



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec




01 Nr. 09/24
Rahovec, 16.9.2024

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e **nëntë (9)**, e cila do të mbahet më:
24 shtator 2024 (e martë), me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit **01 Nr.235/24, i datës 25.7.2024**, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2025;
5. Shqyrtimi i informatës nga DKA-ja, për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025;
6. Shqyrtimi i informatës nga DKRS-ja, rreth muajit të mërgimtarëve.

KRYESUESI I KUVENDIT

Arbër Zenuni





PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **23.08.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 26.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **tetë** të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), Shoqatës “Zona e Pashtrikut”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira 1-15 vjet, P-05058-0 ZK – Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-05058-0, ZK Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira 1-40 vjet, P-00772-10 ZK – Xërxë;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P – 00772-10, ZK-Xërxë;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, P – 02680-1, ZK-Rahovec;
9. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;
10. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023;
11. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2023;
12. Shqyrtimi i Raportit 6-mujor të punës së Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi: Këto janë pikat e rendit të ditës të parapara për sot. E vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (23) votohet rendi i ditës i paraparë për mbledhje e shtatë të kuvendit komunal.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A kemi ndonjë koment apo diskutim nga anëtarët e kuvendit rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht aprovet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;

Sejfullah Sejfullahu: Pyetjet do t'i lë për më vonë! E shfrytëzoj rastin që në emër të opozitës, si opozitë modeste ta urojmë fejesën, gjithashtu Norës ditëlindjen. Urime, të gjitha të mirat.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përsëritet për kryetarin, ekzekutivin, kolegët asambleistë, përfaqësues të KFOR-it, monitorues. E kam një shqetësim, apo një kërkesë për shpjegim dhe dy pyetje. E para është rreth kontratës kolektive, gjegjësisht procedurës përmbarimore, në të cilën është Komuna e Rahovecit në raport me arsimtarët. Arsimtarët kanë pranuar një email përmes avokatëve të tyre, ku nga ana e ekzekutivit të Komunës së Rahovecit është kërkuar që të shtyhet procedura e ekzekutimit përmbarimor, së paku deri në tremujorin e parë të vitit 2025. Në këtë asamble komunale në vazhdimësi e kemi thënë që Komuna e Rahovecit po futet në obligime pa mbulesë financiare, duke e rrezikuar stabilitetin financiar të komunës, për faktin që priten edhe rreth 3 milion të tjera të shkojnë për kontratën kolektive. Këtu është thënë që ne punojmë, ne nuk ndalemi pavarësisht asaj që ndodh në komunë, me arsyetimin që nuk do të ketë probleme financiare. Tani po del e kundërta, ajo që e kemi thënë ne më herët. Kryetar, si të dalim prej kësaj situatë, nëse arsimtarët nuk pajtohen për ta shtyrë procedura e përmbarimit? Këto janë zhagitur përveti nëpër gjykata dhe nuk ka pasur vullnet për një marrëveshje për kompenzimin e kontratës kolektive nëpër periudha. Përkundrazi, është ndjekur në procedurë të ankimit, duke u paguar dhjetra-mijëra € shpenzime avokatore për kontratën kolektive. Në njërin prej rasteve, për periudhën 2023 të gjetur nga auditori: thuhet që obligimet bazë kanë qenë mbi 900.000€ dhe 300.000€ shpenzime të tjera. Kjo nënkupton që 30% është rritur vlera e obligimeve të komunës në raport me arsimtarët për shkak të papërgjegjësisë për ta zbatuar kontratën kolektive. Besoj që jeni të vetëdijshëm që një obligim kontraktual është i pashmangshëm për zbatim. Kjo gjendjen e ka thelluar krizën. Kur opozita jep vërejtje, mos e merrni me inatë – dëgjojeni, analizojeni. Nuk besoj që ka opozitë që i kënaqet falimentimit të komunës, apo kur komunës i ndodh diçka e keqe, sepse ne mund të kemi mospajtime politike, por buxheti nuk është i kryetarit, është i qytetarëve. Kur ekzekutivi nuk dëgjon opozitën, vijmë në situatë që t'i lusim arsimtarët, të cilëve në foltore iu kemi thënë të papërgjegjshëm, sepse kanë "rrejtë" në orët e punës. Kemi thënë që nuk ka shansë të zbatohet kjo, se nuk është obligim i komunës, tani po del të jetë që është obligim i komunës. Pyetja është e njëjta: Në qoftëse arsimtarët nuk e kanë vullneti ta gjejnë mirëkuptimin për ta shtyrë procedurën përmbarimore deri tremujorin e parë 2025? Çka do të bëhet me buxhetin e komunës dhe me projektet që janë në procedurë? A rrezikohet njëmend lekuiditeti i komunës siç e keni shkruar në e-mail, apo jo? Te Drejtoria e Bujqësisë: Është një problem shumë i madh te bujqit për shkak të thatësirave. Sivjet, temperaturat e larta e kanë dëmtuar sidomos perimekulturën. A është një komision që e ka analizuar këtë punë dhe që ka dalun në terren për ta parë gjendjen reale, nëse nuk është, është mirë të formohet për ta bërë një vlerësim të dëmit që është shkaktuar, si dhe ta informoni Ministrinë e Bujqësisë që nëse ka vullnet dhe hapësirë ligjore për kompenzim. Nëse nuk ka mundësi, së paku ne si komunë do ta kemi një pasqyrë të gjendjes së perimekulturës për shkak të thatësirave. Pyetja e fundit përsëri lidhet te çështja financiare. Drejtor, a ka procedurë gjyqësore te tri pagat me rastin e pensionimit? Sa është vlera e saj dhe te pagat jubilarë, kjo çështje përmbarimore a mund ta ndjekë komunën në vazhdimësi?

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit të komunës, ekzekutiv, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë të Komunës së Rahovecit. Po ia filloj nga mbledhja e fundit që e kemi pasur si Komiteti i Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, nga vizitat në Fortesë dhe Drenoc. Objekti i saporenovuar i QMF-së është në gjendje jo të mirë higjienike. Aty stafi shëndetësor ka vështirësi në kryerjen e punëve, sepse kundërmon erë e keqe. Të njëjtin problem e ka edhe Opterusha. Kërkoj nga ekzekutivi të tregojë se pse ndodhin këto kundërmime dhe këtë lagështi. Laboratori në këtë QMF nuk punon. Nga vizita që kemi bërë në Drenoc, aty ka mungesë të barnave. Një sugjerim për ekzekutivin dhe për Drejtorinë e Shëndetësisë: Të bëhet furnitimi më të madh të barnave, nëpër këto QKM që mungojnë barnat. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike: Lagjia "Elshani" në Brestoc ka vazhdimisht kërkesë që t'ju rregullohet kanalizimi, sepse gjendja nuk është e mirë. Është mirë që drejtori të del në vend të ngjarjes dhe ta marrë një veprim urgjent. Rregullimi i trotuarit në Hoqë të Vogël, një pjesë ka filluar, po tash e një muaj është lënë puna dhe nuk është vazhduar me intervenim. Në atë rrugë ka vështirësi në qarkullim dhe mund ta pësojë dikush ndonjë aksident me fatalitet. Për drejtorin e Financave, realisht shefi i grupit, Burimi, e ngriti shqetësimin rreth e-

mailave të dërguara. Drejtor, në bazën ligjore nuk është mirë. Neni 65 i ligjit, thotë ndryshe nga ajo çka ke shkruar. Është mirë që të konsultoheni më saktësisht me zyrën ligjore, që të të informojnë drejt dhe qartë.

Kryetari: Faleminderit! I nderuar kryesues, anëtarë të kuvendit, mbikëqyrës, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të LMT-së. Padyshim që edhe unë i bashkohem urimit të Sefës për fejesën e Arbrit, kryesuesit të kuvendit komunal dhe për ditëlindjen e drejtoreshës Nora Boshnjaku. Urime të gjithëve ata që kanë fejesa, martesë, ditëlindje. Ne jemi dakorduar me Ministrinë e Financave, Departamentin e Thesarit dhe me institucionet tjera që të shtyhen afatet për zbatimin e kontratës kolektive, si dhe fatbardhësisht jemi tri komuna që kemi qenë në hall të madh, e Rahovecit, e Vitisë dhe e Deqanit. Nëse thesari do të vepronte sipas urdhërave përmbarimor, atëherë do të ishte telashe. Më vjen mirë që ne ia kemi arritur, sepse janë obligime shumë të mëdha financiare që rrezikojnë komunën në shumë aspekte. Ju njoftoj që Komunës së Suharekës ia kanë marrë 4 milionë. Ne kemi arritur ta ndalojmë këtë praktikë. Ju përsëris faktin që kontrata kolektive nuk është nënshkruar nga asnjë kryetar komune, por vetëm na institucionet e nivelit qëndror, përkatësisht nga Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, kryeministrat dhe përfaqësuesit e sindikatave përkatëse. E përsëris faktin që nuk kemi të drejtë të planifikojmë mjete për zbatimin e kontratës kolektive dhe kjo është e saktë, sepse buron nga ligji. Kjo gjë ia pamundëson komunave të kenë kod të veçantë për zbatimin e kontratës kolektive. Sipas marrëveshjes për kontratën kolektive kujdeset shteti, i cili siguron mbulimin e shumës financiare që i dedikohet përmbushjes së kontratës kolektive. Sivjet, Komunës së Rahovecit mbi 1 milion euro ia kanë marrë nga kodi paga dhe mëditje. Në qershor kemi filluar të rrezikohemi, pasi kanë thënë që do t'ju marrim edhe në kategorinë e subvencioneve, në investime kapitale apo edhe në mallra dhe shërbime. Letra e fundit e thesarit ka qenë paralajmërim i hapur. Ne kemi kërkuar me insistim nga Ministria e Financave, sepse është mirë ta dinë edhe qytetarët e komunës, ata që na përcjellin, zyrtarët e Ministrisë së Financave dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në qoftëse do ta kishim pranuar ekzekutimin e vendimit që t'i marrin 390.000€ nga shërbimet komunale, atëherë shkollat do të mbetnin pa rrymë, pa lëndë djegëse, pa ujë dhe do të rrezikoheshin institucionet komunale, në pamundësi për t'ju përgjigjur operatorëve. Me një fjalë, kjo gjendje do ta krijonte bazën e përshtatshme për protesta. Është dhënë një opsion nga ministri i Financave, që ekzekutimi i mjeteve të bëhet në tremujorin e vitit 2025 nga kategoria paga dhe mëditje. Mendoj që është lajm i mirë, le të presin edhe 3-4 muaj dhe ne nuk do ta rrezikojmë situatën financiare në komunë. Ne i dimë gjërat mirë dhe gjithashtu po luftojmë shumë që të zbatohet kontrata kolektive, por pa u dëmtuar interesi financiar i komunës. Kemi bërë ankesa, sepse ka kalkulime jo që qarta të avokatëve që i kanë marrë përsipër t'i përfaqësojnë mësimdhënësit. Tani jemi në pritje të vendimeve tjera përmbarimore dhe e kemi alarmuar ministrin e financave, që as ju as ne, nuk kemi të drejtë të ndërmarrim veprime që ia qesin “drynin” komunave të Republikës së Kosovës. Mendoj që e kam bërë një hap të qëlluar. Nga 1 janari, gjegjësisht në tremujorin e parë të vitit 2025, priten të paguhet nga kodi, paga dhe mëditje, si dhe natyrisht i jep mundësi mësimdhënësve t'i realizojnë të drejtat e tyre edhe pse me vonesë. Në këtë pikë, dua t'i shprehi mirënjohje ministrit të financave për mirëkuptim, përndryshe do të ishim në një situatë tepër të rëndë financiare dhe ndoshta nuk do të kishim asgjë për të diskutuar mes vete. Sa i përket kontratës kolektive, i kam fjalët e zgjedhura dhe jam në gjendje gjithë ditën të diskutoj këtu me ju. Tri komuna kemi shpëtuar prej kësaj shtate, sepse e kemi marrë vesh që po na ndodh kjo dhe kemi arritur deri këtu. Urdhërat përmbarimorë nuk i pyesin mësimdhënësit. Ne iu kemi drejtuar përmbaruesëve, përmes avokatit dhe thesari e ka dokumentin, si dhe ata vendosin për shtyerje dhe e rregullon këtë çështje. E kemi pasur mundësi të mos bëjmë ankesë? Po! Plot prej jush do të thonit “pse nuk keni bërë ankesë”? Ne, p.sh. nuk bëjmë ankesë në mendimin juridik të Gjykatës Supreme, që e konsideron të plotfuqishëm vendimin e vitit 2009 të Kryeministrit Hashim Thaqi. Këtu duhet veç zbatim, sepse gjithçka është e qartë. Pra, ne do të paguajmë ende për kontratën kolektive dhe shpresojmë që qeveria e Republikës së Kosovës ta marrë seriozisht këtë temë dhe ta mbulojë kontratën duke mos i ngarkuar komunat, sepse edhe t'i ngarkojë komunat edhe mos të kenë hapësirë për planifikim buxhetor për këtë kontratë, është e vështirë. Në bujqësi, te dëmet për shkak të thatësirave: Sipas udhëzimit administrativ, çdo kush që bënë kërkesë për vlerësim të dëmit, ne e kemi për detyrë ta dëgojmë komisionit. Nuk mund ta bëjmë një komision enkas dhe të shkojmë t'i vizitojmë fermerët e dëmtuar (supozojmë nga thatësitat dhe reshjet), sepse duhet individualisht t'i paraqesin kërkesat për aktivizimin e komisionit. Sa i përket procedurave gjyqësore, nuk e di çka të them Burim, se tani edhe emrin ta përmenda për respekt. Për paga jubilarë e di që plot

vendime i kam nënshkruar dhe deri ku ka arritur procesi për tri pagat, nuk e di saktësisht. Sidoqoftë, me aq sa kemi pasur mundësi financiare, ne i kemi qëndruar gati atyre që i kanë marrë këto paga jubilarë. Drejtoresha e Shëndetësisë nuk është këtu, Lirigzon. Gjendja e QMF-së në Fortesë është sfiduese, sepse është në pikën më të ulët dhe aty ka pasur përmbajtje. Do të ketë probleme sa herë të bie shi, sepse është në pikë të ulët. Na nevojë që objektit të ngritet. Ju kujtoj faktin që ne keni kërkuar ta bëjmë një objekt të ri aty, por qytetarët e Fortesës kanë kërkuar që këtë objekt ta hapim më shpejt. Laboratori nuk punon aty, as në Ratkoc, as në Krushë dhe koncentrimi i angazhimeve për analizave është bërë në QKMF në Rahovec, ndërsa në Ratkoc, Fortesë dhe Krushë bëhen analizat, por për nga numri janë më të pakta. Te mungesa e barnave: QKMF e ka statutin e miratuar nga ky kuvend. Përgjegjësit apo koordinatorët e QMF-ve i bëjnë kërkesat dhe mesiguri të shpërndarja janë disa kritere. Do të interesohemi për këtë temë. Sa i përket QMF-së në Opterushë, gjendja është keq, ka ujëra nëntokësor dhe probleme. Do të zhvillohet një procedurë, sepse aty duhet të ketë një ndërhyrje serioze të brendshme dhe të jashtme. A dështim i punëkryesit? Nuk dua ta them as njërin, as tjetrin, sepse është një organ mbikëqyrës dhe një menaxher. Jam i bindur që këtë punë do ta rregullojmë. Përderisa do të internevojme në Opterushë, unë jam në gjendje t'ju siguroj transport pacientëve për në Rahovec, përkundër që numri i pacientëve është i vogël. Ju vlerësoj për punën e bërë si komitet. Përparimi gjithashtu nuk është sot këtu, por trutuarët kanë filluar dhe do të përfundojnë nga kompania përgjegjëse. Ndërsa problemi në lagjen "Elshani" në Brestoc, ne veçse ia kemi filluar punën me kolektorin dhe me shtratin e lumit prej Hoçës së Madhe deri në Krushë të Madhe. Besoj që edhe ky segment do të ketë ndërhyrje dhe do të trajtohet.

Burim Krasniqi: Kryetar, nuk dalim gjithmonë këtu të bëjmë politikë, dalim për të shprehur shqetësim. Shqetësimi çdo herë nuk është politikë. Është fakt që është barrë e rëndë për komunat. Fakt tjetër është që pjesa dërrmuese e të gjithë kryeministrave që e kanë nënshkruar kontratën kolektive, kanë pasur kryetar komunash. Kryetarët e komunave, kurrë nuk i kanë thënë kryeministrit që, ngadalë sepse na bëhet barrë si komunë (përfshirë edhe kryetarët e Komunës së Rahovecit). Kjo është mungesë planifikimi, mungesë njohurie, neglizhencë apo tendencë shmangie në atë se "Le të ndodh çkado nesër, se duhet t'i fitojmë disa vota", kurse tani nuk bën sepse po dalim keq. Komunës nuk i vendoset çelsi, as asamblesë, veç që e merr menaxhimin thesari, apo Ministria e Financave, nëse nuk gaboj. Nëse themi që nuk kemi të drejtë në asnjë formë, a nënkupton kjo që komunat që e kanë zbatuar kontratën kolektive kanë bërë shkelje ligjore? Ka komuna që nuk kanë obligime dhe e kanë zbatuar kontratën. Këtu nuk ka pasur vullnet, duke menduar që Ministria e Financave e paguan. Është diçka që, të gjithë kryetarët e komunave keni pasur mundësi ta ngritni shqetësimin para nënshkrimit të kontratës kolektive, por është pranuar për shkak të proceseve zgjedhore. Kur e kemi marrë si obligim, nuk është diskutuar deri sa ka arritur në finale përmbartimore. Atëherë janë çelur sytë që njëmend është rrezik diçka. E thash në këtë format të diskutimit, pa pasur vullnet të flas kështu, sepse në vazhdimësi thuhet që, "ne nuk po gërrvishim të lexojmë pak dhe ne po bojmë politikë". Kur është interesi i qytetarëve të Komunës së Rahovecit, nuk bëjmë politikë, vetëm e flasim atë siç ne e shohim, ndoshta jemi duke e parë gabim, por, koha shpeshherë po na jep të drejtën në atë që po e shprehim si shqetësim.

Kryetari: Nuk dëshiroj dhe nuk ka vlerë të bëj replikë. E para, të gjithë kryetarët e komunave janë të shqetësuar dhe kanë qenë të shqetësuar në vazhdimësi, pavarësisht kush ka qenë kryeministër. E dyta, asociacioni i komunave ka bërë edhe padi në emër të krejt komunave. E treta, Komuna e Drenasit ka bërë edhe padi individuale. E katërta, komuna e Kosovës janë në pozitë të palakmueshme sa i përket kontratës kolektive edhe në këtë mandat edhe në mandatet e mëhershme, për jombulueshmërinë financiare nga ana e qeverisë. Drenasi, Suhareka, Peja, Gjakova, Prizreni, të gjitha komunat kanë probleme të mëdha me kontratën kolektive, sidomos mas mendimit juridik të Gjykatës Supreme. Ministria e Financave, bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe Shëndetësisë janë luftëtarët më të mëdha të sigurimit të fondit të zbatimit të kontratës kolektive. Unë ndjehem mirë, sepse ne kemi luftuar me bazë ligjore, asnjëherë kundër mësimdhënësve. Kemi kërkuar shtyerje dhe gjithashtu t'i marrin në kodin, paga dhe mëdijtje. A e dini që opinionin e auditorit e kanë vlerësuar të kualifikuar për shkak të kontratës kolektive?! Pra, kush vuan këtu, përveç qytetarëve të Komunës së Rahovecit? Papërgjegjësi e të gjitha qeverive që nuk i gjejnë diku rreth 100 milionë dhe t'i kryejnë të gjitha obligimet kundrejt mësimdhënësve, ose le të jepet mundësia që komunat ta kenë si obligim, që në baza vjetori t'i planifikojmë "kaq" për kontratën kolektive. Ky është realiteti i ashpër për komunat dhe nëse e keni mundësinë t'i paguani, është pasojë reale financiare.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, të pranishëm tjerë në sallë. Gjykata Themelore në Gjakovë ka marrë një vendim më datë 24 korrik të këtij viti dhe tash më tregoni a jam duke bërë politikë, apo jo! Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses nga Rahovecit, ndaj të paditurës, Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkundesje Sociale, ashtu që vërtetohen të kundërligjshme dhe anulohen. Sa jam unë në dijeni, këtu ka qenë konkursi për teknike të dhëmbëve dhe është punësuar një asistente e stomatologjisë dhe gjykata ka marrë vendim që të anulohet konkursi. Ne jemi në dijeni, unë kam folur paraprakisht këtu që do të punësohet “dikush” dhe është brenda kësaj salle, familjare e ngushtë. Këtu, pos që bëhen punësimet në këtë formë, bëhen edhe të kundërligjshme. Përveç që bëhen me të njofshëm, bëhen edhe me zor, si dhe përgjegjësi nuk jep askush. Kryetar, të ftoj të tregohesh boss dhe të marrësh vendim për shkarkim të drejtoreshës së Shëndetësisë, me atë rrugë edhe Avni Morinën – drejtorin e Arsimit, si dhe të gjithë ata që kanë bërë punësim “spektakolare” në Komunën e Rahovecit.

Kryetari: Ne nuk i komentojmë vendimet e gjykatave! Sipas ligjit janë edhe të drejtat e autoriteteve komunale, për ndonjë të drejtë ankese. Mos u ngut të flasësh para kohë dhe “mos bën hop pa e kcy gardhin”. E presim vendimin e gjykatës së apelit, përgjigjen e tyre. Mos u merr me kualifikime, sepse të gjithë jemi familjarë, bile nuk ka familje shqiptare që unë si kam familjarë. Jemi shqiptarë, vend i vogël. Veprime të dhunshme nuk ka, këtu i rregullon ligji dhe jo “Maliqi”. Secili i shfrytëzon të drejtat ligjore dhe të shprehjes së fjalës së lirë, gjithashtu edhe ti që je në asamble dhe unë që jam këtu, por t’ia lëmë kohës dhe të kuptojmë se cilat janë përgjigjet e organeve profesionale dhe kompetente – gjykata e apelit. E dyta, ekipi është i kryetarit të komunës, i fituesit të zgjedhjeve dhe ju mund t’i përdorni këtu për fushata, por asnjëherë nuk bëhet llogari pa “hanxhi”. Në këtë rast, “hanxhiu” jam unë dhe unë vendosi a ta shkarkojë, a ta emërojë dikë. Unë e kam mandatin dhe unë jam i zoti i shtëpisë. Në fund, përgjegjësia është individuale. Unë i jap vetës të drejtë të të tregoj ty, që në vlerësimet e kryetarit të komunës është emërimi dhe shkarkimi. Kam pasur raste kur dikush ka provuar të më tregojë a duhet ta shkarkojë dikë, apo jo, por ai tani është pensionuar për nga mosha. Unë e kam fituar “davanë” edhe me ligj dhe ia kam kërkuar kompenzim 100.000€ për dëm moral. Besoj që jam arrë e fortë dhe e di a duhet a emërojë dikë apo jo, të gjitha këto kur unë jam kompetent, aty ku s’jam, nuk ndërhyj. Shteti dhe prokuroria është duke funksionuar dhe unë nuk i takoj asaj politike që qohet kundër gjykatave e kundër prokurorisë. Unë jam politikan i rryer me përvojë, që i respektoj vendimet e gjykatës.

Ilir Pallqa: Nëse shkon ankesa dhe në fund aprovohet vendimi i gjykatës, kryetar, a duhet të jep dikush përgjegjësi nëse në fund të ketë drejtë paditësja? Këta kanë bërë pyetje paraprake në Odën e Profesionalistëve Shëndetësorë, sepse këto janë dy kategorizime të ndryshme dhe rastin e keni të humbur. Nëse nuk i shkarkon, atëherë ti duhet të japësh dorëheqje, sepse këtu punësimet janë bërë spektakolare, familjare -partiake dhe paraprakisht unë kam treguar se kush do të punësohet.

Kryetari: E para, nuk e kam ndërmend të jap dorëheqje, sepse nuk shoh as arsye me t’u përgjigj për këtë punë. E dyta, e presim epilogun apo përfundimin e plotë të procesit. E treta, a je i autorizuar ti, t’i tregosh kryetarit të komunës se si zbatohen vendimet e gjykatës? Ka organet tjera që merren, ti je person i zgjedhur dhe këqyri punët e tua.

Defrim Kafexhiu: Urime fejesën, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, media, përfaqësues të LMT-së, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Unë besoj që kur të merret vendimi i shkallës së dytë nga gjykata për çështjen që e potencoi Iliri, kryetari do të merr vendime. Përndryshe, dihet që në politikë përgjegjësia është individuale dhe njerëzit e gjykojnë në formën siç ata dëshirojnë vet, një vendim ose jo të kryetarit të komunës në këtë rast. Unë besoj që, nëse kryetari i komunës nuk e shkarkon një drejtor që e ka marrë një vendim të paligjshëm dhe që e ka punësuar dikë në mënyrë të paligjshme, atëherë ai nuk e meriton të paktën të jetë kryetar i komunës edhe pse ndoshta votat i bën. Te çështja e kontratës kolektive nuk dua të diskutoj shumë, por kryetari i përmendi dy çështje që më lanë përshtypje, tha që, i ka mësuar krejt, e di “fije për pe” çështjen e kontratës kolektive. Unë nuk dyshoj që Komunën e Rahovecit e ka dëmtuar shumë kjo kontratë kolektive dhe në momentin që komuna dëmtohet qindra-mijëra euro është normale që duhet t’i mësojë, por edhe ka qëlluar avokati i fortë dhe ai ndoshta t’i ka mësuar këto teknikalitete ligjore të kontratës kolektive. Kryetari tha që, nëse nuk kisha hasur në mirëkuptimin e ministrit, ju nuk do të vinit këtu të bëni zhurmë. Së pari kërkoj nga kryesuesi që edhe kryetarit të komunës t’ia tërheqë vërejtjen atëherë kur cënohet integriteti i një institucioni të komunës, siç është kuvendi. Ne nuk

vijmë të bëjmë zhurmë, i trajtojmë shumë tema, diçka më serioze dhe diçka më pak serioze dhe përgjegjësia është individuale në atë që ne e flasim. Nuk mund të thirresh në përgjegjësinë individuale të veprimeve tua të kundërligjshme që i merr, e mos të thirresh në përgjegjësinë individuale që e kanë anëtarët e kuvendit. Çështja e ujit në Rahovec: Kemi pasur reduktime të shumta, e di që kryetari është marrë edhe me KRU Gjakovën dhe ka insistuar që kjo çështje të zgjidhet. Çështja e reduktimit është përhapur në tërë qytetin dhe besoj që duhet të bëjmë çmos që kjo çështje jetike të zgjidhet një herë e përgjithmonë, sepse nuk besoj që edhe në Komunë të Gjakovës ka reduktime të tilla. I kam tri rrugë që dua t'i përmendi sot, në të cilat komuna nuk ka ndërhyrë ndoshta që 15 vjet. Rruga "Xhafer Nurkasa", rruga "Gëzim Mullabazi", gjendja e këtyre rrugëve është dytësore dhe janë me vështirësi kalimi. Gjithashtu edhe rruga "Mexhid Mustafa" ka nevojë për intervenime. Ju ftoj që në mundësinë e parë nëse ka kontratë aktive, të rregullohen këto rrugë. U përmend rregullimi i QMF-së në Opterushë: Besoj që vlera ka qenë 100.000€ dhe të prishet kaq shpejt për shkak të kushteve jo të favorshme natyrore – lagështisë, si dhe prapë nuk është zgjidhje që pacientëve t'ia siguronin transportin prej Opterushës, që të vijnë të trajtohen në Rahovec. Kryetari tha që ka pak pacienta në Fortesë, në Opterushë dhe në vende të tjera, atëherë pse i keni ndërtuar QMF-të? E kemi edhe AMF-në në lagjen e epërme që është e mbyllur. Nuk e kuptoj që ta bësh investimin, t'i shpenzosh mjetet e komunës dhe mos të funksionalizohen ato institucione dhe në fund ta krijojmë një zgjidhje tjetër. Është shumë e paarsyeshme nëse tani mendohet të rregullohet QMF-ja në Opterushë. A duhet të jap dikush përgjegjësi për krejt këto AMF dhe QMF që janë bërë? Nuk ka qenë e arsyeshme që të bëhet AMF-ja në Rahovec, që ajo të qëndrojë e mbyllur. Kur të vijmë në atë pikë, unë propozoj që këtë objekti t'ia japim Ministrisë së Arsimit që të rikthehet në çerdhe, në atë çerdhe që është e premtuar. Përveç këtyre, nuk e di kryetari a do të jetë i pranishëm në pikën e raportit të ZKA-së. Para dy seancave, kryetari u drejtua te unë, por besoj që të njëjtin mendim e ka me të gjithë ata që mendojnë ndryshe prej tij. Tha që, "ti nuk din, ti naj herë ia qëllon". Po e jap një koment të vogël, në raportin e auditimit as nuk ia keni qëlluar, as nuk keni ditur. Është interesant, që mos të arrini t'i mësoni rekomandimet e përsëritura gjatë viteve.

Kryetari: Kërkoj mirëkuptim, në ora 11:50 do të lirohem! Fillimisht, parafolësi e mori përgjegjësinë të jetë një këshilltar special i kryetarit të komunës. Unë i marr këto këshilla speciale, sepse je këshilltar i kuvendit dhe i zgjedhur. U kujdes gjithashtu edhe për performancën morale e njerëzore etj etj... E falënderoj shumë, sepse njerëzit që kanë frikë që mos të gabojë kryetari, i ndihmojnë që mos të gabojë. Unë nuk besoj që jam i pakujdesshëm, por sado kudo ta përforcojmë me argumente se si nuk duhet të gabojë një kryetar. Besoj që i dhash përgjigje rreth asaj çka u fol për vendimin e gjykatës, sepse ka një ankesë. Unë kam plot miq në Rahovec, një nga më të mirët e kam Bylbyl Oruqin. Ka arritur dhe është avokat i mirë dhe nuk ka nevojë të më mësoj për teknikalitete, sepse është ligji që i rregullon këto punë. E kam shok dhe jam shumë i lumtur që e kam shok. Shok e kam pasur edhe kur kemi qenë me një parti. Sa i përket përgjegjësisë, u tregova korrekt. Çerdhja do të bëhet. Për objektin e AMF-së atje, është i paraparë me masterplan dhe me plan të mobilitetit. Do të gjenden modalitetet dhe ekspertiza në të ardhmen, se çka bëhet me objekte të cilat nuk mund të plotësohen me asgjë. QMF-ja në Opterushë është një problem i madh i ujërave tokësorë, pra, nuk është problem ndërtimi, por lagështia. Sidoqoftë, jemi të obliguar ta rregullojmë QMF-në në Opterushë. Sa i përket numrit të vogël pacientëve, është shumë mirë, sepse gjendja e popullatës është e shëndetshme. Janë 2-3 objekte shëndetësore që kanë probleme me lagështi. Të inkurajoj ta vazhdojnë rolin e këshilltarit special të kryetarit të komunës, sepse djemve të zotë jam i interesuar t'ju ndihmoj. Mendimi ndryshe mua më ndihmon, e pranoj, ndonëse ndonjëherë me vështirësi, sepse mendimi ndryshe ndonjëherë ka fjalë të pavërteta. Sa i përket raportit të ZKA-së me rekomandime të përsërituara, rekomandimet do të përsëriten ende, sepse obligimet kontraktuale e financiare që lidhen me nevojë që të kryejmë sa më shumë punë, do të përsëriten edhe në të ardhmen. Unë e di që si rekomandim do të jetë, pagesa me vonesë e faturave apo edhe tatimi në pronë. Esencialja është që raporti ynë nuk i jep mundësi dikujt që të vijë ta intervistojë dikë. Ajo që është keq, është që e kemi opinionin e kualifikuar, sepse nëse mbetet kriteri që të fitojmë grant, do ta kemi mundësinë e humbur. Jemi komunë me performancë dhe transparencë të lartë dhe nëse ky kriter bie, ne përsëri jemi fitues të grantit për vitin 2023.

Edonë Kryeziu: Përshëndetje i nderuari kryesues, drejtorë të drejtorive, kolegë kuvendarë, monitorues dhe gjithë të tjerë të pranishëm. Në këtë seancë dua të flas për pritjen e gjatë dhe njëherit durimin e disa prej banorëve në komunën tonë. Konkretisht, dua të flas për të prekurit nga vërshimet që kanë ndodhur me 17 dhe 18 shtator 2022. Kryetar, ju

keni formuar një komision për vlerësimet e këtyre dëmeve. Sa ka qenë real ky komision? Kam informacione nga banorët, që ky komision ka punuar në baza partiake. Dikujt i është kompenzuar dëmi, besa më shumë se sa dëmi, ndërsa disa prej tyre janë ende në pritje të këtyre kompenzimeve që nga vitit 2022. A e meritojnë qytetarët e Rahovecit të dallohen në këtë formë? A janë të gjithë bartës të taksave komunale? A jeni ende në pritje të këtyre kompenzimeve dhe sa mund të ketë shpresë në këtë drejtim?

Kryetari: Këtë çështje e keni ngritur disa herë dhe është mirë, legjitime. Komisioni është komision komunal dhe nuk ka lidhje hiç me parti. Për hir të së vërtetës hulumtoni pak, ndoshta anëtarët e komisionit ju dalin nga partitë e juaja dhe jo prej kësaj që unë i takoj. Komisioni e kryen punën e vet dhe ne duhet t'ia besojmë. Ka bujk që e ka prishur "najlonin" e serrës duke lëvruar me motokultivator dhe e ka kërcënuar komisionin, duke i thënë që t'ia llogarisin edhe atë si dëm. Fillimisht, Komuna e Rahovecit është refuzuar me plot komuna të tjera. Komuna e Rahovecit nuk ka lëshuar pe, duke i nxjerrë një herë 100, e më pas 100 të tjerë deri në fund, në fund kanë mbetur 60-70. Këta të fundit nuk i ka pranuar komisioni shtetëror për kompenzimin e dëmeve. Ne i kemi gjetur disa forma që t'i kompenzojmë edhe pse nuk janë pranuar. Jam shumë i sigurt që lufta për kompenzimin e dëmeve prej vitit 2022 e deri në këtë vit, e kemi kryer punën në mënyrë profesionale. Edonë, është e dhjeta herë që po e përmend këtë temë. Mirë është t'i trajtojmë, por nuk mundesh ti, t'i besosh a priori një qytetari dhe mos të tentosh ta vërtetosh që komisioni e ka bërë punën mirë. Duhet të provojmë që edhe politikën ta bëjmë më argumentuese, më bindëse dhe më kredibile, duke kërkuar qasje në dokumente zyrtare të komisionit të Drejtorisë e Bujqësisë dhe ta vërtetosh a është bërë puna si duhet. Është e sata herë që po flasim për çështjen e dëmeve, një herë e ke ngritur edhe për Vrajakë dhe ta kemi dhënë shpjegimin. Nuk kam harruar unë asgjë, sepse i lexoj edhe procesverbalet.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Të nderuar kolegë asambleistë, drejtorë, vëzhgues, të gjithë në sallë. E kemi biseduar disa herë punën e kamerave në shkollë. Para disa dite kam qenë në vizitë në shkollë me disa arsimtarë, ka qenë shumë e dëmtuar shkolla. Nuk është ndonjë kosto e madhe, por kosotja e dëmit është shumë më e madhe se sa t'i vendosim kamerat. Është mirë t'i vendosni sa më shpejt. Pyetja tjetër ka të bëjë në lidhje me trajtimin e qenve endacakë. Herën e fundit kryetari na ka dhënë një përgjigje joserioze, duke thënë që dikush e ka tenderin dhe ai merret me atë punë. Nuk dua të paragjykoj dhe nuk e di kush është ai operator, por hiç nuk është duke u marrë me këtë punë. Qentë endacakë e kanë kapluar Krushën, Dafina është këtu, besoj që edhe Nagacin. Njerëzit po i sjellin qentë në strehimoren në Nagac, ndërsa strehimorja nuk është duke pranuar më asnjë qenë, për arsye të veta dhe njerëzit po i lëshojnë midis Krushës apo Nagacit. Nuk bëj thirrje për mbyetje të qenve endacakë, por të trajtohen si në çdo vend të botës së civilizuar.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për drejtorët e drejtorive, kolegët asambleistë, për të gjithë të pranishmit. E pata një pyetje për kryetarin sa i përket kontratës kolektive, por meqenëse është konsumuar kjo temë unë e di që gjatë kohës kur kam qenë drejtor shkolle, sindikata ka kërkuar disa herë takim me kryetarin, për ta zgjidhur këtë problem duke bërë marrëveshje me mësimdhënësit, që mos të vie puna deri te gjykatat. Së fundmi po shihet që disa qindra-mijëra euro është dëmtuar Komuna e Rahovecit, për shkak vendimeve të gjykatave. Këtu, gjithashtu në humbje jeni edhe me grant të performancës, meqë e keni humbur si grant dhe del të jetë që është një humbje shumë e madhe, ndoshta për kryetari nuk është shumë, por për qytetarët po. Një fjalë e urtë thotë: "Ata që shkaktojnë probleme, nuk janë të aftë ta zgjidhin"! Në këtë rast, kryetari e ka shkaktuar këtë kaos dhe ka arritur ta shtyjë së paku edhe 4-5 muaj. Kjo punë qenka që ta falënderojmë ministrin Hekuran Murati dhe Ministrinë e Financave, sepse ia ka bërë komunës të mundshme që me 1 shtator të fillojnë punën shkollat dhe të punojnë institucionet. Nëse jo, atëherë do të ishte ndërprerë uji, rryma dhe shërbimet tjera ashtu siç e tha, nuk do të ishte e mundur të hapet asnjë shkollë pa këto mjete. Pyetja e dytë është për Drejtorinë e Arsimit: Gjatë informatës që e kemi pasur në seancën e kaluar, drejtori nuk ka qenë prezent për shkak të ahengut familjarë. E kam parë që, 547 nxënës e kanë përfunduar klasën e 9-të, 280 prej tyre kanë aplikuar për shkollë të mesme. A ndjenë përgjegjësi Drejtoria e Arsimit që 50% e nxënësve që nuk dëshirojnë të regjistrohen në shkolla të mesme? Nëse Drejtoria e Arsimit nuk ka përgjegjësi, atëherë kush e mbanë përgjegjësinë? A ka plan të dytë, që ky trend të mos vazhdojë edhe në vitet tjera? Para fillimit të vitit shkollor, të bëhen komisione, të shkojnë të prezantojnë nëpër klasë të nënta dhe të ligjerojnë programe që ekzistojnë nëpër shkolla të mesme, në mënyrë që ta evitojmë ikjen e nxënësve në Gjakovë apo Prizren.

Edonë Kryeziu: Ndoshta është e padrejtë të kundërpërgjigjem, pasi kryetari nuk gjendet në sallë. Mirëpo, janë procesverbalet ato që lënë gjurmë. Kryetari e ceku kinse unë e kam ngritur disa herë këtë çështje. Lirisht merrni procesverbalet edhe kontrolloni, por edhe nëse po, nuk është shqetësimi im personal, por është i disa banorëve që unë ia besoj sa herë që është e nevojshme, sepse ky është roli im, adresimi i brengave dhe i halleve. Kryetari ia hedhi fajin komisionit. Ne e dimë që secili komision i formuar nga ju, dirigjohet nga kryetari.

Eqrem Spahiu: Faleminderit kryesues! Më herët u fol shumë në lidhje me ambulancën e fshatit Opterushë. Kryetari, fajtor po e bën vendin ku është ndërtuar objekti. Sipas meje nuk është faji i vendit, sepse aty e kemi edhe shkollën. Faji është i operatorit që nuk e ka bërë punën si duhet dhe operatori i njëjtë shpërblehet edhe me tendere të tjera. Kryesues, ti e njeh këtë lëmi dhe nuk i ka fajet vendi, por operatori.

Lirigzon Kastrati: E bëra një kërkesë rreth kubëzimit të rrugëve, por kryetari nuk dha përgjigje, mesiguri për arsye që mungon Përparimi. Le të mbetet në proces, që në seancën e radhës Përparimi të përgjigjet. Sa i përket ndriçimit publik, kompania që është e kontraktuar për ofrimin e shërbimeve për ndriçim publik, rreth rikthimit të ndriçimit publik në lagjet e fshatit Hoçë e Vogël, Kastrati, Krasniqi, Gashi, Berisha, deklaruan që rikthimin duhet ta bëjë KED-si, sepse i njëjti e ka bërë ndërrimin e shtyllave. Është mirë ta kemi një sqarim nga drejtori.

Avni Morina: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë asambleistët, për kolegët drejtorë. U parashtruan dy pyetje sa i përket çështjes së arsimit. Së pari, asambleisti Sejfullah Sejfullahu pyeti për kamerat e sigurisë në shkollën "Bajram Curri"! Është e vërtetë që kur është ndërtuar shkolla, fatkeqësisht në projekt nuk e ka pasur edhe instalimin e kamerave, ju e dini që shkolla është ndërtuar nga Ministria e Arsimit. Ne kemi marrë masa dhe tani jemi në proces që ta bëjmë instalimin e kamerave, sepse e kemi një kontratë për instalimin e kamerave në objekte publike të komunës. Sa i përket pyetjes së Leonard Morinës: Sipas ligjit, shkollimi i mesëm i lartë nuk është shkollim i obliguar. Obligativ është shkollimi fillor dhe i mesëm i ulët. Nuk është e vërtetë që 50% nuk e kanë filluar shkollën e mesme në komunën tonë. Është një përqindje e nxënësve që vërtetë shkojnë edhe në komunat tjera dhe kjo e drejtë është e garantuar me ligj. Ne nuk kemi të drejtë t'i obligojmë nxënësit që të vazhdojnë shkollimin e mesëm të lartë në komunën tonë apo edhe vende të tjera, ashtu siç nuk kemi të drejtë t'u ndalojmë vazhdimin e studimeve atyre që mbarojnë shkollën e mesme të lartë në vende të ndryshme, apo edhe jashtë vendit.

Sejfullah Sejfullahu: Pasi nuk është kryetari, me nënkryetarin e kemi pak me pa doreza. Ka qenë një marrëveshje gjentëlmenësh, janë edhe procesverbalet zyrtare. Kuvendi ka nevojë për një vizitë studimore. A ka mundësi kur e kemi këtë datë, të koordinohemi të gjithë bashkë?! Kërkesa e asambleistëve është që të pranishëm të jenë edhe drejtorët.

Kryesuesi: Faleminderit Sejfullah Sejfullahu! Patjetër që do t'ju informojmë, sepse në kuadër të planit të punës së kuvendit është e paraparë edhe një vizitë studimore.

Leonard Morina: Të dhënat që i dhash, u bazova në informatën e DKA-së që ka ardhur muajin e kaluar. Në qoftëse informata është gabim, atëherë duhet ta hiqni dhe ta zëvendësoni me informatën e saktë. Shënon: 547 nxënës e janë testuar në klasën e 9-të, ndërsa 280 kanë qenë maturanata dhe regjistrimet në afatin e parë janë afër 260 dhe kjo i bie 50%. Ne e dimë që shkollat e mesme nuk janë obligative, por unë e shprehja si shqetësim imazhin që ne iu kemi dhënë shkollave të mesme. Ne, si bartës të institucioneve apo si mësimdhënës që punojmë, fëmijët tanë nuk i regjistrojmë në këto shkolla ku punojmë, atëherë kjo tregon çka i kemi bërë shkollave tona.

Avni Morina: Është e pasinqertë që të merren të dhënat e afatit të parë, kur jemi në dijeni që është edhe afati i gushtit për regjistrimin e klasëve të dhjeta. Afati i gushtit ka mbaruar dje, ka qenë tre ditë rresht dhe ata që shkojnë në komuna të tjera, ne si Drejtori e Arsimit nuk mund t'i ndalojmë. I kanë arsyet familjare, psh. Çifllaku dhe Gur i Kuq dhe Xërxa tradicionalisht shkojnë në Gjakovë, një pjesë e madhe e Krushës shkojnë në Prizren. Unë u uroj vetëm suksese. Sa i përket rënies së numrit të nxënësve, është proces që po ndodh nëpër krejt Kosovën, jo vetëm në komunën tonë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Të nderuar anëtarë të kuvendit, në pyetjet e parashtruara, përgjigjet do t'i merrni me shkrim. Tani e kemi pauzën njëorëshe...

3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), Shoqatës “Zona e Pashtrikut”;

Nënkryetari: I nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë, të gjithë ju të pranishëm. Para vetes e keni vendimin që kërkohet për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), Shoqatës “Zona e Pashtrikut”. Ka të bëjë me ngritjen e shtatores së heroit të kombit, Tahir Sinani. Unë besoj që jam i vogël të flas për veprimtarinë jetësore, ushtarake e luftarake të Tahir Sinanit. Këto mjete do të ndahen nga kodi i subvencioneve. Komunitat donatore janë: Prizreni, Suhareka, Rahoveci dhe Dragashi. Ne i ndajmë 10.000, Prizreni nëse nuk gabo, i ndan 50.000.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! A keni diçka lidhur me këtë pikë?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Unanimisht (17) votohet pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira 1-15 vjet, P-05058-0 ZK – Rahovec;

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Rahovec, parcelë e komunës, vendin e quajtur Krajishte, me nr. 05058-0, me sipërfaqe prej 1276m². Është në qytet, afër rrugës tranzite Qëllimi ka të bëjë me ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale si dhe vetëpunësimi.

Defrim Kafexhiu: A kemi kërkesë për marrje në shfrytëzim të kësaj prone dhe besoj që edhe kuvendi është e udhës t’informohet e kujt është kërkesa.

Ilir Pallqa: Duke marrë parasysh që ka pak prona publike në Rahovec, përnjëmend mendoj që nuk është mirë të jepet kjo pjesë. Është afër asfaltit dhe në PZHK është e paraparë për ndërtime dhe mund të jetë interes publik për ndërtim në komuna.

Kryesuesi: Ilir, kjo është parcela për të cilën po diskutojmë.

Burim Krasniqi: Drejtor, nëse nuk gabo, parcela është pak mbi tranzitit, mbi fabrikën. A do të jepet në shfrytëzim për ndërtim apo për bujqësi? Nëse më lejohe kryesues, në një rast në Fortesë ka pasur problem ta merr pëlqimin për kyq në rrugë prej ministrisë, sepse i kanë kërkuar pëlqim për qasje në pronën publike. Në qoftose tranziti i Rahovecit është i kualifikuar si rrugë që menaxhohet prej ministrisë apo prej komunës? Nëse është prej ministrisë, në qoftëse jepet për ndërtim, a shfaqë vështirësi në marrjen e pëlqimit? Sepse duhet marrur një pëlqim prej Agjencionit të Pylltarisë dhe është proces zigjiror që e kushtëzon njëra-tjetrën. Faktikisht, për të marrur leje ndërtimi, nëse tranzitin e menaxho ministria, të duhet leje për qasje në rrugë dhe nëse ajo është pronë e Agjencionit Pyjor, të duhet pëlqim prej të njëjt agjencion për qasje. Ne e japim në shfrytëzim një parcelë, e cila nëse pretendohet të jepet për ndërtim duhet ta ketë një leje ndërtimi, sepse duke e njohur terrenin, për bujqësi është problem.

Afrim Oruqi: Në pyetjen e kuvendarit, Defrim Kafexhiu, a ka kërkesë? Po, ka kërkesë me shkrim dhe për shkak të procedurave ligjore nuk guxojmë ta përmendim, sepse pas vendimit të juaj formohet një komision, i cili do t’i caktoj disa kritere, hap një ankand dhe mbi bazën e kritereve të komisionit dhe kush jep më shumë – e fiton. Ka ndodhur shpesh që kërkuesi nuk e ka marrë. Kjo pronë e komunës është në listën e përgjithshme të pronave që ne i kemi pasur të planifikuara t’i japim me qera në vitin 2024. Është tokë bujqësore, e precizuar qartë në vendim.

Defrim Kafexhiu: Para 2-3 seancave e kemi votuar një të drejtë të servitutit, a është rruga prej kësaj parcele, apo ajo është parcelë tjetër? Të paktën një informatë për personin që e ka bërë kërkesën, a ka parcelë private që kufizohet me këtë parcelë të komunës?

Afrim Oruqi: Servituti nuk ka të bëjë me këtë pikë. Bëhet fjalë për një pikë tjetër që vjen pas kësaj. Nuk e di nëse njëjti ka parcela private përreth. Fillimisht, ligjërisht nuk e di a e fiton ky!

Defrim Kafexhiu: Parcelat private që janë këtu dhe Komuna e Rahovecit a ka pronë tjetër që është ngjitur me këtë pronë, nëse jo, atëherë këto parcelat private përreth a kanë qasje në rrugë private dhe publike? Mos është rastësisht nevoja që këto parcela prapë ta ushtrojnë të drejtën e servitutit?

Afrim Oruqi: Këto parcela nuk kanë qasje në asfalt, sepse janë shumë më poshtë, kush e njeh atë terren, e din. Këta kanë poshtë rrugën për kyqje, në drejtim të qytetit.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diçka tjetër, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht (19) aprovohet pika e katërt.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-05058-0, ZK Rahovec;

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për të njëjtë pronë të komunës me nr. 05058-0 ZK Rahovec. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, 2 prej tyre nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga organizatat joqeveritare.

Hasan Përboqi: AAK, Feriz Thaqi.

Leonard Morina: LVV, nuk kemi propozim.

Burim Krasniqi: LDK, Lirigzon Kastrati.

Sejfullah Sejfullahu: PDK, nuk kemi propozim.

Kryesuesi: Atëherë, nga kuvendi janë Feriz Thaqi (AAK) dhe Lirigzon Kastrati (LDK), dy të tjerë do të jenë nga ekzekutivi dhe një nga organizatat joqeveritare. Si të tillë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?. Abstenim?... Me shumicë unanime (16) aprovohet pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira 1-40 vjet, P-00772-1 ZK – Xërxë;

Afrim Oruqi: Para jush keni vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pjesën e parcelës, e cila është në pronësi të Komunës së Rahovecit në afat prej 40 vjet. Prona e paluajtshme është në zonë kadastrale në Xërxë, në vendin e quajtur Gradish, me nr. 772-10, me sipërfaqe 23 ari e 50m² prej pjesës së përgjithshme prej 2 hektarë. Parcela është jashtë kufijve dhe mureve që e rrethojnë obeliskun në Gradish, kështu nuk rrezikohet hyrja prej rrugës kryesore në Gradish. Gjithashtu nuk preket as parking e as shtegu i ecjes. Për këtë hapësirë ju kërkohet votën e juaj dhe të vendosim që t’i japim me qera për 40 vjet personave fizikë dhe juridik, përmes ankandit publik. Qëllimi i vetëm është destinim-prodhim tregësor, shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ. Në fund, komisioni është ai që lejon ose jo shërbimet dhe obligo fituesin që ta mirëmbajë Gradishin.

Burim Krasniqi: E kam thënë edhe në KPF! Kjo parcelë nuk bën të jepet në shfrytëzim. Zona e Gradishit, deri te rruga aty ka qenë zonë e mbrojtur. Ajo hapësirë është hequr nga zona e mbrojtur, me qëllim që të ndërtohet obelisku. Ajo është zonë që simbolizon sakrificën e Luftës Çlirimtare të Kosovës. Në emër të kësaj, nuk është mirë të jepet në shfrytëzim një parcelë aty. Kemi shumë prona private në Gradish, që janë parcelë në zonën e mbrojtur dhe nuk mund të ndërtojnë. Tani, nuk bën dikush të ndërtojë, sepse është në zonë të mbrojtur dhe në emër të obeliskut dhe të kujtesës për luftën të heqim një parcelë komunale nga zona e mbrojtur, si dhe në anën tjetër t’i japim dikujt të shfrytëzim për të bërë biznes - restorant, hotel, me arsyetimin që hapësira e obeliskut të mirëmbahet. Në momentin që është ndërtuar obelisku është e ditur që duhet të mirëmbahet dhe të planifikohet mirëmbajtja e saj. Ju kërkohet miqësisht secilit prej asambleistëve mos e votoni të jepet në shfrytëzim kjo hapësirë. Le të ndërtohet parkingu, le të ruhet destinimi i saj dhe le të qmohet ajo për çka është investuar dhe jo të bëhet biznes në emër të saj. Gjithashtu edhe Ferizi duhet të pajtohet me këtë, kryetari i Shoqatës së Veteranëve. Projekti është shumë prapa, janë ende betonet që janë paraparë të varrosen dëshmorë për të cilët asnjëherë nuk është gjetur konsensus me familjarët e tyre. Ende pa u finalizuar, të lejomë që dikush të bëjë biznes! Fillimisht, para se të vendoset në votim, kërkohet të tërhiqet, në të kundërtën i kërkohet asambleistëve që mos të votojnë. Nuk ka logjikë, sepse është zonë të mbrojtur, ku të gjithë të tjerëve i mohohet ndërtimi, si dhe është ndaluar parcelë për hirë të obeliskut, ndërsa sot të shfrytëzohet të bëhet biznes. Për neve si LDK është e papranueshme, për banorët e xërxës është e papranueshme dhe kërkohet për herë të fundit, mos e votoni!

Afrim Oruqi: Qëllimisht e mora fjalën të përgjigjem menjëherë, që të tjerët ta kenë më lehtë qasjen në fjalim dhe në qëndrim. E para, nuk bëhet fjalë për zonën e mbrojtur, nuk është në zonën e mbrojtur të Kanionit – Drini i Bardhë. E dyta, nuk është brenda kufijve të obeliskut. Nder dhe respekt për veprimtarinë e UÇK-së. E treta, pikërisht për këtë qëllim ne po e bëjmë këtë veprim që t’i nderojmë këta dhe veprat e tyre në këtë vend. Nuk bëhet fjalë vetëm për Gradishin, jemi duke e analizuar edhe ngadalë dhe qetë gjithashtu edhe Majën e Shkodranit. Te kulla “Toni e Mici” edhe aty i kemi 60 ari. Nuk po kërkohet nga ju të marrim vendim që këtë pronë të hapet restorant, as hotel. Bashkërisht do ta obligojmë atë që oferton, me kriteret që do t’i vendosë komisioni. Ideja është që të bëhet diçka që ka lidhje me luftën e fundit apo artizanate. Asambleisti e din shumë mirë që pavarësisht mirëmbajtjes, atje janë bërë kundërvajtje të ndryshme, është dhunuar vendi disa herë nga keqdashësit, janë dëmtuar objektet, janë thyer xhamat disa herë. Qëllim

ynë është që me këtë veprim ta vendosim një kujdestari, në mënyrë që të mirëmbahet dhe që familjarët kur të shkojnë për vizitë në këtë vend, mund ta blejnë një flamur apo një palë veshje kombëtare. Nuk jemi duke hyrë brenda kufijve të obeliskut dhe nuk po rrezikojmë asgjë, përkundrazi, Komuna e Rahovecit ka kontratë aktive dhe i ka ndarë mijëra eur për ta përfunduar këtë projekt edhe për për betonat që foli asambleisti, do të veshën me mermer. Sa i përket temës që njerëzve nuk po i lejohet të ndërtojnë në prona private që i kanë aty në zonë të mbrojtur, është formuar një komision dhe ne jemi në komision bashkë me Gjakovën. Takimi i parë është bërë dhe është bërë një draft profesional, i cili do të vendoset në diskutim publik për njerëzit e kësaj zone, të Xërxës e të Gexhës. Shumë shpejt do të kemi vendim këtu, që zona të ngushtohet, me qëllim që njerëzit aty të kenë të drejtë të ndërtojnë, varësisht prej destinimit që është i parapara me PZHK. Ju ftoj juve, bashkë me Burimin si përfaqësues i asaj zone, asgjë të keqe nuk ka që të provojmë këto ari të japim në shfrytëzim, që në të ardhmen ky vend të jetë i hapur 24 orë për njerëz dhe gjithashtu të jetë i mirëmbajtur.

Burim Krasniqi: Drejtor, kur dikush dëshiron të tregoj diçka, ia mbanë me “rrrotlla” për t’u dukur interesant! Ajo është shtyrë disa herë, për shkak të moskujdesit të komunës. Nuk mund të arsyetohesh që është thyer 2-3 herë, ka pasur huliganizëm dhe dukuri negative dhe tani ta japim në shfrytëzim. Nuk ka pasur përkujdesje prej institucioneve dhe i ka dhënë mundësi kujtdo të futet brenda. E dyta, “nuk do të bëhet restorant”? Jo, do të hapet shoqëri kulturo-artistike. Aty do të bëhet një restorant, dyqan i vogël edhe ndonjëvend për shitje të veshjeve kombëtare. Ta garantoj që do të ketë restorant, pa të, nuk do të vie askush të investojë aty. Të mos tentohet të paraqitet, kinse Burimi po e ndryshon. Askush nuk tha që po ndërtohet në zonë të mbrojtur. Ndonjëherë kur flas, ose kur flet dikush, dëgjojeni drejt dhe jo në mënyrë siç keni qejf. Ajo zonë ka qenë zonë e mbrojtur, është hequr si zonë e mbrojtur vetëm për obeliskun. Kur flas, flas me përgjegjësi, sepse jam rritur aty dhe e njoh mirë. Mirëmbajtja? Jepjani dikujt, fatkeqësisht që tre mandate nuk është finalizuar. Nuk e kompletion obeliskun restoranti të dera. Obelisku kompletionet kur të finalizohet brenda. Kërkesa im personale është mos ta votoni! Nuk është në rregull të bëhen biznes çështjet historike!

Ilir Palla: Obelisku për nga struktura është më i bukur në Komunë të Rahovecit. Sa kam informata prej OVL-së, për vitin tjetër do të bëhen përkujtimoret për dëshmorët në një ditë, apo për disa ditë. Nisja dhe baza do të jetë obelisku dhe i bie të jetë një prej vendeve më të rëndësishme në komunë. Nuk e di a mund ta bëjë këtë analogji, por në Prekaz nuk ka diçka të tillë aty afër! Nuk e di! Ndoshta mund të bëhet diçka, por komisioni duhet të ketë shumë kujdes se çfarë parakushte i qet aty. 40 vjet përnjëmend është shumë! Do të ishte mirë, 20 vjet. Për 40 vjet, kryetari i bën 90 vjet, është shumë. Jam pro asaj që të bëjmë diçka, në mënyrë që t’i nxisim njerëzit e vendeve tjera të vijnë në komunën tonë.

Feriz Thaqi: Përsëritet kryesues! I nderuar nënkryetar! Nuk është ndoshta vendi më i rëndësishëm i luftës, por është një ndër vendet më të përshtatshme për mbajtjen e tubimeve të ndryshme. Gjendja në të cilën është tani obelisku, për përkujdesje, me të vërtetë është keq. Ndoshta zgjidhja më e mirë është që të jepet në shfrytëzim dhe njëkohësisht të mirëmbahet.

Merisa Sharku: Përsëritet për të gjithë! Shumica prej neve që jemi këtu, ia dëshirojmë të mirën Rahovecit, sidomos kur në Rahovec bëhet diçka e mirë dhe ndërtohet. Pa mëdyshje do ta votoja këtë pikë që të bëhet një vend i bukur, apo restorant, që të kemi ku të shkojmë për vizitë në një vend historik me familjarë. Do ta votoja pa mëdyshje, nëse do të kishim besimin të ekzekutivi që nuk do të ndodhë ndonjë “dallaver”. Propozoj që AAK-ja të tërhiqet nga komisioni, sepse dy të tjerë i ka nga ekzekutivi. Pajtohem gjithashtu me Ilirin që kohëzgjatja të jetë më e vogël dhe jo për 40 vjet.

Drilon Mustafa: Përsëritet për të gjithë kolegët, drejtorët dhe të gjithë të pranishmit. Drejtori na shpjegoi që ky parcelë e ka titullarin dhe është drejtoria në fjalë. Kjo i bie që për çdo dokument, do të aplikohet te drejtoria në fjalë. Unë jam për t’u ndërtuar aty një restorant i mirë, për vizitë dhe për freskim. Një propozim i imi është që aty të sigurohe 50 parkingje publike.

Sejfullah Sejfullahu: Ajo që kam vërejtje është që ne si PDK nuk mund ta votojmë për 40 vjet, t’i japim rast sikur të tjerat, 5-15 vjet, maksimum 20. Ndoshta është e ligjshme, por për 40 vjet na bën të dyshojmë diçka.

Defrim Kafexhiu: Drejtori tha që ka pasur raste kur personi që e ka bërë kërkesë për ta marrë një pronë në shfrytëzim nuk ka arritur ta marrë në ankand. Do të dëshiroja ta di një rast specifik të tillë. Pajtohem me Burimin që kjo pjesë ka qenë komplet në zonë të mbrojtur. Nuk besoj që zyrtarët e Kadastrës kanë dalur në terren ta shohin parcelën të obeliskut e kanë parë këtë parcelë dhe kanë thënë “wow këtë parcelë duhet ta japim në shfrytëzim”, dyshoj që ka qenë kështu. Kjo personi që ka shprehur interes, besoj që është shumë i mençur. Unë jam pro asaj që të krijojmë mundësi që të menaxhohe

këto monumente historike, që me pasë më të lehtë mirëmbajtjen dhe jetëgjatësinë e tyre. Më pengon fakti që ju i ke humbur ndjenjat në këso raste dhe te kjo pjesë, personi që do ta marrë, ka më shumë interes sesa komuna që po e jep Iliri e dha një propozim, duhet ta vendosim në votim dhe meqenëse edhe Sefa e përmendi. Propozoj që vendimi i ndryshohet dhe të jepet në shfrytëzim për 20 vjet. Është normale që komisioni të ketë kritere më të ashpra në kuptimi e interesit të Komunës së Rahovecit dhe palës së interesuar.

Afrim Oruqi: Para se të vendoset në votim, për hir të asambleistëve që ta kenë më të lehtë votimin. Vendimi është par jush, ende nuk është ligjor. Vitet janë propozim dhe ajo varet nga ju si të koordinoheni. E dyta, mund ta specifikoni në vendim, për shembull restoranti mos të ofrojë alkool, që restoranti të ndërtohet veç me gurë e me dru, që ky restorant t punojë në këtë kohë etj... Nëse don të mos keqpërdoret restoranti, caktoje kohën e veprimit. Në pyetjen e Defrimit rret kërkesës: Ka pasur një kërkesë për një pronë në "Sejan" për 40 ari të komunës, gjatë procedurës së ankandit, e kupto edhe dikush tjetër, i cili i dha disa centë më shumë dhe e fitoi, ia bëme kontratën dhe i prishëm me të parin. Defrimi p më pëlqen. Përderisa ka qenë kryesues, më shumë Defrimi qëndronte me kryetarin sesa unë. Defrimi nuk është i njëj edhe në shkrime. Nuk ke pasur postimet në facebook deri sa ke qenë kryesues. Në momentin që të është rrezikuar poziti i ke bërë 22 postime kundër nesh. Mos më ngushto të flas, neve na ka shkuar mendja bashkë me juve, e kemi pranuar dikë të aplikojë, e thirrnm "hajde apliko, 2 herë" duke i maltretuar anëtarët e komisionit, në fund nuk pranoi, duke thënë që është shtrenjtë. Bashkë e gjetëm dhe dështoi.

Defrim Kafexhiu: Siç thotë kryetari: "Kur t'i mshon tavolinës, krijohet reaksioni dhe dora kthehet prapa"! Faleminder kryesues për mundësinë. Sa kam qenë kryesues është e vërtetë që unë kam ndenjur edhe me kryetarin dhe drejtoriat. M ka rastisur të kem punë edhe me drejtorin, Afrim Oruqi. Drejtorin e kam ngushtuar gjithmonë për punë parimore, seps kurrë asnjë punë nuk e kam diskutuar me drejtorët, apo me kryetarin. Më ka lënë përshtypje Afrim Oruqi. E pyeta diçk dhe më tha që "më fal, unë nuk paguhem për këtë pyetje". Kur kam qenë me kryetarin në bufe, vinte drejtori, unë e ftojsh brenda, sepse e hapke derën dhe në një farë mënyre nuk dëshironte të na pengonte, thua që ne po bëjmë ndonjë "pazar aty. Kurrë "pazare" me kryetarin nuk kam bërë. Asnjëherë nuk na ke penguar, kam kaluar shumë mirë aty. Përndrysh ju keni bërë edhe dallavere. I pritni në zyrë dhe i diskutoni çështjet. Nuk ka asnjë kërkesë që vjen në drejtim të komunë për dhënie e ndonjë prone në shfrytëzim e që nuk shihet në takim me kryetarin. Përderisa kam qenë kryesues, në kërkesa bëhej të hënën, të enjten personi takohej me kryetarin, afër me Afrim Oruqin, për t'ia treguar procedurat. Nu më duket as e drejtë, e as që po bëj diçka qëllimshëm këtu. Çështjen e kam për interes të Komunës së Rahovecit. Në mendon të më ofendosh, shko deri në fund. Për postimet në facebook: Sa kam qenë kryesues i kuvendit e kam respektuar ligjin dhe jo si kolegët e tu drejtorë që e shkelin ligjin, që kanë aktakuza dhe që quhen të pandehur. Sa kam qenë kryesue e kam shfaqur neutralitetin që është dashur ta mbajë. Nëse do ta kisha qëllim pozicionin, ende do të isha kryesue: Postimet në facebook nuk i bëj për çështje të inatit, por i bëj sepse unë jam përfaqësues i qytetarëve. Kjo është arsyej që unë ju jap kritika aty ku e meritoni, njëjtë siç ka bërë kritikë për një kontratë, ku drejtori Afrim Oruqi është menaxher i kontratës. Kritikën e kam bërë me 15 janar, në Ditën e Martirëve të Luftës në Republikën e Kosovës. Në seancë më k thënë që bashkë me një veturë do të shkojmë për të përfunduar punë, unë kam shprehur gatishmëri që me vete do ta mair edhe Ilirin, por drejtori nuk e ka bërë asnjë hap për rregullimin e çështjes së varrezave të martirëve. Sa i përket pikë: jam "për" për 20 vjet. Gjithashtu unë dyshoj te ju, sepse po e lëni një hapësirë për dyshim që dikush e ka bërë kërkesën. Sa i përket në atë që kam folur me kryetarin, shkoni deri në fund, sepse jam i pastër dhe i gatshëm të dal edhe në media para qytetarëve dhe para juve këtu. Nuk mundet askush për asgjë të ma bëjë me gisht!

Kryesuesi: Një vërejtje për ju dhe të tjerët. Përderisa po flasim për një pikë, nuk kemi nevojë të tregojmë gjëra të bufe: apo të asaj që ju e pretendoni.

Ilir Pallqa: E kam një replikë me Defrimin, për çështjen e interesit. Kjo është çështje komplekse, përderisa ne po flasim që ta japim për 40 vjet, ne e kemi propozimin për 20 vjet. Nëse do të ishte në interes vetëm të komunës, më mirë do të ishte ndonjë fondacion. Kuptohet që është interes i privat. Komuna ka interes kur privati përfiton, sepse lidhet m mirëmbajtjen e asaj pjese. Interesi është patjetër i dyanshëm. Ne e kemi propozim ta vendosim për 20 vjet, më pas mun ta rrisim në mënyrën siç tha drejtori.

Lirigzon Kastrati: Qëndrojmë në tërësi pranë propozimit që e bëri shefi i grupit. Nëse ka dyshime, si ta japim për 20 si për 40 vjet është e njëjtë. Nuk është arsyeshmëri ajo që të themi, ka dyshime, por po e japim për 20 vjet. Parimi duhet të jetë që nëse ka dyshime, duhet të dalim kundër.

Nënkryetari: Faleminderit kryesues! Besoj që të gjitha këto “fjalime të kota” jashtë pikës së rendit të ditës, që i patë ish kryesuesi me drejtorin, janë konsumuar brenda pikës së dytë që është pyetje – përgjigje dhe diskutime të kuvendarëve. Ju lus sinqerisht, unë e lus drejtorin, kryesuesi e lut asambleistin. Nëse mendoni që ka dyshime, janë organet tjera përgjegjëse. Ky është propozimi. Ju e keni një propozim tjetër dhe kryesuesi e ka për obligim ta vendosë në votim. Për interesin e parcelës që jepet në shfrytëzim, besoj që është i dyanshëm. Biznesi zhvillohet, komuna e përpara qoftë me punësim dhe me veprimtari. Për të gjithë ata që ndihen keq, unë në pozitën e nënkryetarit, sinqerisht ju kërkoj falje, sepse në institucione nuk jemi ta ofendojmë njëri-tjetrin, por të punojmë në interes të qytetarëve, njëri si në periudhën kur e kërkojmë votën prej tyre.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! Të nderuar anëtarë, jemi në pikën e gjashtë dhe kemi një propozim që në vendimi për dhënien e pronës me qera 1 deri në 40 vjet, të bëhet 1 deri në 20 vjet. Ky është propozimi i Ilir Pallqës dhe si të tillë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 12 vota pro, 5 kundër dhe 4 abstenin kalon propozimi. Tani e vendosim në votim pikën e gjashtë si të tillë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 16 vota pro dhe 4 kundër dhe 1 abstenim, aprovohet pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P – 00772-10, ZK- Xërxë;

Afrim Oruqi: Ju ftoj ta votoni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me numër të njëjtë, me sipërfaqe të njëjtë. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe një nga sektori joqeveritar.

Merisa Sharku: Qëndroj prapa asaj që në komision që AAK të heq dorë nga 2 anëtarë të tjerë që i takojnë kuvendi kjo pasi ata i kanë dy anëtarë nga ekzekutivi.

Defrim Kafexhiu: Dëshiroj të plotësoj diçka në atë që thash më herët dhe pas fjalës së nënkryetarit. Kur kam qen kryesues dhe tani si anëtar i kuvendit, nuk e kam ndërruar bindjen për asnjërin nga drejtorët. Afrim Oruqi është një nga drejtorët që kam respekt më së shumti dhe që është më i përgatituri.

Feriz Thaqi: Ne e përkrahëm propozimin e Ilirit për 20 vjet, por për komision kemi propozim.

Nënkryetari: Është e vërtetë që Afrim Oruqi është më i përgatituri dhe i urojmë shëndet. Lidhjen familjare e kemi që unë Defrimin e kam tezak, Afrimin gjithashtu dhe jemi tre djemë të tezës.

Kryesuesi: Atëherë, fillojmë me propozimet e komisionit.

Hasan Përboqi: AAK, nuk ka propozim!

Leonard Morina: LVV, propozojmë Defrim Kafexhiun!

Eqrem Spahiu: LDK, nuk kemi propozim!

Rasim Fazliu: PDK, propozojmë Sejfullah Sejfullahun!

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, nga kuvendi janë Defrim Kafexhiu (LVV) dhe Sejfullah Sejfullahu (PDK), dy tjerë do të jenë nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Këtë përbërje të komisionit e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 13 pro, 4 kundër dhe asnjë abstenim, aprovohet pika e shtatë.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, P – 02680-1, ZK-Rahovec;

Afrim Oruqi: Të nderuar kuvendarë, është propozim i kryetarit të komunës, që të merret vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë personit juridik, në këtë rast Drejtorisë për Arsim, për ushtrimin e veprimtarisë arsimore – respektivisht për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, për zhvillimin e aktiviteteve edukativo-arsimore për fëmijët e Komunës së Rahovecit. Komplet parcela i ka 52 ari e 59m². Këtu bëhet fjalë për 2 ari e 27m². Afër parcelave është një fushë e vogël e futbollit si dhe ambulanca e lagjes. Sipas Ministrisë së Arsimit është vend adekuat për ndërtimin e çerdhes për fëmijë.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje edhe një herë! Po më vjen keq disi, kur po e marr fjalën në pikat e prezantuara nga drejtori. Në KPF e kemi pasur diskutim për këtë parcelë dhe për çështjen e çerdhes. Kemi kërkuar që për çerdhen që është premtuar nga Ministria e Arsimit, të ndahet një parcelë tjetër. Është një parcelë prapa Institutit të Bujqësisë dhe Verarisë, nëse nuk gaboje. Parcela gjendet te shkolla "Sadedin Hajda", por drejtoria nuk e ka parë të arsyeshme që të vazhdojë me atë parcelë aty. Jam shumë i singertë në këtë propozim dhe nuk e di a ka bazë ligjore apo formë se si të bëhet. Objekti i AMF-së aty, sa që dëmtohet prej kohës, mosfunksionimit, mungesës së stafit dhe pacientëve, propozim që objekti në fjalë t'i jepet Ministrisë së Arsimit, të rregullohet dhe të bëhet një ambient i përshtatshëm çerdhen që aty e kanë premtuar. Përndryshe, nuk është për habi, punimet atje po vazhdojnë, për shkak se zyrtarët e Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastër janë shumë aktivë dhe janë gjithmonë në terren dhe punimet kanë vazhduar deri në ditën kur e kemi mbajtur KPF-në. Këto procedura për të krijuar bazë ligjore për t'ia dhënë Ministrisë së Arsimit, po zhvillohe paasi që punimet kanë filluar. Vetëm Aleanca i din si i bënë këto punë! Propozimi qëndron!

Afrim Oruqi: Në pyetjen e kuvendarit Defrim Kafexhiu, për parcelën që është prapa Institutit të Bujqësisë, ne kemi marrë vendim bashkë me juve që ta shpallim interes të përgjithshëm për të vetmin qëllim që ta mbrojmë dhe që AKP-jam mos ta shes. Ministrisë së Arsimit ia kemi propozuar tri parcela, këtë që po flasim sot, parcelën te Instituti i Bujqësisë dhe parcelën ku është planifikuar banimi i përbalueshëm dhe sipas kritereve të Ministrisë së Arsimit parcela që i ka plotësuar kushtet infrastrukturore, qasjen me rrymë – ujë, ambulancën afër etj, është kjo që është në plan. Nëse ndihet keq Defrimi që Ministria e Arsimit nuk ka mundur ta përfundojë çerdhen për tre vjet, ne mund t'i premtojmë që do të bëjmë edhe një çerdhe, sepse brenda 3 viteve i kemi bërë 3 (Xërxë, Krushë, Ratkoc). Objekti atje është bërë për ambulancë dhe jo për çerdhe, Defrim. Të ftoj ty me deputetë ta ftoni Ministrinë e Arsimit dhe ta përfundojë çerdhen. Si i përket asaj që ata janë duke punuar, puna e mbarë ju koftë. Sipas ligjit, leja nuk jepet menjëherë. Kushtet ndërtimore janë me shkrim.

Burim Krasniqi: Drejtor, a është mirë të bëjmë çerdhe? Është mirë! A e bënë Ministria apo Komuna? Cilido që mundën vetëm bëjeni. Qyteti ka nevojë për çerdhe dhe është mirë të bëhet. E dyta, ta kam bërë një pyetje në KPF, po e përsëris: A është ligjërish në rregull që të fillohen punimet para se ta merret leja e ndërtimit? A guxojnë të lëshohen kushtet ndërtimore për një pronë që nuk je titullar? A ka kushte ndërtimore?

Defrim Kafexhiu: Propozimin e kam shumë të singertë dhe shumë serioz! Sa i përket Ministrisë së Arsimit, unë ty nuk të ndërroj me ministren dhe as me 5 ministra tjerë. Përndryshe, ju zgjas edhe dorën që po i përfundoni projektet përpara se ata ta bëjnë një premtim për së dyti. Në komunë të Rahovecit janë përfunduar çerdhet më herët se sa Ministria e Arsimit që e ka pasur premtimin, ky është fakt i pamohueshëm. Lokacioni i çerdhes është për diskutim. Nëse duhet të ndërtohet atje lart, është mirë që ambulanca të shëndrrohet në çerdhe. Përndryshe ne e kemi një shembull të çerdhes në Krushë, që është larg vendbanimit dhe ka shumë pak nxënës – fëmijë. Përndryshe, tre propozimet që ia keni bërë Ministrisë së Arsimit, nuk do të ishte keq që të na bashkëngjitni në material dhe nëse vetëm kjo parcelë i ka përmbushur kushtet e Ministrisë për çerdhe, atëherë nuk kisha pasë nevojë të flas sot. Përdërisa ne kemi mungesë të informatave për propozuesit, normal që unë flas. A janë dhënë kushtet nga Drejtoria e Urbanizmit? Unë nuk e di dhe nuk jam i sigurt mund të jepen. Nëse ju do të na furnizonit me informata, do të ishte më lehtë.

Ilir Pallqa: Në atë lagje ka nevojë për një çerdhe, sepse ka shumë shtëpi banimi. AMF-ja lart nuk është funksionale askush nuk shkon, madje as ata që i kanë shtëpitë afër. A ekziston mundësia që objekti i njëjtë të kthehet në çerdhe?

Hasan Përboqi: Faleminderit! Diskutimet paraprake nga kolegët kanë qëllime të mira, por besoj që adresa është gabuar. Për të shkuar në bazë të dokumentacionit, kërkesa e ministrisë është që të pajiset me dokumentacion rreth ndërtimit të çerdhes që po bëhet. Ministria kërkon që parcela të kalojë në emër të DKA-së. Është projekt i ministries dhe komuna nuk mund ta bëjë ridestinimin sepse nuk është në kompetencë të komunës. Komuna kërkon nga ne si asambleist të votojmë që kjo parcelë të ndahet, të krijohet një parcelë e re dhe ta ketë një numër të ri, më pas të drejtohet te Drejtoria e Urbanizmit që të pajiset me dokumentacionet tjera. Unë jetoj në atë lagje dhe nëse ka nevojë në qytet për çerdhe është pikërisht kjo lagje. Sa i përket ambulances, unë para dy dite kam qenë aty dhe kam marrë shërbim. Është funksional përkundër mungesës së stafit, që ndonjëherë shfaqen edhe probleme.

Drilon Mustafa: Një pyetje për drejtorin: Parcela që është në mes a është pronë private? Nëse do të ishte e mundur ndonjë shkëmbim i mundshëm me pjesën tjetër të parcelës.

Burim Krasniqi: A duhet të ndërtohet çerdhja? Nuk e kontestoj këtë punë, jemi “për”! Pyetjet që i bëra, pse përgjigjet por e kam edhe një pyetje shtesë: Deri te kërkesa për leje ndërtimi, a ka ardhur për shkak që e ka kërkuar ministria, duk thonë që pa leje nuk e bëj investimin, apo për shkak që inspektorati ka shkuar e ka ndalë punën? Drejtori i Urbanizmit mund të përgjigjet, por nuk e di nëse ndonjë objekt komunal që investon komuna, ka leje të ndërtimit. Në qoftë investimet e komunës nuk ndërprehen, pse të ndërprehen investimet e ministrisë? Një shkollë duhet të ketë leje ndërtim një përrockë duhet të ketë leje ndërtimit, një rrugë, një kanalizim dhe një shesh, sepse për secilin investim ka rregulloj që obligon në leje të ndërtimit.

Vlora Vuçiterna: Pasi jemi te çerdhet: Cila është arsyeja që prindërit nuk lejohen ta vizitojnë çerdhen “Tulipanët” gjat regjistrimit të fëmijës për herë të parë. Secili prind dhe unë si nënë dua ta shoh vendin ku djali, apo vajza ime kalo gjysmën e ditës. A keni frikë nga gjendja jo e mirë brenda, lagështia dhe problemet tjera, apo cila është arsyeja?

Ilir Pallqa: Kërkoj falje për mosseriozitetin e shprehur, sepse jam pa gjumë. Dua mendim të sinqertë prej drejtorit dhe nënkryetarit, sepse njëmend mendojmë që kursejmë shumë para. Mendojmë që duhet ta shfrytëzojmë këtë momentum që ministria çerdhen ta bëjë në një lokacion tjetër dhe ta shfrytëzojmë këtë mundësi këtu, a mund të bëhet kjo?

Afrim Oruqi: Ka disa vjet që jemi përcaktuar për këtë edhe disa prej nesh kemi menduar që është më mirë që çerdhja të ndërtohet prapa shkollës “Bekim Sylka”, por ka qenë nën menaxhim të Agjencionit Pyjor. Disa të tjerë kemi menduar që është më mirë te Instituti i Bujqësisë, por ka qenë në proces të shpronësimit dhe ende sot figuron në emër të Agjencionit të AKP-së. Kemi menduar që është më mirë ta ndajmë një pjesë të parcelës te stacioni i autobusëve, por është kontest pronësor. Fatkeqësisht, e vetmja parcelë e komunës që i ka plotësuar kriteret dhe që ka zotim me shkri për ndërtimin e çerdhes është kjo parcelë, e keni skicën prapa në material. Në rrugë të njëjtë kemi kaluar edhe për parcelën që tashmë është AMF-ja. Sot po kërkojmë që këtë parcelë për çerdhe t’ia japim në shfrytëzim DKA-së. Urc që projekti të kryhet shumë shpejt dhe të ketë sa më shumë fëmijë.

Merisa Sharku: A është e vertetë që ka filluar ndërtimi pa pasur leje ndërtimore objekti?

Afrim Oruqi: Shumë shpejt do të fillojë edhe shkolla fillore në Pastasel, prej Ministrisë së Arsimit. Ka filluar çerdhja. Ata që janë të fushës, Driloni dhe ju, ndoshta edhe ju keni filluar ndonjë projekt pa leje dhe ia keni përfunduar edhe kulmin. Ne nuk do ta bëjmë kështu, por do ta bëjmë me leje së bashku me juve. Atyre iu kemi thënë që ta vazhdojnë punën brenda kufijve. Ne vetë e kemi bërë situacionin dhe janë duke punuar.

Kryesuesi: Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim tjetër, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht (15) votohet edhe pika e tetë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, të nderuar asambleistë! Auditimi i pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2023 ka rezultuar me opinion të kualifikuar, si rezultat i keqklasifikimeve në vlerë prej 284.000 dhe pagesën e kontratës kolektive. Nga ky auditim kanë dalur edhe 8 rekomandime, prej tyre 5 rekomandime të reja dhe 3 rekomandime të përsëritura. Ju njoftoj që krahasur ndër vite, Komuna e Rahovecit asnjëherë nuk ka pasur më pa rekomandime. Progresi i zbatimit të rekomandimeve nga viti 2022 në 2023, ku i kemi pasur 9 rekomandime dhe prej tyre 5 rekomandime janë të zbatuara, 2 rekomandime të paaplikueshme dhe 2 të zbatuara. Në përqindje i bie që 77% rekomandimet janë zbatuar. Në bazë të këtij raporti, ne si komunë e kemi përgatitur një komision për zbatimin e rekomandimeve. E kemi mbajtur një takim dhe në bazë të takimit e kemi përgatitur planin e zbatimit të rekomandimeve. Sa i përket kontratës kolektive, Komuna e Rahovecit si asnjë komunë tjetër nuk ka mundur t’i ekzekutojë vendimet përmbartimore dhe vendimet gjyqësore. Në bazë të Ligjit të Financave Publike dhe Përgjegjësisë, neni 40, vetëm thesari ka të drejtë t’i kryej këto punë. Ne si komunë nuk kemi të drejtë, sepse këto shpenzime janë të paplanifikuara dhe nuk kanë kod ekonomik.

Burim Krasniqi: Besoj që as ne si asambleistë, as dikush prej qytetarëve i kënaqet asaj kur një raporti i auditorit del kualifikuar, sepse kjo nuk penalizon kryetarin ose ekzekutivin, por qytetarët. Tjetra, është jo fër në raport me zyrtarë të cilët punojnë shumë në raport të performancës të komunës dhe ky kualifikim i penalizon te Granti i Performancës, dhe puna e tyre shkon huq për shkak të një keqmenaxhimi të buxhetit. Çështja e kualifikimit ndërlidhet me kontratë kolektive dhe me procedurat përmbartimore. Ndoshta nuk është parimore pse ka dalur kështu, por auditorët janë të thirrur për këto çështje. Drejtor, janë 8 rekomandime, 3 të përsëritura dhe asnjë nuk është pjesërisht i përsëritur. T

rekomandimet e reja, çështja A3: Mungesa e menaxhimit të të hyrave të tatimit në pronë, kur thuhet që janë 1 identifikuar 428 tatimpagues që nuk kanë numër personal, të cilëve iu ka zvogëluar vlera e tatimit në pronë. Kjo ndërlidhet direkt me ju dhe konsideroj që duhet të keni kujdes, sepse kam thënë që nuk ka arsye që numri kaq i madh qytetarëve të kenë fatura me zero tatim në pronë, duke filluar nga vetja ime personale (prindit tim). Çështja 4 Kontraktimi i projekteve të parapara me buxhet, në mungesë të mjeteve financiare dhe zgjatja e afateve të realizimit të projekteve më gjatë se sa ofertimi. Drejtor, si ka mundur të bëhet zotimi i mjeteve për ta shpallur një tender, kur nuk ka pasur mjete? A nënkupton që është nënshkruar nga zyrtari kryesor financiar një dokument fiktiv, një dokument pa para? E kemi rastin e zgjatjes së projekteve. Të kërkoj të na japësh një informatë me shkrim, apo në seancën tjetër, për 4 raste që janë të identifikuar prej auditorit. Janë raste shumë shqetësuese. Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec, i kontraktuar me 20.10.2023, në vlerë prej 2.9 milionë, thuhet që: Ishte udhëhequr procedura e prokurimit me kriteret e dhënies së kontratës çmimi ekonomik më i favorshëm, me poentim 20% për planin dinamik. Kur është futë poentimi, operatori ka marrë 20% të poenave të planin dinamik më të shpejt për realizimin e kontratës. Në anën tjetër kur është nënshkruar kontrata, projekti i cili është ofruar të bëhet për 450 ditë, në kontratë iu kanë dhënë 960 ditë. A ka qenë më i liri? I dyti, apo i treti? Ky 20% i poenave, a i ka mundësuar që ai të jetë fitues? Nëse ky ka qenë më i shtrenjtë se i pari dhe 20% ia ka mundësuar ta merr kontratën dhe 450 ditëshin në kontratë i është bërë 960 ditë, këtu duhet të jà dikush përgjegjës! Është manipulim, është kurditsje! Të njëjtën situatë e keni te ndërtimi i rrugëve në hapësirat për biznes dhe turizëm, rreth 2 milionë € dhe është përdorur 20% i poenave të plani dinamik. Plani i realizimit të projektit në ofertë ka qenë 225 ditë, në kontratë ia kanë bërë 480 ditë. Gjithashtu edhe te ky rast (operatorët i din), i shti ka qenë në listë të ofertës me çmim? Ka qenë më i liri, i dyti a po i treti? Ndërkohë, pres përgjigje, ose do të kërkojmë çasje në dokumente zyrtare, sepse kam miq që kanë çasje në E-prokurim në detaje. Rasti tjetër, ndërtimi i rrugëve lokale, lot i i nënshkruar me 1.11.2023 që e ka vlerën 900.000€ dhe është përdorur i njëjti standart i 20 %. Në kontratë me planin dinamik kanë qenë 225 ditë, kontrata është nënshkruar për 480 ditë. A ka qenë edhe ky më i liri? Apo më i shtrenjtë se sa dy të parët, apo tre. Ndërtimi i shtegut të ecjes dhe turizëm, në Rahovec, Drenoc, Polluzhë, Xërxë, Optrushë. Kontrata është e nënshkruar më 23.11.2023, vlera 119.595€ dhe është përdorur i njëjti kriter. Pa dashur ta luaj hetuesin apo drejtësinë, mendoj që këtu ka dyshim që ka manipulim. Për të qenë korrekt në raport me neve si asambleistë dhe në raport me qytetarin, pres që kjo situatë të sqarohet ndërkohë. A kanë qenë më të lirë këta operatorë ekonomikë apo 20% i poenave u ka mundësuar që operatori më i shtrenjtë ta fitojë tenderin, sepse këtu kemi të bëjmë me dëmtim direkt të buxhetit të Komunës së Rahovecit. E kemi rastin e pranimi të furnizimit të autoambulantës, çështja A5 thotë që ka modifikim. Nuk ka ardhur autoambulanca që është kërkuar në dosje të tenderit. Pse nuk kthehet pas kjo autoambulancë? Pse nuk hyn në listë të zezë furnizuesi i autoambulancës? Pse nuk dërgohet në pranim teknik? Auditori e ka pa dikush duhet të jap përgjigje! Te çështja e realizimit të projekteve kapitale janë të zvarritura me vite dhe jo me muaj. A krijon situatë kur operatori rrezikohet financiarisht për shkak të rritjes së çmimeve? A ka pasur raste kur këto zvarritje kanë bërë situata kur ata kanë kërkuar rishikim të ofertës? Sa po e mbajnë financiarisht stabile situatën këto projektet përveç që janë në ekzekutiv e sipër, ka edhe fatura në pritje. Po pyes për të ardhme, se ku na qon kjo situatë e vonësav të investimeve kapitale, gjegjësisht ka investime kapitale që figurojnë të përcaktuara dhe faktikisht janë të përfunduara vetëm që nuk ka situacion përfundimtar të pranimi të pranimi të projektit. Te kjo çështje, e kam një pyetje që ndërlidhet me raportin e auditorit: A është obligim ligjor, që për pagesën e një kontrate të ketë pranim teknik të projekteve, sipërligjit për ndërtim? Komuna e Rahovecit nuk e praktikon pranimin teknik me arsyetimin se pranimi i situacionit të fundit nënkupton pranimin teknik. A është i obligueshëm pranimi teknik? Te çështja B2: Urdhër të blerjes pas pranimi të faturës. Janë 26 raste me vlerë 1 milion € dhe janë vonuar 2 muaj, dy ditë, deri në 2 vite vonës dhe nuk janë bërë brenda 30 dite. Drejtor, nëse nuk ka mjete, pse po pranon fatura? Kjo, a e rrit rrezikun që këta furnitorë ta dërgojnë në përmbardim? Zyrtarët përgjegjës duhet të kenë kujdes te ekzekutimi i projekteve dhe te pranimi i faturave. E fundit, që ndërlidhet me vonesat e realizimit të projekteve, janë edhe 11 vonesa – pagesa me rreth gjysmë milioni €, që janë të gjetura nga mostrat dhe që janë vonesa 2 javë deri në 2 vite. Për ta përmbledhur në fund këtë diskutim, e shifni: përsëritën papërgjegjësitë e këtyre gjërave, futja në rrugë pa “kry”, apo janë veprime të qëllimshme, pavarësisht pasojave në nesër? Faleminderit!

Leonard Morina: Meqenëse ky raport është për të gjithë asambleistët, Burimi i tha të gjitha. Mirëpo, unë do të ndalej në dy çështje që janë shumë më shqetësuese. Komuna e Rahovecit sipas raportit të auditorit ka bërë keqklasifikimin mjeteve, me ose pa dashje. Në raport thuhet që, keqdeklarimi mund të vije nga mashtrimi, apo gabimi. Ju, ose keni dashur të mashtrini, ose keni gabuar qëllimshëm. Te çështja A4, kam thënë që kush po i monton kaq mirë këta tendera!? Një tender është ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec, i cili është 2.982.000€ dhe është thënë në parakusht që, ata që e kryejnë punën më shpejtë i fitojnë 20% poena për ta fituar tenderin. Del që, operatori që e ka fituar tenderin ka thënë që unë këtë punë e kryej për 450 ditë dhe sipas kësaj, për shkak të planit dinamik e ka fituar tenderin. Komisioni ia zgjatë ditët, e bën që projekti të përfundojë për 960 ditë. Nëse operatori tjetër i ka pasur 700 ditë, ku mbetet ai operator që nuk e ka fituar tenderin? A guxojnë të ndërrohen kriteret gjatë rrugës? Të njëjtin rast e kemi te ndërtimi i rrugëve lokale me vlerë 898.000€ dhe për shkak të planit dinamik i ka fituar 20% të pikëve, që këtë projekt ta përfundojë për 225 ditë, ndërsa komisioni ia shton ditët dhe ia bën 480. Unë mendoj që këtu ka keqpërdorim, dikush ia ka marrë dorë këtij montimi, por zyra e auditorit i ka gjetur, si dhe besoj që operatorët që kanë qenë konkurrentë me këta, të merren më shumë me këto punë dhe të dalin para drejtësisë manipulorët. Te çështja A5, te ambulancat: Komuna ka hapur tender për dy autoambulanta në vlerë prej 109.988€. Komuna, sipas specifikave të tenderit ka kërkuar ambulanta që janë jo më shumë se 8 ulëse. Vijnë autoambulancat, pranohen dhe nuk kanë ulëse, janë për bartjen e mallrave. Meqenëse kam qenë drejtor shkolle, komisioni e bën pranimin e mallit. Këtu ka qenë një komision që duhet t'i pranojë këto dy ambulanta, që secila prej tyre ka kushtuar 51.000€. Komisioni që e ka bërë pranimin e ambulantave, kjo gjendje është shumë e çuditshme. Këtu, ose ka mashtruar operatori, ose komisioni ka dashur të mashtrohet vet prej operatorit. Këtu po del që dikush është shumë i guximshëm dhe guximi po ia vlenë. Mbetet të shihet se kush i ka pranuar këtë autoambulantca dhe pse nuk janë pranuar sipas specifikave të tenderit.

Sejfullah Sejfullahu: Për të mos i përsëritur të gjitha që i thanë, pajtohem edhe me parafolësit lidhur edhe me qendrën rinore, me autoambulancat dhe me ato rrugët tjera që i diskutuam. Nuk po ndodh asgjë rasisht. Herën e parë më kujtohu kryetari kur ka thënë, përderisa ka qenë Vlora Spanca dhe nëse e ka bërë të padrejtë auditori, atëherë ne duhet ta padisin sepse nuk duhet ta rrezikojmë grantin e performancës dhe subvencione të tjera. Sot, kur po e dëgjojmë këtë 20% poenave dhe prej 450 ditë në 900 ditë. Ajo sikur i ka dëgju fjalët e mia dhe na ka dërguar një dëshmi që këtu është bërë një shkelje e madhe dhe siç tha parafolësi, këtu dikush njëmend i guximshëm. Kjo i bie që këtu po bëhen investimet në bazë të operatorëve ekonomik dhe jo në bazë të kërkesave të qytetarëve. Për drejtorin e financave, pse disa rekomandim po na përsëriten gjithmonë?

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! I nderuar ekzekutiv, kolegë anëtarë të kuvendit. Raporti i auditorit të jashtëm është pasqyra e vertetë që si qeveriset dhe menaxhohet Komuna e Rahovecit, po ashtu edhe paraja publike taksapaguesve tanë. Në përgjithëse raporti paraqet gjendje shqetësuese dhe konsideroj që problematika kryesore qëndrojnë në keqmenaxhimin e parasë publike, me apo pa qëllime të caktuara. Disa çështje u përmendën nga kolegët, në menaxhimin e projekteve kapitale, shkeljet ligjore në prokurim publik, vonesat e projekteve. Unë dëshiroj të ndërlidhem te një çështje tjetër sa i përket këtij raporti: Te çështja e përmbarimeve gjyqësore. Në këtë raport është cekur se në përmbarimet e vendimeve gjyqësore komunës i janë marrë më shumë se 200.000€ për një vit kalendarik. Në këtë drejtim kërkoj nga kryetari apo ekzekutivi që përmes përfaqësuesit ligjor të na sqarojë, që nëse ka mundësi komuna t'i lehtësojë procedurat e realizimit të të drejtave të punëtorëve të arsimit pa shpenzime enorme prej të cilave ngarkohet komuna. Konsideroj që kemi mundësi ligjore që komuna t'i lehtësojë këto shpenzime përmbarimore dhe gjyqësore, përmes procedurës së ndërmjetësimit, që mos ta kemi këtë lloj të shpenzimit të parasë publike në mënyrë enorme.

Defrim Kafexhiu: Besoj që dallimi i raportit të ZKA-së ka ardhur me një pikë, ku vetëm që dallimi i viteve paraprak duhet të jetë që prokuroria duhet të marrë hapa të duhur dhe t'u kërkojë përgjegjësi atyre që i bëjnë shkeljet. Besoj që ZKA-ja ka ndryshuar pak, meqë pushteti qëndror është ndryshuar dhe puna e Aleancës ka variuar në bazë të ndikimit që ju në pushtet lokal e keni bërë në zyrën e ZKA-së. E kemi rastin e para dy viteve, ku kryetari ka shkuar jo në formë institucionale dhe ka kërkuar llogari pse të jetë raporti i kualifikuar, sepse Komuna e Rahovecit penalizohet në grantin e performancës. Ne duhet të dimë që nëse granti i performancës do ta ketë si kriter raportin e kualifikuar, atëherë përgjegjës është kryetari i komunës që ne nuk po mundemi ta fitojmë grantin e performancës dhe jo raporti i ZKA-së të jetë shkaktari që komuna nuk po e fiton grantin. Kryetari, çasjen e njëjtë nuk e ka vetëm me mua, por me secilin prej

anëtarëve të kuvendit që mendon ndryshe prej tij. Tha që, “ti ja qëllon dhe ai që nuk din ja qëllon ndonjëherë duke folë palidhje”. Kryetari Smajl Latifi është në pozitë që 11 vjet dhe është turp për Komunën e Rahovecit që raporti të jetë me rekomandime të përsëritura, të paktën 5 rekomandime. Përderi sa jemi në kuvend, për tre vite paramendojeni çka ka bërë Aleanca në Komunë të Rahovecit: Prej investimeve kapitale jepte mjete bujqësore dhe kjo është shkelje flagrant e ligjit që u bë komplet mandatin e kaluar. Kur ka ardhur raporti i auditorit nuk është vazhduar me këtë shkelje të ligjit dhe nuk e di pse organet kompetente nuk ndërhyjnë që kjo punë të gjykohej dhe të kërkohej llogaridhënie. Përgjegjësi kryesor i rekomandimeve është kryetari i komunës, për shkak të pamundësisë apo paaftësisë t’i menaxhojë punët dhe t’i parandalojë gjendjen që është shkaktuar, në këtë rast në Drejtorinë e Financave. E tha edhe Sefa, këto shkelje nuk janë të paqëllimshme, janë të përsëritura. Të bëhen projekte të reja në mungesë të mjeteve financiare, kjo ndodh vetëm në mentalitetin e krijuar të qeverisjes së Smajl Latifit. Kjo është për të ardhur keq, nuk ka duhen neve objekte me borgj. Nuk duhen institucionet, qoftë shëndetësore apo arsimore, por të bëhen siç i ka hije. Kryetari është për diçka të mirë, është për të mbledhur vota, por jo edhe për punë. Këtë gjë e ka dëshmuar edhe raporti i auditimit që për tre vite, 2 herë radhazi është negativ për Komunën e Rahovecit. Përveç që prej investimeve kapitale që janë dhënë mjetet bujqësore, që tani jepen prej subvencioneve ashtu siç duhet, prej mallrave dhe shërbimeve janë paguar shpenzimet e varrimit, si dhe gjatë periudhës që është audituar Drejtoria e Financave, kanë bërë kërkesë dhe ju kanë dhënë afat që ju të plotësoni dokumentacionin dhe ta dërgoni në Ministri të Financave dhe përsëri ka rekomandime të reja. Besoj që kryetari është lodhur duke qenë kryetar i komunës dhe ndoshta i ka ra nami, si dhe njëri nuk ka dhe për këtë arsye po vë deri të keqmenaxhimi dhe të keqklasifikimi prej ZKA-së. Për mua, si qytetar i komunës është e dhimbshme që po menaxhohet Komuna e Rahovecit në këtë formë edhe pse ligji i prokurimit ka mbi 10 vjet që është i tillë. Këto gabime janë të qëllimshme, duke filluar projektin pa zotim të mjeteve, kjo është e dhimbshme për mua dhe pa ndërhyrë prokuroria nuk do të ndërrohet ose vetëm të ndërrohet pushteti.

Afrim Limani: Komuna e Rahovecit, deri më tani nuk ka pasur raport më të mirë. E vertetë që ka ardhur nga keqklasifikimi dhe që po e humbim një mundësi të artë për grantin e performancës. Në ekzekutim të mjeteve ne nuk kemi faj, sepse nuk e kemi bërë, por e ka bërë thesari. Do të thotë nga investimet kapitale e ka paguar pozicionin e paguar. Janë 8 rekomandime dhe prej tyre janë 5 rekomandime të reja, si dhe tri të përsëritura. Konsideroj që është sukses, sepse ka rekomandime që për të dalur prej tyre është e pamundur. Nxjerrja e urdhërblereve në mungesë të faturave, besoj që vitin e ardhshëm nuk do të kemi problem me këtë rekomandim. Në çështja A3, u përmend tatimi në pronë, në raport janë 484, e në fakt nuk janë 484, por 320. Ju kemi dërguar dëshmitë dhe në fund të raportit shkruan që nuk pajtohen. Këtu janë disa tatime pagues të cilët nuk jetojnë më dhe shtëpinë e kanë të regjistruar si vendbanim. Pjesa dërmuese është komuniteti serb, kryesisht në fshatin Hoçë e Madhe dhe në lagjen e epërme në Rahovec. E kemi vështirë të identifikojmë, mirëpo, në aspektin financiar asgjë nuk reflekton. Kontraktimi i projekteve me pambulueshmëri financiare, u përmendën 3 projekte. Të tri projektet, kontratat janë lidhur pas miratimit të buxhetit më 30 shtator. Unë besoj që sipas ligjit çdo gjë është në rregull.

Burim Krasniqi: Unë nuk gjykova! Thashë që ky 20 përqindëshi a i ka mundur këtë të tretit që ta marrë kontratën në raport me të parin që ka qenë më i lirë? Besoj që si informatë mund ta marrësh prej zyrës së prokurimit dhe të na përcjellni këtu. **Afrim Limani:** Ne mund të përgjigjemi edhe me shkrim, por më së mirë kërko qasje në dokumente publike dhe e verifikon lëndën. Sipas ligjit të ri të prokurimit, situacioni i fundit është edhe pranimiti teknik. Për qendrën rinore gjithashtu është mirë të bëni kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, aty i keni të gjitha. Këtë projekt e kemi me bashkëfinancim, 300.000€ komuna dhe dhe 2.5 milionë Ministria e Kulturës. Defrimi e ngriti çështjen që nga investimet kapitale janë paguar subvencionet në bujqësi. Ne i kemi pasur të gjitha argumentet dhe dëshmitë që kemi vepruar sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, mirëpo nuk i kanë marrur për bazë. Nëse një pajisje e ka vlerën mbi 1000€, ajo është investim kapital. Gjithashtu, me secilin fermerë kemi lidhur kontratë që pajisja nuk mund të tjetërsohet brenda afatit të 5 vjet. Sa i përket prokurorisë që e përmende, të gjitha këto raporte ZKA-ja i dorëzon në prokurori.

Defrim Kafexhiu: Nuk dyshoj që raporti shkon në prokurori, unë dyshoj ndoshta edhe te prokuroria, sepse nëse ata do të vepronin siç duhet, këto gabime nuk ishin bërë. Një gjë nuk po e kuptoj, ose ata janë shumë të “keqinjtë” që Komuna e Rahovecit po ia bëjnë me qëllim, ose ju jeni shumë të mirë dhe të gjitha i bëni në përputhje me ligjin. Një korrigjim i ndërtimit të Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec: Vlera mund të luajë në projekte të mëdha që këtu është 2.

milionë, 100.000-200.000€, këtu po thotë që për vitin 2023 i keni ndarë 150.000€, për vitin 2024, 150.000 dhe për vitin 2025, 500.000€ dhe kur t'i mbledhim këto dalin 800.000€ e që nuk është as 30% i vlerës totale që ka kushtur projekt. Po flas duke u bazuar në raport. Ky planifikim ka dalur nga auditori, sepse planifikimi është bërë pa pare. Janë paraparë 800.000 për 3 vjet, për një projekt që kushton 2.9 milion dhe drejtori thotë që ka qenë gabim teknik, nuk e kemi ditur sepse është miratuar buxheti dhe nuk e kemi ditur sa mund të kushtojë. Më pas ka ardhur qeveria – shpëtimtari, që e ka financuar 2.5 milionë € dhe po e përmbyllë këtë projekt. Përndryshe ky projekt do të vazhonte me vite, njëjtë sikur rruga me 4 korsi në Xërxë, që është nën menaxhimin e juaj. Unë raportit i besoj dhe nëse ju do t'i kishit dhënë argumente e duhura për këto gabime “teknike” që i keni bërë, besoj që ata do t'ju merrnin parasysh.

Burim Krasniqi: Dua të sqarohem edhe një herë sa i përket autoambulancës. Tjerave kritere teknike doganore nënshtrihet një automjet transportues dhe tjerave kritere një automjet transportues për pasagjerë. Mjetet transportues nuk kanë akcizë, mjetet për pasagjerë kanë akcizë. Një mjet transportues ta biejmë në Kosovë, rreth 70% del më lirisë sesa një mjet për pasagjerë. Po flas profesionalisht dhe jo si asambleist. E dyta, kur diskutova nuk ishte shumë problem i buxhetit të projektet, sepse nuk është projekti i parë që fillohet pa buxhet. Këto tri kontrata që kanë fituar përmes 20% operatorët a kanë qenë më të lirët apo jo? Nëse nuk kanë qenë më të lirët, a u ka mundur 20 përqindëshi ta fitojnë kontratën? Sa është vlera e buxhetit që Komuna e Rahovecit është dëmtuar, nëse pronari ka qenë më i shtrenjtë se më i liri?

Afrim Limani: Harrova t'ju them diçka me rëndësi! Shanset për ta fituar grantin e performancës i kemi përsëri, sepse përmes asociacionit të komunave kemi kërkuar që hiqet si kriter.

Burim Krasniqi: Drejtor, nëse ka nevojë për votë në asamble, votën e LDK-së do ta kesh që t'ia mundësojmë komunë për ta marrë grantin e performancës.

Ilir Pallqa: Drejtori Përparim dhe Kryetari Latifi, mungojnë. Kryetari pse nuk vjen? E ka përfunduar takimin Ramushin. Janë 3-4 seanca që kryetari po na ik. Ne nuk dyshojmë që ai frikohet prej neve, por e ka lënë përdore çështje e nivelit komunal.

Nënkryetari: Vetëm dua t'i vërtetoj fjalët e drejtorit të Financave. Sinqerisht, asnjëherë raport më të mirë nuk ka pas Komuna e Rahovecit. Në pyetjen e Ilirit, kur nuk është kryetari aty, me ligj dhe udhëzim administrativ është nënkryetar. Nëse përsëri vendos kryetari të kandidojë për kryetar komuna, me bindje të plotë ju them që e keni përsëri në këtë karrigë të majtë edhe për një mandat tjetër.

10. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023;

Afrim Limani: Mendova që edhe këtë pikë e kam potencuar më herët. Brenda muajit, pas pranimit të raportit përfundimtar, ne e kemi përgatitur planin e veprimit. Kryetari e ka nxjerrë një vendim dhe është formuar një komision për zbatimin e rekomandimeve. Plani është dërguar në ZKA me të gjitha informatat e precizuara. Në fund të vitit fisaka besoj që mbi 80% do të realizohen rekomandimet e paraqitura.

Burim Krasniqi: Te plani i zbatimit të rekomandimeve, te çështja A4, pika 4: Te vonesat në buxhet me pagesat projekteve, keni thënë që me buxhetin 2024, orientimet 2025, 26, 27 do të mbulohen të gjitha kontratat. Në raportin financiar të 2023 keni prezantuar rreth 24 milionë obligime kontraktuale në investime kapitale, janë edhe procedurat përmbartimore dhe kur e llogaris del të jenë 25, 26 milionë obligime kontraktuale, bashkë me kontratën kolektive dhe procedurat përmbartimore. Buxheti mesatar vjetor për investime kapitale është 6.2 milionë dhe nëse shkojmë për tri vit të investimeve kapitale, buxheti për investime kapitale në total mund të jetë 18.6 milionë. Me këtë buxhet, do të mbetej edhe 5-6 milionë tjera pa u mbuluar financiarisht për ta zbatuar planin e rekomandimeve të auditorit të çështja e vonesave në realizimin e kontratave. Analizoje këtë, vërtetoje dhe përgjigju me shkrim.

Afrim Limani: Raporti i obligimeve financiare dhe vlera e obligimeve nuk është më tepër se 12 milionë. Nuk e di ku ke marrë ato shifra. Prej aty i kam ndarë dhe nuk janë vetëm investime kapitale, por kemi edhe mallra dhe shërbime. Ne, me buxhet të vitit 2025 dhe projeksione, kemi buxhet që t'ia mbulojmë financiarisht të gjitha këto kontrata.

Defrim Kafexhiu: Te plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nuk besoj që do të ketë ndonjë rezultat, përveç nëse me zbatimin e këtyre rekomandimeve merret nënkryetari i komunës. Është më serioz dhe e ftoj sepse këto lloje raporte të ZKA-së janë duke ardhur për shkak të mendësisë politike që kryetari po e udhëheq Komunën e Rahoveci.

Iliri e tha që tani nuk po ka kohë të merret me çështje lokale. Interes e ka bashkimin kombëtar, nivelin nacional. Prap po e them që, nëse me këto rekomandime merret nënkryetari i komunës, rezultati do të jetë shumë i kënaqshëm.

Sejfullah Sejfullahu: E kam një kërkesë serioze, nëse ka mundësi që kjo pikë të hiqet krejt. Këtu nuk jam as nënkryetarin, as me Defrimin. Nënkryetari tha që raport më të mirë nuk kemi pasur kurrë, atëherë nuk kemi nevojë të sanojmë rekomandimet.

Nënkryetari: Sa për informatë, unë jam udhëheqës i grupit punues për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Në asnjë pikë nuk do ta ndërroja, përderisa zgjedhjet e ka fituar kryetari i komunës. Unë jam vetëm pjesë e ekipit dhe punojm bashkërisht. Besoj që do të dalim mirë, njëjtë si në të gjitha punët që i kemi marrë për bazë t'i përfundojmë. Në dëshiron që dikush t'i ndërroj të gjitha këto, duhet që partia politike t'i fitojë zgjedhjet. Kritika e ndihmon pozitën mirëpo jo që me çdo kusht ne duhet të veprojmë ashtu siç thonë ju. Të gjitha zotimet do t'i përfundojmë deri në fund. Qëndrojmë mirë, qytetarët na vlerësojnë dhe besoj që përsëri do ta vlerësojnë punën që e kemi bërë bashkërisht.

Burim Krasniqi: Raporti financiar janar – dhjetor 2023, në seancën e 30 janarit 2024, në pikën 5.5 – obligime kontraktuale, në faqe 25, 26 dhe 27, thotë që obligimet e kontratave të mbetura janë 23.934.309.89 €. Është raport i juaj dhe jo i imi.

Afrim Limani: Unë të tregova çka kam raportuar në seancën e kaluar. E kam paraqitur raportin 6 mujor financiar. Tani po thua për raportin e dhjetorit 2023. Natyrisht që ka ndryshime, nëse ai raport i ka pasur 23 milionë, mesiguri aty 5-milionë kanë qenë mallra dhe shërbime. Vlera zbritet mjaftueshëm që me projeksione buxhetore me komoditet të mbulojmë të gjitha kontratat.

Sejfullah Sejfullahu: Kontribues për punë të mira jemi edhe ne opozita, këtë e ka thënë edhe vetë kryetari i komunës. Meqë raporti është më i miri, për këtë arsye e thash që nuk po e vazhdojmë këtë pikë të rendit të ditës. Ne i gëzohen grantit të performancës, siç e tha edhe kolegu.

Nënkryetari: Me sa të kuptova ty, the që nëse bindja juaj është që raporti është në rregull, atëherë ne nuk po diskutojmë. Të garantoj që bindja jonë është 100% në rregull. Foltorja dhe ulësja e kuvendarit është për diskutime, mbetet tek jeni nëse e diskutoni ose jo. Ekzekutivi e ka për obligim ligjërisht ta prezantojë kuvend për diskutim.

Defrim Kafexhiu: E përmendi që nesër nëse Aleanca do të jetë në opozitë. Me qenën opozitë është vështirë. Gjatë këtij mandati e vërejmë që jo të gjithë kanë mund ta përballojnë opozitarizmin. Më vjen mirë që je bartës i këtij procesi në planin e veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve dhe besoj që vullneti yt mund të ketë pozitivitet. Kryetari i komunës the që ka mbështetje, kjo është e vërtetë, sepse gjëja që më mirë kryetari e bën është të mbledhë vota. Vetë fakti që përkantoni që ta largoni si kriter grantin e performancës përmes asociacionit të komunave, kjo tregon për këtë mendim politik. Nëse ka nevojë do të qëndrojmë në opozitë ne, nuk është nevoja që Aleanca. Qëndrojmë, por, besoj që duhet ta kuptoni që interesi ynë është që gjendja të jetë më mirë në Komunën e Rahovecit.

Nënkryetari: Sa i përket opozitarizmit, vështirë që ne të jemi në opozitë. Unë kam qenë në opozitë 4 vjet, tani jemi në opozitë dhe besoj që kjo gjendje do të vazhdojë tutje. Sa i përket asaj që the që, kryetari i komunës vetëm mbledhë vota dhe nuk bën asnjë punë tjetër: Dua ta bëjë një krahasim me liderin shpirtëror, kurrfarë pune nuk ka bërë qeveria e juaj lart, përpos mbledhjes së votave. Nëse keni ndonjë punë që mund të na tregoni, urdhëroni, përpos atij 51%-it. Për punë që ka bërë, e përmendi Sefa, është ish presidenti.

11. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2023;

Nënkryetari: Është raport i MAPL-së dhe jo i yni. Komuna jonë ka një grup punues për performancë, në krye me zn Bajondina Ramaj. Janë 16 fusha dhe 85 tregues. Komuna jonë gradohet shumë mirë pothuajse në të gjithë treguesit. Rezultatet finale ende nuk kanë dalur, shpresojmë që të jemi në vend të parë ose të dytë.

12. Shqyrtimi i Raportit 6-mujor të punës së Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe;

Mehreme Gërguri Krasniqi: Përsëritet për të gjithë! Për ata që nuk më njohin, unë jam Mehreme Gërguri Krasniqi sot, në cilësinë e anëtares së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe do ta prezantoj raportin gjashtëmujor të këtij këshilli. Si këshill jemi votuar nga asambleja komunale, për secilin muaj mbajmë nga një mbledhje dhe shqyrtojmë kërkesat e qytetarëve të cilët kanë zonën e mbrojtur historike të fshatit Hoçë e Madhe. Dua të ndalem më shumë te buxheti i fshatit Hoçë e Madhe. Përveç pagave që marrin anëtarët e këshillit, kemi edhe material për zyrë, pajisje dhe laptop për zyrë. Kërkoj nga drejtori që kërkesat që i dorëzojmë si këshill i fshatit të merren parasysh, sepse buxheti i Hoçës së Madhe

është grant që vjen nga qeveria dhe kërkoj që këto mjete t'i shfrytëzojmë si këshill i fshatit Hoçë e Madhe. E kam edhe një kërkesë për kryetarin që administratori i zyrës, i cili po bënë punë shtesë, të gjenden ndonjë mënyrë që ai të kompenzohet apo të paguhet, sepse po e bën një punë të mirë. Nëse keni ndonjë pyetje jam këtu edhe pse nuk jam kompetente për raportim.

Burim Krasniqi: Nuk e di a e kanë hapur materialin, por aty është një propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të parcelën 05080 në vendin e quajtur Kraishte dhe nuk është raporti i këshillit të Hoçës së Madhe.

Defrim Kafexhiu: Unë kam qenë kryesues i kuvendit dhe kuvendi i Komunës së Rahovecit e ka buxhetin e ndarë për grantit qeveritar që miratohet çdo vit prej Komunës së Rahovecit. Besoj që është shumë që, këshilli i fshatit Hoçë e Madhe të kërkojë ta shfrytëzojë buxhetin për shkak të punës që e bën. E kam përcjellur procesin dhe punën e këtij këshilli, pagat janë rritë dhe besoj që duhet të jeni të kënaqur si këshill i fshatit. Te çështja e raportimit, nuk besoj që duhet të vijë vetëm një anëtar i këshillit, duhet të vijnë edhe tjerët. Ka nevoja tjera jetike që i ka Komuna e Rahovecit ka edhe mungesë të ujit të pijes dhe ne të kërkojmë diçka më special nuk është etike.

Mehreme Gërguri Krasniqi: Unë nuk thash që komuna nuk e përkrah këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Përkunder asaj përgjegjësinë që e kam e mbaj. Në mbledhje shkoj edhe me foshnje shtatëmuajshe, përveç në mbledhjen e parë që kam munguar me arsytim (fletëlëshim të spitalit). Këtë gjë mund ta dëshmojë Senadi që është administrator i zyrës. Unë nuk jam jashtë asaj, e di çka është jetike dhe e di çka është mungesa e ujit, por, i pata vetëm disa sqarime puna që na duhet material për zyre. Besoj që kërkesat e mia janë të arsyeshme, sikurse të juajat që i keni si anëtar i kuvendit.

Feriz Thaqi: Përhëndetje nënkryetar, kryesues! E nderuar, the që jemi për mbrojtjen e vlerave historike në Hoçë e Madhe! Çfarë vlera mbron në Hoçë të Madhe? Çfarë vlera historike ka Hoça e Madhe? Çfarë pune bëni ju, çka punoni?

Mehreme Gërguri Krasniqi: Ne jemi votuar nga ju dhe besoj që secili i dini detyrat dhe përgjegjësitë. Para se të na votojnë, besoj që e keni lexuar ligjin. Unë kam konkurruar nga shoqëria civile dhe në bazë të përvojës sime jam pranuar. I falënderoj të gjithë ata që më kanë votuar. Çdo muaj mbajmë mbledhje të rregullt për t'i shqyrtuar kërkesat e qytetarëve. Për zonë të mbrojtur historike dhe ato monumenta që janë, ju i dini më mirë se unë. Këshilli nuk ka vendosë se cilat monumente janë historike dhe cilat jo, ne veçse bëjmë një punë që është votuar nga ju.

Defrim Kafexhiu: Përveç kërkesës për administratorin, që besoj që është në rregull dhe të bëhet një zgjidhje për Senadin. Përndryshe, kërkesat tjera janë të paarsyeshme. Nëse e keni përpara raportin prej momentin që është themeluar ky këshill, tregom sa kërkesa të qytetarëve kanë ardhur? A kanë qenë mbi tre kërkesa apo jo?

Mehreme Gërguri Krasniqi: Prej muajit janar deri në këtë periudhë, e kemi pasur prej KRU Gjakovës për ta shtrir rrjetin e ujësjellësit. Unë nuk kam faj nëse nuk ka kërkesa prej qytetarëve. Pajisjet dhe letrat na duhen, sepse ne mbajmë mbledhje dhe trajnime të ndryshme me organizata të ndryshme. Mos na nënvlerësoni punën, sepse unë e kam pranuar përgjegjësinë dhe jap përgjegjësi.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, anëtarë e këtij këshilli. Ju jeni duke e kryer një punë sipas ligjit dhe udhëzimit që keni, që ne nuk duhet të ndërhyjmë në atë pjesë. Ju falënderoj dhe ju uroj suksese.

Kryesuesi: Ju falënderoj të gjithëve! Mbledhjen e quaj të mbyllur, shihemi në seancat e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport



Datë: 12.09.2024

Datë/Datum/Date:	12.09.2024
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal-Rahovec
CC:	
Nga/Od/From:	z. Afrim Dina, Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport
Subjekti/Predmet/Subject	Informatë:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport
-XIII- Nr. l prot. 37 Br. prot. 16.09.2024
RAHOVEC - ORAHOVAC

-Informatë për muajin e mërgimtarëve 2024:

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal- Rahovec.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si bartëse e të gjitha aktivitete për muajin e mërgimtarëve ju paraqet dhe informon për mbarrëvajtjen e të gjitha aktiviteteve nga 15 korrik deri më 15 gusht 2024.

Manifestimi tradicional për muajin e mërgimtarëve, nisi më 15 korrik dhe u përmbyll më 15 gusht, sipas agjendës e cila ka qenë publike, të gjitha aktivitete e organizuara janë pritur jashtzakonisht mire nga qytetarët tanë.

Kryetari i komunës z. Smajl Latifi ka pritur në zyrën e tij shumë mërgimtarë me të cilët ka biseduar për gjendjen socio-ekonomike në komunën e Rahovecit, si dhe ka dëgjuar kërkesat e tyre. Me këtë rast kryetari Latifi ju ka kërkuar mërgimtarëve që merren me biznes në vendet Perëndimore që të shqyrtojnë mundësinë e investimeve në vendlindje.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë për takime reciproke ndërmjet mërgimtarëve tanë dhe takimeve me autoritetet lokale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim edhe me drejtoritë tjera komunale si Drejtorinë për Administratë, Drejtorin e Arsimit, Drejtorin për Ekonmi, Drejtorin për Shëndetësi dhe Drejtorinë për Bujqësi kanë mbajtur aktivitete të shumta nga 15 korrik deri më 15 gusht 2024.

Aktivitetet për pritjen dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet mërgimtarëve dhe autoriteteve vendore, kanë nisur zyrtarisht më 15 korrik 2024. Në oborrin e Komunës ku u organizua ceremonia simbolike e nisjes së këtyre aktiviteteve, ku ishin të pranishëm edhe mërgimtarë.

Me vendim të Kryetarit të Komunës hapësira për parkim të automjeteve ka qenë e rezervuar vetëm për mërgimtarët dhe ky vendim është respektuar me korrektësi, gjithashtu ka qenë I hapur një sportel i veçantë për mërgimtar ku janë ofruar shërbime, nga data 15.07.2024 deri me date 15.08.2024 sa ka zgjate muaj mërgimtareve Drejtoria për Administratë ka leshuar 5469 dokumente të dryshme.

Me 19 Korrik 2024 Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në bashkëpunim me USAID-in Amerikan, ka organizuar takim me bizneset e Komunës së Rahovecit si dhe atyre në Diasporë, ku në këtë takim u prezantua lista e pronave të lira komunale që mund të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024. Poashtu në këtë takim u prezantua PZHK dhe zonat e zgjeruara me mundësi ndërtimi dhe zonat që janë dedikuar për biznese, komuna në këtë rast ka luajtur rol në ofrimin e mundësive për bashkëpunim dhe shfrytëzim të resurseve njerëzore, natyrore e materiale të komunës së Rahovecit.

Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport ka organizuar turne në futboll, shah, koncerte dhe ndeja me mërgimtarët (sofra e mërgimtarit), mbërme argëtuese në Rahovec, Xërrxe, Ratkoc, Opterushë, Dejnë, Fortesë dhe Krushë të Madhe u mbajt "Agro Festa" me 3-4 gusht ku përveq prezantimit të prodhimeve bujqësore nga perimekultura kanë prezantuar grupe dhe muzikantë të shumtë siq ishte Luiz Eli e këngëtarë të tjerë, pjesëmarrja e qytetarëve ishte shumë e madhe. Ndër aktivitetet e pëlqyeshme ka qenë edhe organizimi i veprimtarisë "Sofra e mërgimtarit", duke patur parasysh që po ju krijohet mundësia e takimeve dhe bashkëbisedimi me mërgimtarët tanë.

Përveç këtyre aktiviteteve u organizua edhe turneu në Shah për penzionista në fshatin Ratkoc ku moren pjesë edhe kurbetqarë në këtë turne, mërgimtarët kanë pasur mundësi të marrin pjesë edhe në turneun e futbollit, që u organizua enkas për dashamirësit e këtij sporti në Krushë të Madhe.

Pjesëmarrja e madhe e qytetarëve në këto aktivitete nga data 15 korrik deri më 15 gusht, është dëshmia më e mirë se organizimet kanë qenë në nivel dhe se janë përmbushur në masë të koniderueshme pritjet e mërgimtarëve tanë, aktivitete e organizuar në qytet pikërisht në rrugën "Xhevat Kaspi" janë organizuar në bashkëpunim me bizneset të cilët veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në atë pjesë, ku edhe i falenderojmë për bashkëpunim të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në muajin e mërgimtarëve.


Në të gjitha aktivitetet e mbajtura kanë qenë prezent Pocija e Kosovës-Stacioni Policor në Rahovec të cilët janë kujdesur për mbarëvajtjen dhe sigurinë e qytetarëve, ku shfytëzojmë rastin ti falenderojmë për bashkëpunim të cilët janë të gatshëm çdo here të ofojnë siguri për qytetarët.



Drejtoria për Shëndetësi e Përkujdesje Sociale, në bashkëpunim me QKMF "Dr. Fahredin Hoti", kanë organizuar kontrolle mjekësore falas në ambiente të hapura (29.07.2024). Me këtë rast janë realizuar kontrolle mjekësore nga mjekët dhe infermierët e QKMF-së.



Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë organizuar gara në futboll të vogël, gara në shah, si dhe janë përruruar objekte sportive infrastrukturore. Turneu i futbollit për mërgimtarët në Krushë të Madhe, ishte planifikuar të mbahet më 26 e 27 korrik, mirëpo për arsye të interesimit të madh për të marrë pjesë, ky turne ka zgjatur gjashtë ditë. Pjesëmarrja ka qenë masive dhe mbarëvajtja ka qenë shembullore.



Organizimi i aktiviteteve kulturore ka qenë më masiv në krahasim me vitet e kaluara. Sofra e mërgimtarit, aktivitet tradicional ky shumë i dëshiruar nga mërgimtarët, ka tërhequr vëmendjen e shumë pjesëmarrësve. Në fshatrat; Opterushë, Dejnë e Fortesë, në bashkëpunim me Këshillat e këtyre fshatrave dhe bizneseve vendore, u mbajtën aktivitete muzikore e argëtuese, që tërhoqi shumë mërgimtarë.



Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qenë shumë domethënës, me ç'rast më 2 gusht u organizua manifestimi "FARDIFEST", në Kompleksin përkujtimor e kulturor në Gradish. Në këtë festë të organizuar nga Forumi "Anadrini" (OJQ e formuar nga rahovecianët që jetojnë e punojnë në Prishtinë), pati prezantim të vlerave tona kulturore të traditës, vlera artistike muzikore tradicionale, si dhe prezantim të ushqimeve e pijeve tradicionale të zonës së Rahovecit.




Në këtë vazhdë në Krushë të Madhe, më 3 e 4 gusht, u mbajt manifestimi tradicional “AGROFESTA”, ku u prezantuan prodhimet bujqësore vendore, industria e përpunimit të perimeve, si dhe ritet e kultura popullore e kësaj zone. Pjesëmarrja e prodhuesve, përpunuesve dhe e qytetarëve ka qenë e kënaqshme, ndërsa është përmbushur edhe një synim i këtij aktiviteti – ndërlidhja e zinxhirit prodhues-përpunues-kosnumator.



Gjatë kësaj kohe nuk janë lënë në harresë as më të vegjlit, respektivisht fëmijët me nevoja të veçanta. Më 8.08.2024 në parkun e qytetit Toni e Mici u mbajt një aktivitet argëtues “Kids party”, në bashkëpunim me shoqatën e Pavarur të Gruas “Hareja”. Në këtë aktivitet morën pjesë numër i konsiderueshëm i fëmijëve dhe të rinjve, me ç’rast u organizuan lojëra e argëtime të ndryshme. Fëmijët u zbavitën shumë.



Muaji i mërgimtarëve është shoqëruar edhe me organizime të ndryshme kulturore e artistike, me ç'rast në rrugën "Xhevat Kasapi", (afër palestrës së sportit), janë organizuar mbledhje muzikore ku kanë prezantuar vlera muzikore grupe dhe artistë vendor. Organizimi i këtyre mbledhjeve është bërë në bashkëpunim me bizneset që afardojnë në këtë rrugë, Komunës së Rahovecit (DKRS) dhe shoqërisë civile.



Organizimet e shumta për mërgimtarët janë përmbyllur me ceremoninë e ndarjes së Dekorates Komunale për Humanizëm "Dr. Ali Sokoli", aktivitet që u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës, ku ishin të pranishëm numër i konsideueshëm qytetarësh e veprimtarësh. Kjo dekoratë iu nda mjekut në pension, kirurgut të mirënjohur Dr. Sadri Bajraktari.



Ndonëse ishin planifikuar gjashtëmbëdhjetë aktivitete të ndryshme, gjatë kësaj kohe janë realizuar gjithsej 25/26 aktivitete kulturore, artistike, sportive dhe aktivitete të tjera që ndërlidhen me mërgimtarët tanë, vlenë të cekët se për muajin e mërgimtarëve kontribut të madh ka dhënë shoqata “Vizioni i Rinisë për Integritet Social”, këshillat lokale të fshatarave si dhe të rinjtë e komuns sonë.

Sipas të dhënave të vëzhguesve tanë, në këto aktivitete duke filluar nga Qyteti e në të gjitha vendbanimet tjera ku janë mbajtur aktivitete kanë marrë pjesë rreth 20,000 mijë qytetarë.

Konsiderojmë se, të gjitha aktivitetet kanë pasur ecuri normale dhe nuk janë regjistruar incidente apo ngecje në procesin e përmbushjes së programit të paraparë.

Rahovec, shator2024

Drejtori i DKRS-së





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ORAHOVACIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Nr. i prot. 116
Br. prot. 13.09.2024
RAHOVEC - ORAHOVAC

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim

Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

Informatë nga DKA për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025

Përshëndetje të nderuar!

Drejtoria Komunale për Arsim, ashtu sikur edhe viteve të tjera është angazhuar maksimalisht t'i bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025.

Më 2 shtator 2024, ditë e hënë, filloi viti i ri shkollor 2024/2025 në të gjitha shkollat e komunës sonë dhe nëpër çerdhe. Gjatë muajit gusht, DKA ka bërë përgatitjet e duhura në planifikimin e orëve dhe kuadrit mësimor për të gjitha nivelet, e poashtu kemi organizuar dhe mbajtur trajnim për mësimdhënësit e rinj në disa nga fushat kurrikulare. Ky trajnim është mbajtur për mësuesit dhe edukatorët e programit fillor dhe parafillor, për fushën kurrikulare të shkencave të natyrës, për fushën kurrikulare të matematikës dhe për fushën kurrikulare të shkencave shoqërore (shoqëria dhe mjedisi).

Procesi mësimor filloi, por edhe në këtë fillim viti u shkaktua problem për shkak të mungesës së furnizimit me tekste mësimore. Kjo për shkak se MASHTI përsëri, ashtu sikur vitin e kaluar, anashkaloi DKA-të dhe vendosi që të subvencionojë prindërit për blerjen e teksteve. Edhe sot e kësaj dite kemi mungesë furnizimi me tekste adekuate shkollore për nxënësit e klasave 1 deri 9, sepse Shtëpitë Botuese nuk kanë sjellë në të vetmen librari të qytetit fondin e mjaftueshëm të teksteve.

Ky vendim i përsëritur i ministries, shkaktoi edhe vonesë në furnizimin me libra e tekste shkollore për nxënësit e të gjitha shkollave të komunës sonë dhe telashe dhe tollovi pranë librarisë në qytet nga ana e prindërve. Gjatë ditëve të para të shtatorit jemi angazhuar që sadopak t'u dalim në ndihmë prindërve përmes mësuesve dhe drejtorëve të shkollave që ata ta kenë më të lehtë të orientohen për tekstet që duhet t'i blejnë për fëmijët e tyre, por edhe për t'i udhëzuar ata se si të aplikojnë në platformën e-Kosova për rimbursimin e mjeteve.

Për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve, ka ndodhur edhe zvogëlimi i numrit të klasave dhe rrjedhimisht kjo ka ndikuar që disa mësimdhënëseve t'u zvogëlohet fondi i orëve, sidomos në Shkollat e Mesme të Larta. Ne jemi kujdesur maksimalisht që planifikimin e orëve dhe kuadrit

arsimor ta bëjmë në mënyrë parimore, duke iu përmbajtur të gjitha ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi.

Aktivitetet kryesore që zhvilluam rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor, ishin këto:

- ❖ Në kuadër të projektit të mirëmbajtjes dhe rregullimit të hapësirave të brendshme, janë zhvilluar punime në riparimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e nyjeve sanitare në objektin e SHML "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe;
- ❖ Çerdhja për fëmijë në Xërxë u pajis më në fund me inventarin e kuzhinës, i cili i mungonte;
- ❖ Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, kanë përfunduar riparimet e brendshme në objektin e SHFMU "Skënder Kastrati", paralelja e ndarë në Gexhë;
- ❖ Në datat 19, 20 dhe 21 gusht është zhvilluar procesi i regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta, në 3 SHML dhe në IAAP;
- ❖ Patëm një vizitë verifikuese nga komisioni I MASHTI-t në 3 çerdhet e reja të ndërtuara, të cilat së shpejti edhe zyrtarisht do të themelohen si institucione të reja të edukimit parafillor;
- ❖ Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, kanë përfunduar riparimet e brendshme në objektin e SHFMU "Gëzim Hamza-Piktori" në qytet;
- ❖ Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë, Ratkoc dhe Pastasel, gjatë muajit gusht, kanë vazhduar punimet. Punime janë zhvilluar edhe në ndërtimin e çerdhes së re në lagjen e epërme në qytet;
- ❖ Gjatë muajit gusht, po ashtu ka përfunduar edhe ndërtimi i rrethojës së oborrit të Çerdhes për Fëmijë "TULIPANËT";
- ❖ Përfundoi edhe trajnimi i 3 grupeve të mësimdhënësve dhe edukatoreve, i cili zgjati 6 ditë me radhë dhe u zhvillua në ambientet e SHFMU "Isa Boletini";
- ❖ Para fillimit të vitit të ri shkollor zhvilluam një takim me drejtorët e shkollave, kryetarët e KDSH-ve dhe me koordinаторët e cilësisë. Gjithashtu, mbajtëm edhe dy takime në SHFMU "Katër Dëshmorët" dhe në SHML "Ukshin Hoti";
- ❖ Të shtunën, më 31 gusht 2024, u mbajt Provimi i Maturës për maturantët, i vlefshëm për afatin e gushtit, për të gjithë ata maturantë që në qershor nuk e kishin arritur pragun e kalueshmërisë.
- ❖ Përfunduam me procesin e planifikimeve të orëve mësimore dhe kuadrit arsimor për vitin e ri shkollor 2024/2025.





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opštine Orahovac / Municipal of Rahovec

Department of Finance and Budget

Planifikimi i Investimeve kapitale 2023-2025

				(1,193,972.00)	5,651,323.00	5,013,228.00	637,904.00	5,651,132.00	5,254,228.00	821,113.00	6,075,341.00	5,602,144.00	771,328.00	6,373,472.00	5,777,544.00	871,141.00	6,648,685.00	
Nënprogramet,kodet,përshkrimi dhe kodet e projekteve			2023			2024			2025			2026			2027			Totali
		VITI	Grandi	THV	Totali	Grandi	THV	Totali	Grandi	THV	Totali	Grandi	THV	Totali	Grandi	THV	Totali	
		TOTALI	4,039,948.00	417,403.00	4,457,351.00	4,982,918.80	747,904.00	5,730,822.80	5,254,228.00	821,113.00	6,075,341.00	5,602,144.00	771,328.00	6,373,472.00	5,777,544.00	871,141.00	6,648,685.00	22,636,986.80
						30,309.20	-110,000.00	-79,690.80	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
16311		Administrata	23,000.00	5,000.00	28,000.00	-	45,000.00	45,000.00	29,500.00	-	29,500.00	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	102,500.00
53789	Vazhdim	Ndërtimi i E- Kioskut	23,000.00	5,000.00	28,000.00			0.00			0.00			0.00			0.00	28,000.00
47994	Vazhdim	Riparim i objekteve të gjendjes Civile -			0.00		20,000.00	20,000.00			0.00			0.00			0.00	20,000.00
49841	i ri	Vendosja e ashensorit në objektin e ndërtesës së Komunës	0.00		0.00		25,000.00	25,000.00	29,500.00		29,500.00			0.00			0.00	54,500.00
16621		Inspeksioni	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	-
			-		0.00			0.00			0.00			0.00			0.00	-
17511		Buxhet e Financa	142,000.00	47,000.00	189,000.00	100,024.00	10,000.00	110,024.00	53,524.00	50,000.00	103,524.00	248,374.00	50,000.00	298,374.00	50,000.00	50,000.00	100,000.00	800,922.00
53782	Vazhdim	Projekte me donatorë - Vazhdim	142,000.00	47,000.00	189,000.00	100,024.00	10,000.00	110,024.00	53,524.00	50,000.00	103,524.00	248,374.00	50,000.00	298,374.00	50,000.00	50,000.00	100,000.00	800,922.00
18171		Shërbimet publike	710,000.00	80,000.00	790,000.00	990,000.00	70,000.00	1,060,000.00	1,090,000.00	210,000.00	1,300,000.00	1,600,000.00	150,000.00	1,750,000.00	2,380,000.00	440,000.00	2,820,000.00	7,720,000.00
53791	Vazhdim	Merentimi i rrugëve dhe trotuareve	150,000.00		150,000.00	300,000.00	0.00	300,000.00	200,000.00	30,000.00	230,000.00	130,000.00		130,000.00	200,000.00	20,000.00	220,000.00	1,030,000.00
	Vazhdim	Ndërtimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik në komunën e Rahovecit	160,000.00		160,000.00	140,000.00		140,000.00	200,000.00	30,000.00	230,000.00	400,000.00	50,000.00	450,000.00	700,000.00	50,000.00	750,000.00	1,730,000.00
53790	Vazhdim	Ndërtimi i rrugëve në Komunën e Rahovecit	330,000.00		330,000.00	400,000.00	0.00	400,000.00	300,000.00	50,000.00	350,000.00	400,000.00	50,000.00	450,000.00	800,000.00	100,000.00	900,000.00	2,430,000.00
53792	Vazhdim	Ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit në Komunën e Rahovecit		20,000.00	20,000.00		20,000.00	20,000.00	50,000.00	30,000.00	80,000.00	90,000.00		90,000.00	80,000.00	70,000.00	150,000.00	360,000.00
53793	Vazhdim	Krijimi i parkingjeve të reja në Qytet		20,000.00	20,000.00		10,000.00	10,000.00			0.00			0.00			0.00	30,000.00
53866	Vazhdim	Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale(Gropa Septike) në komunën e Rahovecit	70,000.00	20,000.00	90,000.00	150,000.00		150,000.00	100,000.00	50,000.00	150,000.00	80,000.00		80,000.00			0.00	470,000.00
	Vazhdim	Ndërtimi dhe rregullimi i Infrastrukturës në stacion të autobusëve në Rahovec		20,000.00	20,000.00		40,000.00	40,000.00	40,000.00	20,000.00	60,000.00			0.00			0.00	120,000.00
49887	Vazhdim			20,000.00	20,000.00		40,000.00	40,000.00	40,000.00	20,000.00	60,000.00			0.00			0.00	120,000.00
55182	I Ri	Ndërtimi i rrugëve në hapirat përbiznese dhe turizëm			0.00			0.00	200,000.00		200,000.00	500,000.00	50,000.00	550,000.00	600,000.00	200,000.00	800,000.00	1,550,000.00
18415		Zjarrëfiksat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	-
50715	Vazhdim	Izolimi i objektit të zjarrfikësve	0.00		0.00			0.00			0.00			0.00			0.00	-
19555		Zyra Lokale e Komuniteteve	-	20,000.00	20,000.00	-	25,000.00	25,000.00	-	20,000.00	20,000.00	-	30,000.00	30,000.00	0.00	30,000.00	30,000.00	125,000.00
53781	Vazhdim	Projekte me bashkëfinancim	0.00	20,000.00	20,000.00		25,000.00	25,000.00		20,000.00	20,000.00		30,000.00	30,000.00		30,000.00	30,000.00	125,000.00
47011		Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim rural	940,000.00	65,000.00	1,005,000.00	930,000.00	215,000.00	1,145,000.00	820,000.00	120,000.00	940,000.00	798,000.00	70,000.00	868,000.00	400,000.00	170,000.00	570,000.00	4,528,000.00
53794	Vazhdim	Kanali i kullimit të tokave bujqësore në komunën e Rahovecit (Ratkoc, Qifllak)	300,000.00		300,000.00	250,000.00	50,000.00	300,000.00	100,000.00	50,000.00	150,000.00	80,000.00		80,000.00			0.00	830,000.00
53795	Vazhdim	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve shpore (Kramovik, Xërxe, Drenoc, Opterushë, Krushë e Madhe, Rahovec)	150,000.00		150,000.00	100,000.00	55,000.00	155,000.00	100,000.00	20,000.00	120,000.00	100,000.00	50,000.00	150,000.00	100,000.00	20,000.00	120,000.00	695,000.00
53796	Vazhdim	Ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit (Bërnjakë) Hardh Fest - Faza e Dytë	50,000.00	40,000.00	90,000.00	40,000.00	10,000.00	50,000.00			0.00			0.00			0.00	140,000.00
53797	Vazhdim	Ndërtimi i objektit-depos Bujqësore Bërnjakë	70,000.00	25,000.00	95,000.00	50,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00		100,000.00	98,000.00		98,000.00			0.00	393,000.00
50726	Vazhdim	Ndërtimi i kanalit të kullimit tokave në Fortesë-Celinë	70,000.00		70,000.00	40,000.00		40,000.00			0.00			0.00			0.00	110,000.00
50717	Vazhdim	Ndërtimi i kanalit të kullimit tokave nga Shtavica deri në Fortesë	300,000.00		300,000.00	450,000.00	50,000.00	500,000.00	400,000.00		400,000.00	350,000.00		350,000.00	200,000.00	100,000.00	300,000.00	1,850,000.00
55183	I Ri	Ndërtimi i urave në komunën e Rahovecit			0.00			0.00	70,000.00		70,000.00	70,000.00		70,000.00			0.00	140,000.00
	I Ri	Ndërtim i i kanalit të kullimit të tokave bujqësore Fortesë - Celinë, Faza II			0.00			0.00	50,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00	20,000.00	120,000.00	100,000.00	50,000.00	150,000.00	370,000.00
48011		Zhvillim ekonomik	68,000.00	47,000.00	115,000.00	87,900.00	15,000.00	102,900.00	-	119,317.00	119,317.00	-	50,000.00	50,000.00	-	48,685.00	48,685.00	435,902.00
53785	Vazhdim	Investime në Zonën ekonomike në Apterushë	50,000.00	40,000.00	90,000.00	50,000.00		50,000.00		50,000.00	50,000.00			0.00			0.00	190,000.00
53786	Vazhdim	Investime në turizëm dhe shtigje të ecjes	18,000.00	7,000.00	25,000.00		15,000.00	15,000.00		69,317.00	69,317.00		50,000.00	50,000.00		48,685.00	48,685.00	208,002.00
55184	I Ri	Ndërtim i i shtandave (tezga) mobile për mbajtjen e panairëve			0.00	37,900.00		37,900.00			0.00			0.00			0.00	37,900.00
65055		Kadastra dhe Gjeodezia	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	-
			0.00		0.00			0.00			0.00			0.00			0.00	-
66360		Planifikim Urban dhe Mjedis	1,340,000.00	10,000.00	1,350,000.00	1,610,000.00	31,120.00	1,641,120.00	1,887,000.00	254,000.00	2,141,000.00	1,780,000.00	190,000.00	1,970,000.00	2,240,000.00	120,000.00	2,360,000.00	9,462,120.00
53800	Vazhdim	Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përrockave (Krushë e Madhe, Polluzhë, Radostë Dejnë, Celinë Sapniq) në komunën e Rahovecit	360,000.00		360,000.00	350,000.00		350,000.00	200,000.00	50,000.00	250,000.00	300,000.00	100,000.00	400,000.00	650,000.00	50,000.00	700,000.00	2,060,000.00
43494	Vazhdim	Ndërtimi i busteve, lapidarëve dhe pllatoeve të dëshmorëve		10,000.00	10,000.00	0.00	10,000.00	10,000.00		14,000.00	14,000.00		10,000.00	10,000.00			0.00	44,000.00
53858	Vazhdim	Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve (Celinë, Krushë e Madhe, Opterushë, Mrasor, Rahovec)	80,000.00		80,000.00	40,000.00		40,000.00	40,000.00	50,000.00	90,000.00	50,000.00	30,000.00	80,000.00	50,000.00	50,000.00	100,000.00	390,000.00
53802	Vazhdim	Krijimi i hapësirave të gjelbëruara (Rahovec, Xërxe, Kramovik, Drenc, Opterushë, Krushe e Madhe) dhe drunj dekorativë	80,000.00		80,000.00		21,120.00	21,120.00	47,000.00	20,000.00	67,000.00			0.00			0.00	168,120.00
49832	Vazhdim	Ndërtimi i Sheshit qendror të qytetit	700,000.00		700,000.00	1,100,000.00		1,100,000.00	1,350,000.00		1,350,000.00	580,000.00		580,000.00	300,000.00		300,000.00	4,030,000.00
49909	Vazhdim	Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi i shtratit të lumit Rimnik: Rahovec -Fortesë - Celinë	120,000.00		120,000.00	120,000.00		120,000.00	50,000.00	50,000.00	100,000.00	150,000.00		150,000.00	350,000.00		350,000.00	840,000.00
	I Ri	Projekti inovativ i turizmit në hyrjet-daljet e Rahovecit, me simbolet e rrushit në formë të obeliskut			0.00			0.00	30,000.00		30,000.00			0.00			0.00	30,000.00
	I Ri	Ndërtimi i kolektorit dhe shtratit të lumit Hoqë e Madhe, Brestovc, Hoqë e Vogël			0.00			0.00	50,000.00		50,000.00	400,000.00	50,000.00	450,000.00	650,000.00	20,000.00	670,000.00	1,170,000.00
	I Ri	Ndërtimi i Qendrës Përkujtimore të UÇK-së në Retijë			0.00			0.00	20,000.00	10,000.00	30,000.00			0.00			0.00	30,000.00
	I Ri	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Sapniq-faza e dytë			0.00			0.00	60,000.00	20,000.00	80,000.00	200,000.00		200,000.00	240,000.00		240,000.00	520,000.00

19,097,498.00

	I RI	Ndërtimi i rrugëve në qytet, Rr. Ibrahim Rugova, Rr. Xhelal Hajda dhe Rr. Rifat Dina			0.00			0.00	40,000.00	40,000.00	80,000.00	100,000.00		100,000.00			0.00	180,000.00
73700		Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	120,000.00	-	120,000.00	150,000.00	230,000.00	380,000.00	320,000.00	30,000.00	350,000.00	250,000.00	30,000.00	280,000.00	0.00	0.00	0.00	1,130,000.00
51928	I RI	Shtëpitë e komunitetit për përsona me nevoja të veqanta- Rahovec			0.00		230,000.00	230,000.00	200,000.00	30,000.00	230,000.00	200,000.00	30,000.00	230,000.00			0.00	690,000.00
52281	Vazhdim	Ndërtimi dhe Renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve (Ratkoc, Krushe e Madhe, Fortesë, Xerxe, Drenoc)	120,000.00		120,000.00	150,000.00		150,000.00	120,000.00		120,000.00	50,000.00		50,000.00			0.00	440,000.00
85011		Kultura, Rina dhe Sportet	371,948.00	123,403.00	495,351.00	467,000.00	70,000.00	537,000.00	367,000.00	-	367,000.00	115,546.00	184,454.00	300,000.00	37,544.00	12,456.00	50,000.00	1,749,351.00
53798	Vazhdim	Rregullimi i terreneve sportive (Xërxe, Pataqan, Nashpall, Fortesë, Krushë e Madhe)	50,000.00		50,000.00	76,000.00		76,000.00	110,000.00		110,000.00	65,546.00	4,454.00	70,000.00	37,544.00	12,456.00	50,000.00	356,000.00
53782	Vazhdim	Projekte me bashkëfinancim në Kulturë, Rini, Sport (Te kodi 53782 i financave)		10,000.00	10,000.00		10,000.00	10,000.00	10,000.00		10,000.00			0.00			0.00	30,000.00
40865	Vazhdim	Vazhdimi i ndërtimit të Shtëpisë muze "Ukshin Hoti"	60,000.00		60,000.00			0.00	20,000.00		20,000.00			0.00			0.00	80,000.00
53799	Vazhdim	Riparimi i monumente historike (Krushë e Madhe, Hoqë Vogël, Rahovec)		20,000.00	20,000.00		20,000.00	20,000.00	7,000.00		7,000.00			0.00			0.00	47,000.00
48175	Vazhdim	Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec	90,000.00		90,000.00	120,000.00		120,000.00			0.00			0.00			0.00	210,000.00
48201	Vazhdim	Restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruarit në Krushë të Madhe		5,000.00	5,000.00	0.00	5,000.00	5,000.00	20,000.00		20,000.00		40,000.00	40,000.00			0.00	70,000.00
51463	Vazhdim	Ndërtimi dhe Instalimi i ngrohjeve qendrore në objektet kulturore të komunës së Rahovecit	20,000.00		20,000.00	21,000.00		21,000.00			0.00			0.00			0.00	41,000.00
49953	Vazhdim	Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec - vazhdim	141,948.00	8,403.00	150,351.00	250,000.00		250,000.00	50,000.00		50,000.00	50,000.00		50,000.00			0.00	500,351.00
	Vazhdim	Ndërtimi i Muzeut në Krushë të Madhe	10,000.00	40,000.00	50,000.00		25,000.00	25,000.00			0.00			0.00			0.00	75,000.00
50753	Vazhdim	Ndërtimi i muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin Sulejman Krasniqi		40,000.00	40,000.00		10,000.00	10,000.00	50,000.00		50,000.00		120,000.00	120,000.00			0.00	220,000.00
	I RI	Fushat sportive dhe parqet, Nagavc, Xërxë, Rahovec, Pataqan i Poshtëm			0.00			0.00	100,000.00		100,000.00		20,000.00	20,000.00			0.00	120,000.00
92055		Arsim dhe shkencë	325,000.00	20,000.00	345,000.00	647,994.80	36,784.00	684,778.80	687,204.00	17,796.00	705,000.00	810,224.00	16,874.00	827,098.00	670,000.00	-	670,000.00	3,231,876.80
53783	Vazhdim	Riparime në shkolla (Rahovec, Qifllakë, Zoqishtë)	55,000.00		55,000.00	110,000.00	6,784.00	116,784.00	52,204.00	17,796.00	70,000.00			0.00			0.00	241,784.00
53784	Vazhdim	Furnizimi i shkollave me teknologji informative (tabela digjitale) -Vazhdim (Ratkoc, Rahovec, Vrajak, Fortes etj.)	20,000.00		20,000.00		20,000.00	20,000.00			0.00			0.00			0.00	40,000.00
51468	Vazhdim	Ndërtimi i SHFMU "Hamëz Thaçi" në Xërxë	150,000.00		150,000.00	320,000.00		320,000.00	350,000.00		350,000.00	290,000.00		290,000.00	450,000.00		450,000.00	1,560,000.00
51353	Vazhdim	Ndërtimi i aneksit të SHFMU "Katër Dëshmorët" në Ratkoc	100,000.00		100,000.00	160,000.00		160,000.00	250,000.00		250,000.00	500,000.00	16,874.00	516,874.00	200,000.00		200,000.00	1,226,874.00
55186	I RI	Rrethimi i oborreve të shkollave			0.00	47,994.80		47,994.80			0.00			0.00			0.00	47,994.80
55185	I RI	Riparime në nëntë (9) shkolla fillore dhe të mesme			0.00			0.00	25,000.00		25,000.00			0.00			0.00	25,000.00
53870	Vazhdim	Pajisje me mjete konkretizuese dhe mjete laboratorike- Vazhdim (Dejn, Kramovik, Drenoc, Polluzhe, Krushe, Opterushë)	-	20,000.00	20,000.00	10,000.00	10,000.00	20,000.00	10,000.00		10,000.00	20,224.00		20,224.00	20,000.00		20,000.00	90,224.00

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna Rahovec / Opštine Orahovac / Municipal of Rahovec
Drejtoria për Financë dhe Buxhet-Odeljenje za Finansije i Budzet
-Department of Finance and Budget



Buxheti sipas qarkores

		2024	2025	2026	2027
Totali i buxhetiit		18,610,681.00	20,982,796.00	21,995,252.00	23,032,894.00
Të hyrat vetanake		1,614,904.00	2,001,711.00	2,144,713.00	2,291,032.00
Grandi qeveritar		16,995,777.00	18,981,085.00	19,850,539.00	20,741,862.00
Grandi i përgjithshëm (adm)		7,175,251.00	9,168,059.00	9,700,883.00	10,243,423.00
Grandi për Shëndetsi		2,616,204.00	2,452,200.00	2,568,925.00	2,691,206.00
Grandi për Arsim		7,175,251.00	7,330,156.00	7,550,061.00	7,776,563.00
Sherbime Rezidenciale					
Këshilli i Hoçës së Madhe		29,071.00	30,670.00	30,670.00	30,670.00

BUXHETI 2024	Nr.Stafi		Grandi	THV			Grandi	THV		Grandi	THV		
Programet		Paga	Mallra dhe Shërbime		Totali Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione		Totali Subvencione	Investime kapitale		Totali Investime kapitale	Totali
Totali i buxhetit		10,407,314.00	2,369,340.00	97,000.00	2,466,340.00	390,000.00	10,000.00	880,000.00	890,000.00	5,013,228.00	637,904.00	5,651,132.00	19,804,786.00
		10,407,314.00	2,369,340.00	97,000.00	2,466,340.00	390,000.00	10,000.00	880,000.00	890,000.00	5,013,228.00	637,904.00	5,651,132.00	19,804,786.00
		-					-	-					
Administrata e përgjithshme		1,771,072.00	1,566,902.00	63,000.00	1,629,902.00	240,000.00	-	800,000.00	800,000.00	4,147,024.00	601,120.00	4,748,144.00	9,189,118.00
Zyra e Kryetarit	22	185,216.00	55,000.00		55,000.00			180,000.00	180,000.00	-	-	-	420,216.00
Administrata	40	262,252.00	120,000.00	28,000.00	148,000.00						45,000.00	45,000.00	455,252.00
Çështjet Gjinore	1	6,964.00	2,000.00		2,000.00				-	-	-	-	8,964.00
Inspektimet	12	106,699.00	70,000.00		70,000.00				-	-	-	-	176,699.00
Zyra e Kuvendit Komunal	31	268,759.00	17,000.00		17,000.00				-	-	-	-	285,759.00
Buxhetimi	15	121,907.00	186,902.00		186,902.00					100,024.00	10,000.00	110,024.00	418,833.00
Infrastruktura publike	4	35,815.00	510,000.00	35,000.00	545,000.00	236,000.00		50,000.00	50,000.00	990,000.00	70,000.00	1,060,000.00	1,926,815.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	203,421.00	15,000.00		15,000.00				-	-		-	218,421.00
Zyra e Komuniteteve	7	103,324.00	15,000.00		15,000.00					25,000.00		25,000.00	143,324.00
Bujqësia	11	77,246.00	90,000.00		90,000.00			440,000.00	440,000.00	930,000.00	115,000.00	1,045,000.00	1,652,246.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	53,364.00	70,000.00		70,000.00			20,000.00	20,000.00	50,000.00	15,000.00	65,000.00	208,364.00
Shërbimet kadastrale	11	88,396.00	16,000.00		16,000.00				-	-	-	-	104,396.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	59,950.00	320,000.00		320,000.00				-	1,610,000.00	31,120.00	1,641,120.00	2,021,070.00
Shërbimet sociale	15	102,625.00	10,000.00		10,000.00	4,000.00			-		230,000.00	230,000.00	346,625.00
Shërbimet kulturore	13	95,134.00	70,000.00		70,000.00			110,000.00	110,000.00	467,000.00	60,000.00	527,000.00	802,134.00
Shëndetësia		1,816,902.00	363,098.00	-	363,098.00	80,000.00	10,000.00	80,000.00	90,000.00	266,204.00	-	266,204.00	2,616,204.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	198	1,816,902.00	363,098.00		363,098.00	80,000.00	10,000.00	80,000.00	90,000.00	266,204.00		266,204.00	2,616,204.00
Arsim dhe Shkencë	878	6,819,340.00	439,340.00	34,000.00	473,340.00	70,000.00				600,000.00	36,784.00	636,784.00	7,999,464.00
Administrata e Arsimit	8	57,589.00	55,000.00		55,000.00					20,000.00		20,000.00	132,589.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	207,896.00	53,000.00	34,000.00	87,000.00	8,500.00						-	303,396.00

Arsimi fillor, i mesem I ulet	675	5,251,402.00	233,237.00		233,237.00	46,500.00				16,784.00	616,784.00	6,147,923.00
Arsimi i mesëm i larte	161	1,302,453.00	98,103.00		98,103.00	15,000.00				-	-	1,415,556.00

878,680.00878,680.00

BUXHETI 2025			Grandi	THV			Grandi	THV		Grandi	THV		
Programet		Paga	Mallra dhe Shërbime		Totali Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione		Totali Subvencione	Investime kapitale		Totali Investime kapitale	Totali
Totali i buxhetit		10,746,449.00	2,293,408.00	170,598.00	2,761,006.00	390,000.00	-	1,010,000.00	1,010,000.00	5,254,228.00	821,113.00	6,075,341.00	20,982,796.00
		10,746,449.00	2,293,408.00	170,598.00	2,761,006.00	390,000.00	-	1,010,000.00	1,010,000.00	5,254,228.00	821,113.00	6,075,341.00	20,982,796.00
Administrata e përgjithshme		1,900,078.00	1,457,068.00	136,598.00	1,890,666.00	253,000.00	-	930,000.00	930,000.00	4,934,228.00	791,113.00	5,725,341.00	10,699,085.00
Zyra e Kryetarit		197,000.00	55,000.00		55,000.00			240,000.00	240,000.00	0.00	-	-	492,000.00
Administrata		269,000.00	170,000.00	28,000.00	198,000.00				0.00	29,500.00		29,500.00	496,500.00
Çështjet Gjinore		7,200.00	2,000.00		2,000.00				0.00	0.00	-	-	9,200.00
Inspektimet		108,000.00	70,000.00		70,000.00				0.00	0.00	-	-	178,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal		268,000.00	17,000.00		17,000.00				0.00	0.00	-	-	285,000.00
Buxhetimi		135,000.00	156,402.00	53,598.00	210,000.00				0.00	53,524.00	50,000.00	103,524.00	448,524.00
Infrastruktura publike		44,000.00	585,666.00	55,000.00	640,666.00	250,000.00		110,000.00	110,000.00	1,090,000.00	210,000.00	1,300,000.00	2,344,666.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet		210,000.00	15,000.00		15,000.00				0.00	0.00	-	-	225,000.00
Zyra e Komuniteteve		107,000.00	15,000.00		15,000.00				0.00	0.00	20,000.00	20,000.00	142,000.00
Bujqësia		48,000.00	100,000.00		100,000.00			440,000.00	440,000.00	820,000.00	120,000.00	940,000.00	1,528,000.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik		60,878.00	70,000.00		70,000.00			20,000.00	20,000.00		119,317.00	119,317.00	270,195.00
Shërbimet kadastrale		99,000.00	16,000.00		16,000.00				0.00	0.00	-	-	115,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni		72,000.00	33,000.00		330,000.00				0.00	1,887,000.00	254,000.00	2,141,000.00	2,543,000.00
Shërbimet sociale		108,000.00	10,000.00		10,000.00	3,000.00			0.00	0.00	-	-	121,000.00
Shërbimet kulturore		102,000.00	80,000.00		80,000.00			120,000.00	120,000.00	367,000.00		367,000.00	669,000.00
Administrata e Arsimit		65,000.00	62,000.00		62,000.00				0.00	687,204.00	17,796.00	705,000.00	832,000.00
Shëndetësia		1,896,902.00	450,000.00	-	450,000.00	70,000.00	-	80,000.00	80,000.00	320,000.00	30,000.00	350,000.00	2,846,902.00
Shërbimet e shëndetësisë primare		1,896,902.00	450,000.00		450,000.00	70,000.00		80,000.00	80,000.00	320,000.00	30,000.00	350,000.00	2,846,902.00
Arsim dhe Shkencë		6,949,469.00	386,340.00	34,000.00	420,340.00	67,000.00	-	-	-	-	-	-	7,436,809.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet		260,000.00	55,000.00	34,000.00	89,000.00	8,500.00			0.00			-	357,500.00
Arsimi fillor		5,430,000.00	233,237.00		233,237.00	43,500.00			0.00			-	5,706,737.00
Arsimi i mesëm		1,259,469.00	98,103.00		98,103.00	15,000.00			0.00			-	1,372,572.00

7,436,809.00

BUXHETI 2026			Grandi	THV			Grandi	THV		Grandi	THV		
Programet		Paga	Mallra dhe Shërbime		Totali Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione		Totali Subvencione	Investime kapitale		Totali Investime kapitale	Totali
Totali i buxhetit		11,337,504.00	2,503,341.00	312,885.00	2,816,226.00	407,550.00		1,060,500.00	1,060,500.00	5,602,144.00	771,328.00	6,373,472.00	21,995,252.00
		11,337,504.00	2,503,341.00	312,885.00	2,816,226.00	407,550.00		1,060,500.00	1,060,500.00	5,602,144.00	771,328.00	6,373,472.00	21,995,252.00
Administrata e përgjithshme		2,072,900.00	1,658,341.00	222,885.00	1,881,226.00	261,050.00	-	980,500.00	980,500.00	5,352,144.00	741,328.00	6,093,472.00	11,289,148.00
Zyra e Kryetarit		201,000.00	60,000.00		60,000.00			250,000.00	250,000.00	0.00	-	-	511,000.00
Administrata		275,000.00	110,000.00	28,000.00	138,000.00				0.00	0.00	-	-	413,000.00
Çështjet Gjinore		7,900.00	2,000.00		2,000.00				0.00	0.00	-	-	9,900.00
Inspektimet		112,000.00	75,000.00		75,000.00				0.00	0.00	-	-	187,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal		280,000.00	15,000.00		15,000.00				0.00	0.00	-	-	295,000.00
Buxhetimi		141,000.00	190,000.00		190,000.00				0.00	248,374.00	50,000.00	298,374.00	629,374.00
Infrastruktura publike		56,000.00	590,000.00	85,000.00	675,000.00	257,550.00		120,000.00	120,000.00	1,600,000.00	150,000.00	1,750,000.00	2,858,550.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet		290,000.00	15,000.00		15,000.00				0.00	0.00	-	-	305,000.00
Zyra e komuniteteve		109,000.00	15,000.00		15,000.00				0.00	0.00	30,000.00	30,000.00	154,000.00

Bujqësia		52,000.00	90,000.00		90,000.00			450,000.00	450,000.00	798,000.00	70,000.00	868,000.00	1,460,000.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik		68,000.00	70,000.00		70,000.00			40,500.00	40,500.00		50,000.00	50,000.00	228,500.00
Shërbimet kadastrale		105,000.00	16,000.00		16,000.00				0.00	0.00	-	-	121,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni		79,000.00	275,341.00	109,885.00	385,226.00				0.00	1,780,000.00	190,000.00	1,970,000.00	2,434,226.00
Shërbimet sociale		115,000.00	10,000.00		10,000.00	3,500.00			0.00	0.00	-	-	128,500.00
Shërbimet kulturore		108,000.00	70,000.00		70,000.00			120,000.00	120,000.00	115,546.00	184,454.00	300,000.00	598,000.00
Administrata e Arsimit		74,000.00	55,000.00		55,000.00				0.00	810,224.00	16,874.00	827,098.00	956,098.00
Shëndetësia		1,989,000.00	450,000.00	-	450,000.00	70,000.00	-	80,000.00	80,000.00	250,000.00	30,000.00	280,000.00	2,869,000.00
Shërbimet e shëndetësisë primare		1,989,000.00	450,000.00		450,000.00	70,000.00		80,000.00	80,000.00	250,000.00	30,000.00	280,000.00	2,869,000.00
Arsim dhe Shkencë		7,275,604.00	395,000.00	90,000.00	485,000.00	76,500.00	-	-	-	-	-	-	7,837,104.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet		310,000.00	55,000.00	90,000.00	145,000.00	8,500.00			0.00			-	463,500.00
Arsimi fillor		5,610,604.00	240,000.00		240,000.00	48,000.00			0.00			-	5,898,604.00
Arsimi i mesëm		1,355,000.00	100,000.00		100,000.00	20,000.00			0.00			-	1,475,000.00

BUXHETI 2027			Grandi	THV			Grandi	THV		Grandi	THV		
Programet		Paga	Mallra dhe Shërbime		Totali Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione		Totali Subvencione	Investime kapitale		Totali Investime kapitale	Totali
Totali i buxhetit		11,938,391.00	2,598,000.00	274,551.00	2,872,551.00	427,928.00	-	1,145,340.00	1,145,340.00	5,777,544.00	871,141.00	6,648,685.00	23,032,895.00
		11,938,391.00	2,598,000.00	274,551.00	2,872,551.00	427,928.00		1,145,340.00	1,145,340.00	5,777,544.00	871,141.00	6,648,685.00	23,032,895.00
Administrata e përgjithshme		2,197,400.00	1,753,000.00	184,551.00	1,937,551.00	269,428.00	-	1,055,340.00	1,055,340.00	5,777,544.00	871,141.00	6,648,685.00	12,108,404.00
Zyra e Kryetarit		210,000.00	70,000.00		70,000.00			260,000.00	260,000.00	0.00	-	-	540,000.00
Administrata		285,000.00	135,000.00	28,000.00	163,000.00				0.00	0.00	-	-	448,000.00
Çështjet Gjinore		8,400.00	2,000.00		2,000.00				0.00	0.00	-	-	10,400.00
Inspektimet		117,000.00	85,000.00		85,000.00				0.00	0.00	-	-	202,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal		286,000.00	15,000.00		15,000.00				0.00	0.00	-	-	301,000.00
Buxheti		151,000.00	200,000.00	4,551.00	204,551.00				0.00	50,000.00	50,000.00	100,000.00	455,551.00
Infrastruktura publike		61,000.00	560,000.00	60,000.00	620,000.00	265,428.00		140,000.00	140,000.00	2,380,000.00	440,000.00	2,820,000.00	3,906,428.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet		295,000.00	25,000.00		25,000.00				0.00	0.00	-	-	320,000.00
Zyra e komuniteteve		115,000.00	15,000.00		15,000.00				0.00	0.00	30,000.00	30,000.00	160,000.00
Bujqësia		52,000.00	110,000.00		110,000.00			480,000.00	480,000.00	400,000.00	170,000.00	570,000.00	1,212,000.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik		74,000.00	70,000.00		70,000.00			50,000.00	50,000.00		48,685.00	48,685.00	242,685.00
Shërbimet kadastrale		110,000.00	45,000.00		45,000.00				0.00	0.00	-	-	155,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni		119,000.00	260,000.00	92,000.00	352,000.00				0.00	2,240,000.00	120,000.00	2,360,000.00	2,831,000.00
Shërbimet sociale		121,000.00	10,000.00		10,000.00	4,000.00			0.00	0.00	-	-	135,000.00
Shërbimet kulturore		114,000.00	81,000.00		81,000.00			125,340.00	125,340.00	37,544.00	12,456.00	50,000.00	370,340.00
Administrata e Arsimit		79,000.00	70,000.00		70,000.00				0.00	670,000.00		670,000.00	819,000.00
Shëndetësia		2,100,000.00	450,000.00	-	450,000.00	75,000.00	-	90,000.00	90,000.00	-	-	-	2,865,000.00
Shërbimet e shëndetësisë primare		2,250,000.00	450,000.00		450,000.00	75,000.00		90,000.00	90,000.00			-	2,865,000.00
Arsim dhe Shkencë		7,640,991.00	395,000.00	90,000.00	485,000.00	83,500.00	-	-	-	-	-	-	8,209,491.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet		360,000.00	55,000.00	90,000.00	145,000.00	13,500.00			0.00			-	518,500.00
Arsimi fillor		5,850,991.00	240,000.00		240,000.00	50,000.00			0.00			-	6,140,991.00
Arsimi i mesëm		1,430,000.00	100,000.00		100,000.00	20,000.00			0.00			-	1,550,000.00



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY	
RAHOVEC / ORAHOVAC		
Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)		
Nr./Br./No 01/249 Nr. i faq/Br.str/No.pg 70		
Data/Datum/Date 16 / 09 / 2024		

Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa për projekt - buxhetin e komunës për vitin 2025

Shtator 2024

Hyrje

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017 si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nga kuvendi i komunës së Rahovecit kanë planifikuar organizimin e dëgjimit buxhetor me datën 06.09.2024. Me datë 8.7.2024 Kryetari i Komunës Smajl Latifi me vendimin Nr: 4422 ka caktuar grupin punues i cili sipas UA Nr. 04/2023 ka organizuar dëgjimet dhe ka adresuar kërkesat e pranuar nga qytetarët në dëgjimet buxhetore.

Zyra për informim e ka bërë njoftimin sa i përket organizimit të dëgjimit buxhetor të organizuara nga anëtarët e KPF-së, ku e ka bashkëngjitur në linkun <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/08/NJOFTIM-per-mbajtjen-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitet-2025-KPF.pdf>

Ftesat dhe njoftimet për mbajtjen e dëgjimit buxhetor janë shpërndarë me kohë (14 ditë) para mbajtjes së dëgjimit, poashtu ftesat ju janë dërguar në email anëtarëve të KPF-së dhe anëtarëve të kuvendit. Gjithashtu njoftimi është shpërndarë me kohë në rrjetet sociale zyrtare të komunës.

Disa nga anëtarët e KPF-së, anëtarët e kuvendit dhe grupi punës kanë qenë pjesëmarrës në këtë takim, por, për shkak të mospjesëmarrjes së qytetarëve, ky dëgjim buxhetor i organizuar nga anëtarët e KPF-së, ka dështuar, të bashkëngjitur e gjeni lajmin për mbajtje të dëgjimit buxhetor: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/?newsct=deshton-degjimi-buxhetor-i-komitetit-per-politike-dhe-financa-i-kuvendit-komunal-te-rahovecit>

Poashtu personat përgjegjës të cekur në njoftim nuk kanë pranuar asnjë kërkesë në emailat e tyre.

Skender Hamza





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No	4687	Nr. i faq./Br.str./No.pg 172
Data/Datum/Date	4 / 9 / 2024	
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt - buxhetin e komunës për vitin 2025

Shtator 2024

Përmbajtja

Hyrje.....	2
Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt - buxhetin e vitit 2025	6
Dëgjimet publike buxhetore	7

Hyrje

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017 si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Komuna, komuna e Rahovecit ka organizuar dëgjimet buxhetore. Me datë 8.7.2024 Kryetari i Komunës Smajl Latifi me vendimin nr: 4422 ka caktuar grupin punues i cili sipas UA Nr. 04/2023 ka organizuar dëgjimet dhe ka adresuar kërkesat e pranuar nga qytetarët në dëgjimet buxhetore.

Grupi punues ka mbledhur komentet dhe në takimet e mbajtura me datë 22.8.2024 ka diskutuar kërkesat e qytetarëve dhe ka vendosur për pranimin refuzimin a po adresimin e tyre.

Sipas standardeve të UA nr 04/2023 grupi punues me shumicë votash ka vendosur sipas arsyetimeve që janë në këtë raport. Mbi kriteret e paracaktuara grupi punues ka vendosur të pranoj, refuzoj apo adresoj kërkesat që janë pranuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore. Sipas kriterëve të paracaktuara kërkesat janë trajtuar si vijon

Pranuar: Kërkesa të cilat grupi punues i ka vlerësuar nevojë për qytetarët dhe ka rekomanduar të futen në buxhetin e komunës

Pranuar pjesërisht: kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se ka nevojë dhe mund të përmbushen pjesërisht nga buxheti i komunës

Refuzuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të përmbushen nga buxheti i komunës dhe janë jashtë mandatit

Adresuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të adresohet nëpërmjet buxhetit për shkak se kërkesat adresohet nga institucionet e tjera apo mekanizmat administrativ të komunës dhe institucioneve të tjera

Raporti përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor dhe është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare. Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Të gjithë emrat dhe fotografitë e qytetarëve që janë përdorur gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë me pëlqimin e tyre. Grupi punues ka vendosur që të redaktoj dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky raport në ditën e miratimit është bërë publik dhe i është dorëzuar Kryetarit të komunës dhe Asamblesë së Komunës së Rahovecit. Në faqen e komunës në kuadër të këtij procesi janë publikuar, kalendari i dëgjimeve, plani i punës, ftesat për pjesëmarrje, raportet e shkurta nga dëgjimet, procesverbalet nga dëgjimet dhe materialet e tjera provuese të cilat janë të listuar në fund të këtij dokumenti si anekse

Sipas planit të punës komuna ka organizuar 13 dëgjime buxhetore në të cilat kanë marrë pjesë 490 qytetarë prej të cilëve 349 burra dhe 141 gra.

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo të refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt - buxheti i vitit 2025, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, është finalizuar dhe është proceduar, në Kuvendin e Komunës së Rahovecit.

Të dhëna të shkurtër për dëgjime buxhetore:

Nr	Emri dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data e mbajtjes	Nr. pjesëmarrëseve	Statusi i Kërkesa
1	Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus gratë në biznese Restaurant “Ana kafe” – Krushë e Madhe	23.7.2024	F 15 M 0 T 15	R 0 P 6 PJ 1 A 2 T 8
2	Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus bizneset Kompania “Eurofood” Xërxë	23.7.2024	F 24 M 0 T 24	R 0 P 0 PJ 0 A 1 T 2
3	Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Ratkoc, Malësi e Vogël, Dejnë, Vrajak, Bratotin, Gexhë, dhe banorëve të tjerë Ratkoc te qendra e fshatit	24.7.2024	F 3 M 63 T 66	R 4 P 53 PJ 6 A 5 T 68
4	Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Xërxë, Fortesë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe rrethinë Amfiteatri në Kompleksin e Gradishit	25.7.2024	F 8 M 12 T 20	R 0 P 14 PJ 0 A 0 T 14
5	Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët fshatrave Opterushë, Zoqisht, Retijë dhe Retijë e Ulët. Objekti i shkollës në Opterushë	26.7.2024	F 2 M 12 T 14	R 0 P 19 PJ 0 A 0 T 19
6	Dëgjimi publik me banorët e komunës së Rahovecit, me fokus banorët e fshatit Hoçë e Madhe Objekti i Shtëpisë së Kulturës	30.7.2024	F 4 M 3 T 7	R 2 P 24 PJ 4 A 0 T 30
7	Dëgjimi publik me banorët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Drenoc, Senoc, Pastasellë, Zatriq, Kaznik, Pataqan i Epërm. Objekti i shkollës fillore në Drenoc	30.7.2024	F 0 M 21 T 21	R 0 P 22 PJ 1 A 3 T 28
8	Dëgjimi publik me banorët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor. Objekti i shkollës fillore në Çifllak	31.7.2024	F 0 M 26 T 26	R 0 P 7 PJ 3 A 0 T 10
9	Dëgjim publik me banorët e Rahovecit, me fokus fshatrat Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë. Amfiteatri i muzeut “Ukshin Hoti”	1.8.2024	F 3 M 21 T 24	R 0 P 68 PJ 13 A 2 T 83
10	Dëgjim publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus punonjësit e shërbimeve publike dhe punëtorët shëndetësorë	2.8.2024	F 15 M 34 T 49	R 1 P 16 PJ 1 A 7 T 25

	QKMF “Fahredin Hoti” në Rahovec					
11	Dëgjim me qytetarët e Rahovecit, me fokus qumështarët Objekti i grumbullimit të qumështit në Ratkoc	2.8.2024	F 0	M 61	T 61	R P PJ A T
12	Dëgjimi me qytetarët e Rahovecit, me fokus përfaqësuesit e OJQ-ve, bizneseve, fermerëve, rinisë, përfaqësues të shkollave dhe grupet e interesit Salla e Kuvendit	6.8.2024	F 9	M 29	T 38	R P PJ A T
13	Dëgjim publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e lagjeve të qytetit (I, II, III, IV)	6.8.2024	F 1	M 20	T 21	R P PJ A T

Femra----:84

Meshkuj-:302

Totali-----:386

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt - buxhetin e vitit 2025

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit ka prezantuar projekt - buxhetin për vitin 2025-2027. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2024, në total prej 20.982.796.00 Euro, ku ky buxhet është ndarë në kategori, si:

1. Paga dhe Mëditje, në shumën prej 10.746.449.00 euro;
2. Mallra dhe Shërbime në shumën prej 2.761.006.00 euro;
3. Shpenzime komunale, në shumën prej 390.000.00 euro;
4. Subvencione dhe transfere në shumën prej 1.010.000.00 euro;
5. Investime Kapitale në shumën prej 6.075.341.00 euro.

Për realizimin e procesit të dëgjimeve buxhetore **Kryetari i Komunës, më 8 korrik, ka marrë vendim për caktimin e Grupit punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027.**

Grupi punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027, në këtë përbërje:

- 1.1. Ekrem Bytyqi –kryesues;
- 1.2. Skender Hamza – anëtar;
- 1.3. Ardian Rama – anëtar;
- 1.4. Egzon Thaqi – anëtar;
- 1.5. Izet Morina – anëtar;
- 1.6. Muharrem Morina - anëtar;
- 1.7. Blerta Gashi – anëtar;
- 1.8. Albion Krasniqi – anëtar;
- 1.9. Qendresa Kryeziu – anëtare;
- 1.10. Mimoza Ejupi – anëtare;
- 1.11. Bahrije Çmega = anëtare;
- 1.12. Ardit Halilaj – anëtar;
- 1.13. Kosovare Gashi = anëtare;
- 1.14. Agnesa Ramadani – anëtare.

Grupi punues ka për detyrë që të hartojë **procesin e dëgjimeve buxhetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027**, të bëjë hartimin e Planit të brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ (Mapl) Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna, të bëjë

hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetor dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime radhazi, duke bërë Planin e veprimit për dëgjimet buxhetore, përpilimin e kalendarit të dëgjimeve buxhetore dhe njoftimeve për publikim.

Plani i veprimit ka përfshirë organizimin e dëgjimeve publike nga ekzekutivi gjatë periudhës korrik-gusht, si dhe organizimin e dëgjimit buxhetor nga Kuvendi Komunal përkatësisht Komiteti për Politikë dhe Financa, 6 shtator.

Ekzekutivi komunal ka organizuar gjithsej trembëdhjetë dëgjime publike buxhetore. Njoftimi, kalendarit, Plani i veprimit dhe një dokument i detajuar mbi buxhetin, janë publikuar në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit, në Platformën Qeveritare për Konsultime Publike, në rrjete sociale, janë dërguar ftesa përmes rrjeteve sociale, e-maileve dhe direkt përmes thirrjeve telefonike, duke i ftuar pjesëmarrësit që të bëhen pjesë direkte e përgatitjes së buxhetit. (Në annex 1 materialet e publikuara)

Dëgjimet publike buxhetore

Procesi i dëgjimeve buxhetore filloi më 23 korrik, deri më 6 gusht 2024, me gjithsej 13 dëgjime publike, në të cilat qytetarët dhe grupet e interesit patën mundësi të paraqesin kërkesat dhe sugjerimet për një buxhetim sa më gjithëpërfshirës.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus gratë në biznese	23.07.2024 1orë e 15 minuta	15 pjesëmarrës 15 gra 0 burra	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

2. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus bizneset	23.07.2024 50 minuta	24 pjesëmarrës 24 gra 0 burra	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
3. Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Ratkoc, Malësi e Vogël, Dejnë, Vrajak, Bratotin, Gexhë, dhe banorëve të tjerë	24.07.2024 1 orë e 10 minuta	66 pjesëmarrës 3 gra 63 burra	8 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
4. Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Xërxë, Fortesë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe rrethinë	25.07.2024 1 orë e 13 minuta	20 pjesëmarrës 8 gra 12 burra	7 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
5. Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët fshatrave Opterushë, Zogisht, Retijë dhe Retijë e Ulët.	26.07.2024 50 minuta	14 pjesëmarrës 2 gra 12 burra	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
6. Dëgjimi publik me banorët e komunës së Rahovecit, me fokus banorët e fshatit Hoçë e Madhe	30.07.2024 1 orë e 5 minuta	7 pjesëmarrës 4 gra 3 burra	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

7. Dëgjimi publik me banorët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Drenoc, Senoc, Pastasellë, Zatriq, Kaznik, Pataqan i Epërm.	30.07.2024 50 minuta	21 pjesëmarrës 0 gra 21 burra	12 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
8. Dëgjimi publik me banorët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor.	31.07.2024 1 orë e 7 minuta	26 pjesëmarrës 0 gra 26 burra	13 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
9. Dëgjim publik me banorët e Rahovecit, me fokus fshatrat Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc, Celinë.	01.08.2024 1 orë e 5 minuta	24 pjesëmarrës 3 gra 21 burra	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
10. Dëgjim publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus punonjësit e shërbimeve publike dhe punëtorët shëndetësorë	02.08.2024 1 orë e 17 minuta	49 pjesëmarrës 15 gra 34 burra	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
11. Dëgjim me qytetarët e Rahovecit, me fokus qumështarët	06.08.2024 1 orë e 7 minuta	61 pjesëmarrës 0 gra 61 burra	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
12. Dëgjimi me qytetarët e Rahovecit, me fokus përfaqësuesit e OJQ-ve, bizneseve, fermerëve, rinisë, përfaqësues të shkollave dhe grupet e interesit	06.08.2024 1 orë e 18 minuta	38 pjesëmarrës 9 gra 29 burra	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

13. Dëgjim publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e lagjeve të qytetit	06.08.2024 45 minuta	21 pjesëmarrës 1 gra 20 burra	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
Publikimi në ueb - faqe / platforma elektronike	14 ditë para dëgjimit publik		Asnjë koment nuk kemi marrë

**1. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus gratë në biznese
Krushë e Madhe – Restaurant “Ana Kafe”- 23.07.2024 – Ora 10:00**

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus gratë në biznes është mbajtur në Krushë të Madhe me datë 23.07.2024. Takimi ka zgjatur 1orë e 15 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 15 gra

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 8 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit ne (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht Adresuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
1. Shpërndarje e vlerës së subvencioneve te punëtorët dhe jo te pronari (punëdhënësi)	Emira Duraku	Adresuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e kësaj kërkesë është në kompetencë të Komunës së Rahovecit dhe Ministrive të linjës. Grupi punues ka konstatuar se përcaktimi i rregullave të ndarjes së subvencioneve nuk mund të	DBPZHR

			përcaktohet me planifikimin buxhetor. Grupi punues ka vendosur që rekomandimin e qytetarit ta adresoj tek drejtoria ekonomisë e cila përcakton rregullat e ndarjes së granteve. GP e ka njoftuar Komuna e Rahovecit, gjatë vitit 2023 ka angazhuar praktikant me pagesë në partneritet publiko-privat, ku 11 praktikant kanë punuar në ndërmarrjet private dhe janë financuar nga komuna e Rahovecit me 50% të pagës së tyre. Kjo ka qenë një formë subvencionimi edhe për të rinjtë që kanë nevojë për një vend pune (praktik me pagesë) dhe poashtu për bizneset në të cilat kanë shërbyer këta praktikant.	
2.Rregullimi i shtratit të lumit Brestoc-Krushë e Madhe		Pranuar	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zgjidhja e këtij problemi është kompetencë e Komunës së Rahovecit. Grupi punues ka kërkuar informacione nga Drejtori e Shërbimeve Publike për këtë problematikë. Nga të dhënat e pranura është konstatuar se për zgjidhjen e këtij problem është lidhur kontrata për rregullimin e shtratit të lumit, në DUPMM, e po ashtu edhe rruga është pjesë e kontratës në DShP.	DEZHT
1. Tema: Ndihmë për gratë e reja në biznes, me tavolina dhe makina të qepjes (punëdore, rrobaqepësi)	Samire Duraku	Pranohet	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se ndarja e subvencioneve për këto kategori është në mandatin e komunës së Rahovecit. Grupi punues ka vlerësuar se subvencionimi i grave në biznes është prioritet për komunën e Rahovecit dhe buxhetimin gjinor. Në buxhetin e vitit 2025 në programet buxhetore ... gratë mund të bëhen pjesë e programeve duke aplikuar në thirrjet e hapura.	DEZHT
2. Femrat 15-19 - vjeçare t'i aktivizojmë në zanate në një qendër rinore, t'i aktivizojmë nxënëset në zanate (emancipimi i femres)		Pranohet	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se zhvillimi i aktiviteteve në fuqizimin e grave në biznes dhe në jetën publike është prioritet për komunën e Rahovecit. Grupi punues ka konstatuar se në buxhetin e vitit 2025 janë dy linja buxhetore në të cilat adresohet kjo kërkesë. Në linjën buxhetore me nrKomuna, çdo vit përmes Drejtorisë së Kulturës, subvencionon shoqatat të cilat zhvillojnë aktivitete të ndryshme. Poashtu në linjën buxhetore me nr..... komuna ndanë subvencion. Të gjitha këto subvencione dhe grante i nënshtrohen kriterëve të konkursit.	DEZHT
1.Gjendja kaotike e tregut në qendër, të bëhet urgjentisht një minitreg në Krushë të Madhe, te qendra e fshatit.	Nashide Dellova	Refuzohet	Grupi punues ka vlerësuar se kërkesa nuk mund të adresohet nëpërmjet buxhetit. Grupi punues ka konstatuar vendi ku aktualisht zhvillohet tregu në Krushë të Madhe, është	DEZHT

			përgjatë rrugës kryesore dhe nuk ka hapësirë në atë vend për ndërtimin e një tregu. GP ka adresuar këtë kërkesë për tek drejtoria e inspektoriatit	
1.Pengesa në rrugë te Kafiteria “Ana Caffè”	Arberita Malsori	Pranohet	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është në kompetencat e komunës dhe adresohet në buxhetin e vitit 2025 në kuadër të linjës buxhetore.... Mirëmbajtja e rrugëve. Grupi punues e ka adresuar kërkesen tek drejtoria përkatëse.	DBF
1.Aktivizimi (zgjedhja) e këshillit të fshatit Krushë e Madhe si nevojë imediate	Zejnije Dellova	Adresohet	Grupi punues ka konstatuar se përzgjedhja e këshillave të fshatrave është proces i cili rregullohet me udhëzim administrativ të MAPL-së dhe kërkesa nuk mund të adresohet nëpërmjet buxheut Grupi punues e ka adresuar kërkesën tek komisioni për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Kuvendit Komunal me qëllim që të rifillohet procesi aty ku ka ngecur	
1.Përkrahje me pajisje pune për bizneset Start Up	Merisa Sharku	Pranohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe i është drejtuar drejtorisë së Ekonomisë, të cilët pas një analize kanë konstatuar se në vitin paraprak janë subvencionuar bizneset start up, kështu që edhe për vitin 2025 parashihet subvencionimi edhe i bizneseve start up në vlerën monetare deri në 20 mijë euro.	DEZHT

2. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus bizneset Xërxë – Kompania “Euro food”- 23.07.2024 – Ora 14:00

Dëgjimi publik me fokus gratë në biznes është mbajtur në Xërxë te kompania “Eurofood” me datë 23.07.2024. takimi ka zgjatur 30 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 24 gra

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 2 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit ne (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
1. Krijimi i vendeve të lira të punës në sektorin e shëndetësisë	Behije Bajraktari	Pranuar	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim me zyrën e personelit dhe drejtorinë e shëndetësisë ka konstatuar se Komuna e Rahovecit ka planifikuar krijimin e vendeve të reja në sektorin e shëndetësisë duke marrë parasysh që ka nevojë ky sektor për mjekë dhe infermier pasiqë viteve të fundit ka pasur ikje të një pas njëshme për në shtetet e perëndimit.	DSHMS
1. Të rriten lehtësirat e komunës ndaj kompanive siç është Eurofood-i:	Mehmet Shala	Pranohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe i është drejtuar drejtorisë së Ekonomisë të cilët kanë konstatuar se Komuna e Rahovecit, në kuadër të ofrimit të lehtësirave për biznese, aktualisht ka 4 kontrata të lidhura për shfrytëzimin e pronës komunale, me kompaninë Euro Food, ndërsa për përkrahje financiare, mundësitë buxhetore janë të kufizuara për subvencionimin e bizneseve të mëdha.	DEZHT

**3. Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Ratkoc, Malësi e Vogël, Dejnë, Vrajak, Bratotin, Gexhë dhe banorëve të tjerë
Ratkoc – Qendra e fshatit- 24.07.2024 – Ora 19:00**

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus banorët e banorët e fshatrave Ratkoc, Malësi e Vogël, Dejnë, Vrajak, Bratotin, Gexhë dhe banorëve të tjerë është mbajtur në Ratkoc me datë 24.07.2024. Takimi ka zgjatur 1orë e 10 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 66 pjesëmarrës

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 8 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit ne (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
1. Papunësia e rinisë (vende te reja pune për rininë) dhe mundësia e rritjes së investimit në bujqësi, përkrahja e bujqve me pajisje dhe inpute bujqësore.	Ramiz Hoti	Pranuar pjesërisht	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe i është drejtuar drejtorisë së bujqësisë të cilët kanë konstatuar se Komuna e Rahovecit, në programin për zhvillimin e bujqësisë, është duke vazhduar të përkrahë fermerët në shumë sektorë. Pasi është përmbyllur faza e përkrahjes me pajisje bujqësore, tani fokusi është që të përkrahen me inpute, si: farëra, pleh, preparate etj. Po ashtu, ndërtimi i serrave është prioritet dhe do të ndodhë këtë vit dhe vitin e ardhshëm.	DBPZHR
1. Instalimi i kamerave në fshatin Ratkoc	Mustafë Krasniqi	I pranuar	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se ka kontratë për kamerat e sigurisë, mirëpo me prioritet janë ato vende që janë me prioritet të larta. Kontrata me nr.	DSHP

2. Eliminohen mbeturinat - mbetjet shtazore në fshatin Ratkoc.			Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se Komuna e Rahovecit ka kontratë me dy operatorë ekonomikë: Ekoregjionin dhe Ekodrininë, për eliminimin e të gjitha deponive ilegale. Kontratat me nr.623-23-13129-2-1-1/C546 dhe 623-21-9748-2-1-1/C350.	DSHP
1. K.R.U. "Gjakova" gjatë sanimit ta kthejë punën në gjendjen e mëparshme	Shukri Morina	Adresohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën e cila nuk ka të bëjë me provcesin e planifikimit të buxhetit, por në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se në bashkëpunim me inspektoratin do të bëhet vërejtja për kthimin e rrugës në gjendje të mëparshme.	DSHP
2. Sistemi i ujitjes të fillojë në muajin mars		Adresohet	Grupi punues në bashkëpunim me zyrtarët e drejtorisë së bujqësisë ka rekomanduar kryetarin dhe drejtorin e bujqësisë që kjo kërkesë të adresohet te K. R.U "Gjakova" përmes një shkrese zyrtare në kuader të K.R.U. "Radoniqi" - Dukagjini.	DBPZHR
Subvencionimi i qumështarëve – pika grumbulluese	Naser Morina	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën në fjalë dhe konstaton se kjo kërkesë hyn në planifikimin e rritjes së përkrahjes nga na e kryetarit andaj nga ky vit do të fillojë përkrahja për prodhuesit e qumështit. Thirrja për aplikim do të hapet në shtator 2024 dhe do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.	DBPZHR
Të bëhet një urë afër hekurudhës, tokat bujqësore Radostë-Ratkoc	Adnan Hoti	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorin e bujqësisë dhe zyrën e prokurimit ka konstatuar se pikërisht në atë lokacion është bërë projekti për ndërtimin e urës. Janë iniciuar procedurat e prokurimit, por fatkeqësisht lënda është në OShP. Me t'u zgjidhur ky problem, do të bëhet ndërtimi i urës në atë lokacion.	DBPZHR
1. Kubëzimi i rrugëve në fshatin Gexhë,	Bajram Himaj	Pranohet	Grupi punues konstaton se kjo kërkesë është veçse në planet investive të Komunës. Komuna e Rahovecit ka kontratë me operatorë për ndërtimin e rrugëve lokale. Kontrata nr. 623-23-9085-5-1-1.	DSHP
Pastrimi i kanalit të ujërave të zeza në fshatin Gexhë				DSHP

Problemi me ujë të pijes në fshatin Gexhë	Muharem Morina	Pranohet	Grupi punues konstaton se kjo kërkesë është immediate dhe në koordinim me zyrëne prokurimit dëshnon që nisur procedura e rehabilitimit të ujit për pije, në bashkëpunim me K.R.U. "Gjakova". Komuna e Rahovecit participon me 49%.	DSHP
Rregullimi i rrugëve dhe kubëzimi i trotuareve në fshatin Vrajkë		Pranohet	Grupi punues pas analizimit të kontratave të cilat janë aktive konstaton që Komuna e Rahovecit posedon kontratë për rregullimin e 14 km trotuare në tërë territorin e komunës së Rahovecit. Kontrata me nr. 623-24-2324-5-2-1 dhe kjo kërkesë do të pranohet dhe punimet do të fillojnë.	DSHP

4. Dëgjimi publik me qytetarët e komunës së Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Xërxë, Fortesë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe rrethinë"- 25.07.2024 – Ora 19:00

Dëgjimi publik me fokus gratë në biznes është mbajtur në Xërxë te Kompleksi në Gradish me datë 25.07.2022. takimi ka zgjatur 1 orë e 13 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 20 pjesëmarrës.

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverballi nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 7 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si fletat dhe procesverbalet e takimit ne (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
1.Rregullimi i kanalizimit që shkon përkaj rrugës, Xërxë-Fortesë, te livadhet, ku nga vërshimet e mëdha po shkaktohen vërshime dhe po përmythen tokat bujqësore të kësaj ane	Shani Kryeziu	Pranuar	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën dhe në koordinim drejtorinë e shërbimeve publike ka konstatuar se Komuna e Rahovecit ka planifikuar intervenimin me kohë për shkak që e dijmë që ky problem është sfidë për Xërxën dhe për Fortesën sepse ekziston rreziku i vërshimeve.	DSHP
2. A do të ketë shpërndarje të subvencioneve bujqësore, kryesisht rreth mekanizmave bujqësor?	Helami Krasniqi	Refuzohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe në koordinim me drejtorinë e Bujqësisë konstaton se nuk do të ketë më subvencione bujqësore,	DEZHT

			mekanizma, sepse është përmbyllur si proces ndër vite shpërndarja e mekanizmave, kështu që nga ky vit kemi filluar me përkrahje të inputeve bujqësore.	
3.Reenovimi dhe rregullimi I objektit të shkollës fillore në Xërxe qe te pershtatet me objektin e ri	Setki Kryeziu	Pranohet	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe në koordinim me drejtorinë e Arsimit konstaton se ne kemi kontratë të renovimit dhe riparimeve të shkollave, si dhe programin për efikasitet, që patjetër do të intervenohet në objektin e vjetër ekzistues dhe do të përshtatet më hapësirat e objektit të ri që po ndërtohet.	DKA
4.Çerdhja ka nevojë për një aneks shtesë në mënyrë që të vendoset peleti që do të shfrytëzohet për ngrohje.	Shqipe Kryeziu	Pranohet pjesërisht	Grupi punues në takimet e mbajtura pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, ka analizuar kërkesën në fjalë dhe në koordinim me drejtorinë e Arsimit konstaton se nese do të kemi mundësi shohim nëse mund të gjejmë zgjidhje për vendosjen e peletit, nëse është e nevojshme do të marrim një kontinier nga donatorë të ndryshëm	DKA
5. Pyetje rreth rrugës, Xërxë-Ratkoc, sa peshë të makinerisë lëvizëse mban kjo rrugë, sepse është shqetësuese që në këtë rrugë lëvizin makineri me peshë të rënda dhe së shpejti mund të dëmtohet	Bedri Kryeziu	Refuzohet	Grupi punues ka konstatuar që kjo kërkesë nuk ka të bëjë me planifikimet buxhetore dhe nuk ka impakt në buxhetim, mirëpo drejtori i shërbimeve publike u munadua që t'i japi përgjigje kërkesës në fjalë.	
5. Pyetje rreth tribunave të stadiumit në Xërxë, kur do të përfundojnë ato, pyetje rreth ndriçimit publik në stadium, shkollës së futbollit si dhe rreth një fushe ndihmëse afër stadiumit "KF Xërxa"	Qëndrim Thaqi	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën në fjalë dhe në koordinim me drejtorinë e kulturës konstaton se tribunat do të përfundojnë para se të fillojë sezoni vjeshtor, ku janë me një gjatësi, 70 m, dhe me një kapacitet për rreth 500 ulëse, gjithashtu do të bëhet nivelizimi i hapësirave rreth fushës, ndërsa rreth fushës ndihmëse do të kërkojmë mbështetje edhe nga Federata e Futbollit të Kosovës, në mënyrë që të shfrytëzohet edhe nga të rinjtë e shkollës së Futbollit të KF Xërxa.	

5.Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët fshatrave Opterushë, Zoqisht, Retijë dhe Retijë e Ulët.

Objekti i shkollës në Opterushë 26.07.2024 – Ora 19:00

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus banorët fshatrave Opterushë, Zoqisht, Retijë dhe Retijë e Ulët është mbajtur në Opterushë me datë 26.07.2024. Takimi ka zgjatur 50 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 14 pjesëmarrës

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 4 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit ne (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
1. Mungesa e ujit të pijes – Opterushë; Papërgjegjësia e K.R.U. "Gjakova"	Eqrem Spahiu	Adresohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike ka adresuar kërkesën te KRU Gjakova dhe menjëherë është bërë një ndërhyrje emergjente për rehabilitimin e një pjese të lagjeve "Mazreku" dhe "Krasniqi".	DSHP
1. Hapja e një rruge të re fushore, Opterushë – Zoqisht - Retijë	Enver Kabashi	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e bujqësisë dhe planifikimet investive konstaton që do të trajtohet deri në fund të vitit me kontratën e rrugëve fushore: 623-24-3803-5-2-1/C598.	DBPZHR
Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit – Zoqisht		Refuzohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e Urbanizmit ka konstatuar që Komuna e Rahovecit nuk ka kontratë për rregullimin e shtratit të lumit në Zoqisht pasi që kontrata që veçse është aktive dhe një pjesë do të mbulohet me grantin e performancës është rregullimi i shtratit të lumit nga Hoça e Madhe, deri në Krushë të Madhe	DUMM
Pastrimi i lumit në afërsi të shkollës në Opterushë	Arben Kabashi	Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e Urbanizmit ka konstatuar që Komuna e Rahovecit ka kontratë për rregullimin e shtratit të lumit në Opterushë për rregullimin e lumit në gjerësi prej 70 metra	DUMM

Rregullimi i kanalit për kullimin e ujit – Retijë	Dardan Kryeziu	Refuzohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e bujqësisë ka konstatuar që Komuna e Rahovecit nuk ka kontratë për rregullimin e kanalit të kullimit në Retijë, pasi që nuk u konstatua si zonë që rrezikohet nga përmyjtjet dhe në këto vitet e fundit më shumë u fokusua në ato zona ku ka pasur vërshime dhe janë cilësuar si zona me rrezikshmëri të lartë dhe janë më shumë zona bujqësore.	DBPZHR
Ndriçimi i rrugicave - Retijë		Pranohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë E shërbimeve publike ka konstatuar se në Retijë është bërë ndriçimi publik, ka kërkesë vetëm në disa shtylla për vendosje të poçave. Kemi kontratë me ESCO-n. Kontrata me nr. 623-22-11049-2-1-1.	DSHP

6.Dëgjimi publik me banorët e komunës së Rahovecit, me fokus banorët e fshatit Hoçë e Madhe

Objekti i Shtëpisë së Kulturës 30.07.2024 – Ora 10:00

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus **banorët e fshatit Hoçë e Madhe** është mbajtur në Hoçë e Madhe, me datë 30.07.2024.

Takimi ka zgjatur 1 orë e 5 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 7 pjesëmarrës

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbalit nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 6 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit në (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
---------------------------------	---	--	---	------------

		Pjesërisht		
Projektet e parapara për Hoçë të Madhe	Miroslav Lukic	Pranuar	ZKKK-ja do të trajtojë me prioritet problemet infrastrukturore në vendbanimet e komuniteteve joshumicë, veçanërisht kur të paraqiten kërkesat specifike dhe zyrtare nga fshati Hoçë e Madhe.	ZLK
Investimi i fundit ka qenë këtu në fshat para 3 viteve, një rrugë me kubëza. Nuk ka patur investime të reja.		Pranohet pjesërisht	ZKKK-ja nuk ka pranuar asnjë kërkesë tjetër me shkrim për ndërhyrje të tjera specifike në infrastrukturë. ZKKK-ja, së bashku me IOM-in, KFOR-in italian dhe me bashkëpunëtorë të tjerë, ka ndërhyrë në disa projekte kapitale, duke përfshirë kubëzimin, rinovimin e qendrës kulturore, inventarizimin me pajisje teknike të zyrës, terrenin sportiv dhe ndriçimin.	ZLK
Të jetë një kod buxhetor i veçantë për Hoçë të Madhe;		Pranohet	Sipas ligjit, për fshatin Hoçë e Madhe ndahen 37,000 euro për paga për anëtarët, ndërsa ZKKK-ja ka një buxhet prej 20,000 euro për investime kapitale që janë të dedikuara për të gjitha komunitetet, pa specifika për vendbanime të veçanta. ZKKK-ja nuk ka linjë buxhetore të investimeve kapitale të destinuara specifikisht për një vendbanim (si fsh. Hoçë e Madhe), apo të një komuniteti specifik; ato shpërndahen në mënyrë të përgjithshme në të gjitha vendbanimet me përbërje të komuniteteve joshumicë sipas nevojës dhe prioritetëve.	ZLK
Deri ku ka arritur projekti për ujin e pijes?		Pranohet	Ky projekt është në proces të realizimit nga Komuna e Rahovecit, K.R.U. "Gjakova" dhe ministria përkatëse.	ZLK
Kërkesë për dezinfektimin e fshatit Hoçë e Madhe		Refuzohet	ZKKK-ja nuk ka pranuar zyrtarisht asnjë kërkesë për dezinfektim (me specifika kryesore) deri më tani. Komuna ka një kontratë për dezinfektimin e objekteve publike në të gjithë komunën. Në momentin e pranimin të një kërkesë me specifika, ajo do të trajtohet me prioritet së bashku me dikasterin përgjegjës.	ZLK
Fshati nuk ka këshill lokal - mungon kryetari i fshatit Hoçë e Madhe	Stanimir Mavrice			

**Dëgjimi publik me banorët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Çifllak,
Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor.
Objekti i shkollës fillore në Çifllak 31.07.2024 – Ora 19:00**

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus banorët e fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor është mbajtur në Çifllak, me datë 31.07.2024. Takimi ka zgjatur 1 orë e 7 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 21 pjesëmarrës. Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks. Gjatë dëgjimit janë parashtruar 47 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit në (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Problem me kanalizim - tri lagje në Çifllak	Selajdin Gashi	Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton se Komuna e Rahovecit ka dy kontrata të kësaj natyre: për zgjerimin e rrjetit në lagje që nuk ka dhe furnizimin me gypa sipas kërkesave të qytetarëve. Kontrata me nr. 623-23-171-1-2-1.	DSHP
Rregullimi i rrugës që lidh Koznikun me Polluzhën dhe mungon shenjëzimi i rrugëve		Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton se Komuna e Rahovecit ka kontratë për shenjëzimin e rrugëve, ndërsa për rrugë duhet të evidentohet cila rrugë	DSHP

			është fushore apo rrugë që është në kategorinë e rrugëve për ndërtim. Kontrata me nr. 623-22-1304-5-2-1.	
Kemi kërkesë edhe për rregullim të trotuareve në rrugën kryesore.		Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton në rrugën kryesore ka trotuar, sidoqoftë kemi kontratë për ndërtim të rrugëve me trotuare. Kontrata me nr. 623-24-2324-5-2-1.	DSHP
Shenjëzimi i trotuarit afër shkollës në Çifllak		Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton se Komuna e Rahovecit ka kontratë për sinjalizim horizontal dhe vertikal. Kontrata me nr. 623-22-1304-5-2-1.	DSHP
Ndriçimi publik - Çifllak		Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton se ndriçim publik ka fshati Çifllak. Pritet që gjatë vitit të bëhet ndërrimi i poçave të vjetër me ata të rinjë "esco". Kontrata me nr. 623-22-11049-2-1-1.	DSHP
Rregullimin e rrugëve fushore në fshatin Çifllak		Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e bujqësisë konstaton se Komuna e Rahovecit tanimë ka të lidhur kontratën për rregulim dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore dhe për fshatin Çifllak janë parapare 1000 m, të cilat shpresojmë që këtë vit dhe vitin e ardhshëm të perfundojnë. Kontrata nr. 623-24-3803-5-2-1/C598.	DBPZHR
Grumbullimi i ujit kur ka reshje atmosferike- rrezik për familje dhe biznese - Çifllak		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e bujqësisë konstaton se Komuna e Rahovecit tanimë kemi të lidhur kontratën për rregulim dhe mirëmbajtjen e kanaleve t; kullimit t; tokave bujqesore fshatin Çifllak . Kontrata nr. 623-21-2485-5-1-1/C301	DBPZHR
Ura është ndërtuar, rruga pas urës ka mbetur në gjysmë - Çifllak		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e bujqësisë konstaton se Komuna e Rahovecit do ta trajtoj deri në fund të vitit me kontratën e rrugëve fushore: 623-24-3803-5-2-1/C598.	DBPZHR
Kubëzimi i rrugëve të lagjeve në Kramovik	Binak Berisha	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e shërbimeve publike konstaton se Komuna e Rahovecit ka kontratë për për ndërtimin e 3 rrugëve në fshatin Kramovik. Kontrata me nr. 623-23-9085-5-1-1.	DSHP
Rregullimi i përroskave që shkarkohen nga Guri i Kuq		Refuzohet	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me drejtorinë e Urbanizmit ka konstatuar që Komuna e Rahovecit nuk ka kontratë për rregullimin e kanalit të kullimit në Retijë, pasi që nuk u konstatua si zonë që rrezikohet nga përmyjtjet dhe në këto vitet e fundit më shumë u fokusua në ato zona ku ka pasur vërshime dhe janë cilësuar si zona	DUMM

			me rrezikshmëri të lartë dhe janë më shumë zona bujqësore	
Një kanalizim problematik në lagjen "Kelmendi" ende nuk është përfunduar - Kramovik		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë për rregullimin e rrjeteve të ujërave të zeza. Kontrata me nr. 623-23-179-5-1-1.	DSHP
Të vazhdohet trotuari në rrugën kryesore - Kramovik		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se ka mungesë buxheti.	DSHP
Ndriçimi publik nëpër lagje		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë me ESCO, për zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik. Kontrata me nr. 623-22-11049-2-1-1.	DSHP
Rrethoja e Shkollës "Mustafë Ibishi"		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit ka konstatuar se do të kontraktohet me buxhetin e vitit të ardhshëm, me bartje.	DKA
Mungesa e kanalizimit në shkollën e Çifllakut	Halit Sahitaj	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit ka konstatuar se ekziston kontrata me nr. 623-23-179-5-1-1.	DKA
Vendosja e dritave elektrike në oborrin e shkollës		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit ka konstatuar se kemi kontratë me ESCO, për zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik. Kontrata me nr. 623-22-11049-2-1-1.	DKA
Largimi i shtyllës elektrike nga oborri i shkollës - Çifllak;		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit ka konstatuar se është në kompetencë të KEDS-it.	DKA
Shenjëzimi i trotuarit afër shkollës në Çifllak		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se ekziston kontrata për sinjalizim horizontal dhe vertikal, kërkesat i nënshtrohen komisionit përkatës dhe kërkesa merr epilog përfundimtar sipas konstatimit të këtij komisioni, i cili në përmbajtje ka ekspertë të fushave përkatëse (Gjatë muajit gusht 2024, nënshkruhet kontrata e re).	DBF

Ndriçimi publik në rrugën "Tahir Sinani" – Bllata në Çifllak	Selajdin Mazreku	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë me ESCO, për zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik. Kontrata me nr. 623-22-11049-2-1-1.	DSHP
Kubëzimi i rrugëve në fshat, prioritet i kemi dy rrugë, njëra 800m, tjetra 250m - Dobidol	Kujtim Sopjani	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë për ndërtim të rrugëve me Kompaninë "Etniku". Kontrata me nr. 623-23-9085-5-1-1.	DSHP
Kubëzimi dhe riparimi i trotuareve		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se është në kuadër të kontratës për meremetim të rrugëve dhe të trotuareve lot 2 dhe 4. Kontrata nr. 623-24-2324-5-2-1.	DSHP
Rregullimi i kanalit për ujërat atmosferike në fshat		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka konstatuar se e kemi të lidhur kontratën për rregullim dhe mirëmbajtjen e kanaleve të kullimit të tokave bujqësore në fshatin Çifllak. Kontrata nr. 623-21-2485-5-1-1/C301.	DBPZHR
Shtrimi i rrugëve fushore		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka konstatuar se e kemi të lidhur kontratën për rregullim dhe mirëmbajtje të rrugëve fushore dhe për fshatin Dobidol janë paraparë 500 m, të cilat shpresojmë që këtë vit dhe në vitin e ardhshëm të përfundojnë. Kontrata nr. 623-24-3803-5-2-1/C598.	DBPZHR
Aneks shtesë si shkollë fillore - Dobidol		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale	DKA

			për Arsim ka konstatuar se ka mungesë të mjeteve buxhetore.	
Mirëmbajtja e parkut në fshat - Dobidol		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë me Kompaninë "Ekodrinia" për mirëmbajtje. Kontrata nr. 623-23-8000-5-2-1.	DSHP
Mbështetje me serra, mekanizëm bujqësor dhe pleh artificial		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka konstatuar se Komuna e Rahovecit në programin për zhvillimin e bujqësisë është duke vazhduar të përkrahë fermerët në shumë sektorë. Pasi është përmbyllur faza e përkrahjes me pajisje bujqësore, tani fokusi është që të përkrahen me inpute, si: farëra, pleh, preparate etj. Po ashtu, ndërtimi i serrave është prioritet dhe do të ndodhë këtë vit dhe vitin e ardhshëm.	DBPZHR
Rregullimi i shtratit të lumit Drini I Bardhë			Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka konstatuar se në vitin 2025, do të lidhet kontratë për pastrim të përrrenjve dhe kanaleve, kjo kërkesë do të trajtohet përmes kësaj kontrate.	DBPZHR
Rregullimi i trotuareve në fshatin Polluzhë	Alban Bajraktari	I pranuar	Edhe pse ka kontratë për ndërtim të trotuareve, vetëm një pjesë e vogël ka hapsirë për trotuare, sepse vendbanimi dhe rruga që është brenda, nuk ka hapësirë për trotuare. Nëse ka vende që duhet të ndërtohet, le të bëhen kërkesat specifike së në cilën pjesë duhet të bëhet trotuari. Kontrata nr. 623-24-2324-5-2-1.	DSHP
Ndriçimi i lagjeve në fshatin Polluzhë		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë me ESCO për zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik. Kontrata me nr. 623-22-11049-2-1-1.	DSHP

Pastrimi i kanaleve kulluese në fshat - Polluzhë		I pranuar	Vitin e ardhshëm do të lidhet kontratë për pastrim të përrënjeve dhe kjo kërkesë do të trajtohet përmes kësaj kontrate	DBPZHR
Segmente të vogla për kubëzim në fshatin Polluzhë		I pranuar	Kemi kontratë për rregullimin e rrugëve, mirëpo të adresohen kërkesat për cilat rrugë dhe ato rrugë a janë private apo rrugë që janë kategori e rrugëve publike. Kontrata me nr. 623-23-9085-5-1-1.	DSHP
Problemet me kanalizim në lagjen e epërme – Polluzhë		I pranuar	Kemi kontratë me kompaninë "Bazalti" për rrjetin e ujërave fekale. Kontrata me nr. 623-23-179-5-1-1.	DSHP
Asfaltimi i rrugës tranzite, Sarosh – Pastasel		I pranuar	Tanimë kemi të lidhur kontraten për rregulim dhe mirëmbajtje të rrugëve fushore dhe për fshatin Polluzhë-Pastasel , të cilat shpresojmë që këtë vit dhe vitin e ardhshëm të perfundojnë. Kontrata nr. 623-24-3803-5-2-1/C598.	DSHP
Vendosja e policëve të shtrirë - Polluzhë		I pranuar	Ekziston kontrata për sinjalim horizontal dhe vertikal, kërkesat i nënshtrohen komisionit përkatës dhe kërkesa merr epilog përfundimtar, sipas konstatimit të këtij komisioni, i cili në përmbytje ka ekspertë të fushave përkatëse. (Gjatë muajit gusht 2024, nënshkruhet kontrata e re.)	DBF
Pastrimi i kanaleve kulluese në fshat - Polluzhë		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka konstatuar se v Vitin e ardhshëm do të lidhet kontratë për pastrim të përrënjeve dhe kjo kërkesë do të trajtohet përmes kësaj kontrate.	DBPZHR
Punimi i kanaleve të hapura në Lagjen "Fetahaj" - Gur i Kuq	Drilon Mustafa			DUMM
Kubëzimi i rrugës "Bregu i Arave"		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e	DSHP

			Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë për ndërtim të rrugëve nga kompania "KAG Oil". Kontrata me nr. 623-23-3318-5-1-1.	
Trotuari rrugës për në shkollë		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se është në kontratë, gjatë vitit 2024 përfundon. Kontrata nr. 623-24-2324-5-2-1.	DSHP
Ndërrimi i rrjetit elektrik - Gur i Kuq	Osman Halilaj	Adresuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se është në përgjegjësi të KEDS-it.	DSHP
Rregullimi i dy rrugëve që të dërgojnë te varrezat e katolikëve në Dobidol	Lekë Gashi	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë për ndërtim të rrugëve nga kompania "KAG Oil". Kontrata me nr. 623-23-3318-5-1-1.	DSHP
Të asfaltohet rruga që lidh fshatin prej hekurudhës deri në qendër - Çifllak	Feriz Thaqi	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë për rehabilitimin e rrugëve me asfalt.	DSHP
Vendosja e pikave gjeodezike për rrugën e fshatit - Çifllak		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Kadastër dhe Pronë ka konstatuar se verifikimi i gjendjes në terren.	DKP
Të largohen mbeturinat te Drini - Çifllak		I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se janë bërë pastrimet çdo vit. Kemi kontratë me "Ekodrinia". Kontrata me nr. 623-23-13129-2-1-1.	DSHP
Mirëmbajtja e rrugëve lokale në fshatin Çifllak	Baki Limani	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë për mirëmbajtje të rrugëve lot 2 nga kompania "Etniku". Kontrata me nr. 623-24-2324-5-2-1.	DSHP
K.R.U. "Gjakova" gjatë punimeve të kujdeset dhe ta	Feriz Thaqi	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e	DSHP

rikthejë rrugën në gjendjen e mëparshme në Çifllak			Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi marrëveshje me K.R.U. "Gjakova" për rehabilitimin e rrugëve pas riparimeve të defekteve.	
Furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra	Bashkim Halilaj	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit ka konstatuar se ka mjete të planifikuara.	DKA

Dëgjim publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus punonjësit e shërbimeve publike dhe punëtorët shëndetësorë

QKMF "Fahredin Hoti" në Rahovec 2.8.2024 – Ora 13:45

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus punonjësit e shërbimeve publike dhe punëtorët shëndetësorë është mbajtur në QKMF "Fahredin Hoti" në Rahovec, me datë 2.8.2024. Takimi ka zgjatur 1 orë e 17 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 49 pjesëmarrës.

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 7 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit në (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Rritja e buxhetit për analiza (reagencë)	Elbunit Kryeziu	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	DSHPS
Pajisja me inventar të ri për nevojat e QKMF-së dhe të AMF-së	Elbunit Kryeziu	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	DSHPS
Gjendja jo e mirë e ambulancës në Opterushë	Albert Shala	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale	DSHPS

			ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	
Probleme me nyje sanitare në ambulancën e Opterushës	Lumturie Fazliu	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	DSHPS
Nevojë urgjente për një inverter në laborator	Lumturie Fazliu	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kjo kërkesë do të realizohet.	DSHPS
Nevojë për një aparat të ri të biokimisë	Elbunit Kryeziu	Refuzuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kostoja e efektivitetit është e lartë.	DSHPS
Aparat të veçantë për glikime	Elbunit Kryeziu	Refuzuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale ka konstatuar se kostoja e efektivitetit është e lartë.	DSHPS

**Dëgjimi publik me banorët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Drenoc, Senoc, Pastasellë, Zatriq, Kaznik, Pataqan i Epërm.
Objekti i shkollës fillore në Drenoc - 30.7.2024– Ora 19:00**

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus banorët e Rahovecit, me fokus banorët e fshatrave Drenoc, Senoc, Pastasellë, Zatriq, Kaznik, Pataqan i Epërm është mbajtur në Drenoc, me datë 30.7.2024. Takimi ka zgjatur 50 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 21 pjesëmarrës.

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 9 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit në (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
---------------------------------	---	--	---	------------

		Pjesërisht		
Kërkesë për një simbol për masakrën e Pastaselit	Mehreme Krasniqi	Refuzuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Urbanizmit ka konstatuar se ka mungesë të mjeteve buxhetore.	Drejtoria e Urbanizmit
Rregullimi i fushës së basketbollit dhe riparimi i fushës së futbollit	Seljadin Berisha	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Arsimit ka konstatuar se ekziston kontrata me nr.	Drejtria e Arsimit
Riparimi i ndriçimit publik afër shkolles	Seljadin Berisha	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se kemi kontratë me ESCO. Kontrata me nr. 623-22-11049-2-1-1.	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Prioriteti i ujit të pijshëm	Artan Asllani	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se ka bashkëpunim me K.R.U. "Gjakova", do të insistojmë që të planifikohet projekti i ujit të pijshëm për dy fshatra: Senoc dhe Drenoc.	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Rruga me kubëza: Rruga "Xhavit Gashi", Rruga "Dastant", Rruga e Gashve, Rruga "Haliljakup", Rruga "Veli Zyberaj", Rruga "Abaz Zyberaj", Rruga "Vesel Krasniqi", Rruga "Dan Mehmeti", Rruga "Sali Qazimi", Rruga e Mrizeve, Rruga "Beq Makshana", Rruga "Rexhep Kastrati", Rruga "Legjes Kastrati"	Artan Asllani	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se këto kërkesa janë bërë sivjet dhe DSHP planifikon, përmes një kontrate të re, që do të bëhet në vitin 2025.	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Shtrimi i rrugës Drenoc-Sarosh	Artan Asllani	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar se është në kuadër të kontratave për riasfaltim.	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Ndërtimi i një grope septike	Artan Asllani	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka konstatuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike

			se është në kuadër të ndërtimit të kanalizimeve dhe gropave septike. Kontrata me nr. 623-23-179-5-1-1.	
Rregullimi dhe ridizajnimi i qendrës së fshatit, konkretisht sheshi i dëshmorëve	Artan Asllani	I pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe ka konstatuar se ky projekt është aktiv në Drejtorinë për Urbanizëm.	Drejtoria e Urbanizmit
Rregullimi i muzeut të UÇK-së	Artan Asllani	I pranuar		Drejtoria e Urbanizmit

Dëgjimi me qytetarët e Rahovecit, me fokus përfaqësuesit e OJQ-ve, bizneseve, fermerëve, rinisë, përfaqësues të shkollave dhe grupet e interesit
Salla e Kuvendit 6.8.2024 – Ora 10:00

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus përfaqësuesit e OJQ-ve, bizneseve, fermerëve, rinisë, përfaqësues të shkollave dhe grupet e interesit është mbajtur në Rahovec në Sallën e Kuvendit, me datë 6.8.2024. Takimi ka zgjatur 1 orë e 18 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 38 pjesëmarrës.

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverbali nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 3 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit ne (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Një lagje të mbillet me hardhi të rrushit dhe të emërtohet “lagje e hardhisë”	Vjollca Gurgule	Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Urbanizëm ka konstatuar se kontrata është e lidhur.	DUPMM
Ndërtimi i një parku të Rrasat				
Rregullimi i murit të varrezat e serbeve	Naser Dula			

Dëgjimi publik me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e lagjeve të qytetit (I, II, III, IV)

Salla e Kuvendit Komunal 6.8.2024 – Ora 19:00

Raporti me të gjitha detajet:

Dëgjimi publik me fokus me qytetarët e Rahovecit, me fokus banorët e lagjeve të qytetit (I, II, III, IV)

është mbajtur në **Rahovec në Sallën e Kuvendit**, me datë 6.8.2024. Takimi ka zgjatur 1 orë e 18 minuta dhe në të kanë marrë pjesë 38 pjesëmarrës.

Thirrja për takim materialet promovuese dhe procesverballi nga ky takim janë të bashkangjitura në aneks në aneks.

Gjatë dëgjimit janë parashtruar 3 kërkesa dhe grupi punues në takimin e mbajtur me datë 04.09.2024 ka marrë vendimet e mëposhtme për t'i trajtuar kërkesat. Shih dokumentet si ftesat dhe procesverbalet e takimit ne (Aneks 1).

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë / sugjerim për projektin e buxhetit të vitit 2025	Statusi i kërkesës: Pranuar Refuzuar Pjesërisht	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)	Drejtoria:
Rregullimi i rrugës “Haxhi Hoti”-kanalizimi dhe gypi i ujësjellësit	Nebih Hoxha	Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Shërbime Publike ka konstatuar se aprovohet nga komuna për intervenime në këtë rrugë.	DSHP
Nevoja për dy policë të shtrirë (pengesa), në rrugën “Xhelal Hajda”	Ardian Kadiri	Pranuar	Grupi punues ka analizuar kërkesën dhe në koordinim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se ekziston kontrata për sinjalizim horizontal dhe vertikal, kërkesat i nënshtrohen komisionit përkatës dhe kërkesa merr epilog përfundimtar sipas konstatimit të këtij komisioni, i cili në përbajtje ka ekspertë të fushave përkatëse. (gjate muajit gusht 2024, nënshkruhet kontrata e re.)	DBF

Me 04.07.2024:

Kalendari-Njoftimi përmes emailit u është dërguar : Drejtorëve të shkollave fillore-publike; drejtorëve të shkollave të mesme-publike; drejtorëve të shkollave private; pedagog, psikolog, mësime dhënë, mbështetës në shkollat fillore dhe të mesme; sekretarëve të shkollave të punësuar në institucione arsimore; policia, zjarrfikës, biznese; OJQ për mirëqenie, OJQ për barazi gjinore; institucione shëndetësore (QKMF, QMF dhe AMF) dhe OJQ të ndryshme.

Përmes grupit të formuar në rrjetin social viber, njoftimi dhe materialet që kanë të bëjnë me dëgjime buxhetore u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve të Komunës së Rahovecit.

Shkurtesat:

F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali, P-Pranuar, R-Refuzuar, PJ-Pjesërisht.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 235/24 i datës 25.07.2024 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 235/24 i datës 25.07.2024 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik.
2. Pika 1 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim:
 1. Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm publik ndërtesa administrative në sipërfaqe prej 200m² (dyqind metra katror) e evidentuar në emër të KB Bujku Drenoc Rahovec, e cila ndërtesë gjendet në parcelën kadastrale P-71510026-00041-1.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 01 Nr. 235/24 i datës 25.07.2024 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/2024
Datë:00.09.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec



Njesia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/235 Nr. i faq./Br.str./No.pg 68

Data/Datum/Date 25.07.2024

Në mbështetje të nenit 12, pika 1 dhe pika 2, shkronja d), nenit 14, pika 1, nenit 17, shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2024, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik P -71510026-00041-1 në Zonën Kadastrale Drenoc

1. Me këtë vendim, shpallet me interes të përgjithshëm publik në ndërtesën administrative të KB Bujku Drenoc – Rahovec, Zona kadastrale Drenoc, Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe prej 200m² (dyqind metra katror), e cila gjendet në njësinë kadastrale: *P -71510026-00041-1*, në vendin e quajtur *Vishe Sela – Vishe Sela*, sipas certifikatës së pronësisë: *Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K. Rahovec - Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec*.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të lokalit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë: iniciimi i procedurës për shpronësim dhe meremetimi i shtabit të UÇK-së.
3. Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.235/24
Datë:25.07.2024





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510026-00041-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0027671/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission:	16.07.2024 - 09:31
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Drenoc / Drenovac / Drenovec
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71510026-00041-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		11680	2-2000		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
VISHE SELA-VISHE SELA				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësori/Pojtoprivredu/Agriculture	Kullosa/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 6/Pashnjak 6 Klase/6th Class Pasture	11680

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Poseëdin individual / Individualna Drazvina / Single possessor	PASURI SHITET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHRYT.EKON.E PYJEVE RAHOVEC	KCID1503615	RAHOVEC/ ORAHOVAC/ RAHOVEC /		RAHOVEC	1/1	2-2000	





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
II	
Nr.	2649
Dr.	
No.	
Nr. 154.	2
Dr. 154.	02. 07. 2024
Dr. 154.	
Dr. 154.	
Pratërit / Pristat	

02 Korrik 2024

Për: z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit

Përmes: z. Petrit Ibraj, U.d Zëvendës Drejtor Ekzekutiv

Lënda: Pronat të cilat janë me interes publik për Komunën e Rahovecit

I nderuar z. Latifi,

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i themeluar me Ligjin Nr. 04/L-034 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr.05/L-080 dhe Ligjin nr. 04/L-115, me mandat ligjor për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve të tyre.

Agjencia Kosovare e Privatizimit me anë të kësaj shkrese dëshiron të ju njoftoj për të gjitha asetet në pronësi shoqërore që planifikojmë të i tenderojmë andaj e domosdoshme që brenda afatit prej 15 ditëve, nga data e pranimi të kësaj shkrese, Komuna të njoftoj AKP-në nëse ndonjëra nga pronat që janë në këtë listë është me interes për Komunën, dhe nëse ka ndonjë aset/pronë që është me interes brenda afatit prej një (1) muaj të fillohet me procedura të shpalljes me interes publik të pronave për të cilat ka shpreh interes publik komuna.

Gjithashtu për këto raste, kërkojmë që nga data e pranimi të kësaj shkrese, deri në një periudhë 2 muajore të iniciohen procedurat për shpronësim të këtyre pronave dhe të nxirret vendim preliminar.

Në rast se Komuna nuk ndërmer veprimet ligjore të lartcekura brenda këtyre afateve, AKP sipas ligjit dhe planit të punës do të jetë e detyruar që të vazhdoj me shitjen e këtyre asetëve.

AKP gjithashtu është e gatshme që të ju takoj për sqarim të çfarëdo pakjartësie lidhur me këtë kërkesë.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin gjatë procesit të privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve shoqëror. AKP çmon lartë vazhdimësinë dhe ngritjen e këtij bashkëpunimi.

Me respekt

Arben Limani
Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr	Rajoni	Komuna ku gjendet aset	Lokacioni i asetit (Fshat, Qyte)	AKP ID	Emri NSH-së	A është NSH në likuidim	Data e vendosjes së NSH-së në likuidim	Kategoria e asetit	Sipërfaqja e objektit në m ²	Sipërfaqja e tokës në m ²	Vlera
4											
83	Prizren	Rahovec	Opterushë	PRZ044	Podrima	PO	26-Feb-20	lokal dhe tokë	45.00	200	
99	Prizren	Rahovec	Drenoc	PRZ086	KB Buju Drenoc Rahovec	PO	26-Feb-20	ndërtësë administrative	200.00	4.1-1	
375	Mitrovica	Rahovec	Rahovec	MIT144	Borova Vukovar	PO	26-Feb-20	lokal	70.00	-	
503	Prishtina	Rahovec	Rahovec	PRN125	BANKKOS	PO	26-Feb-20	lokal	74.64	-	
GJITHSEI											208,533
Nëntotal											390
											200

74.64 + 200.00 = 274.64 €

Shënim: Ky dokument është i përbërë nga 100 kopje të njëjta.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Drenoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510026-00041-1	Parcelë / Parcela / Parcel	11680



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1765

Punoi/Obradio/Created: Albina Durguti

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 16.07.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:32:12



Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal të datës 13.03.2008, nenit 10 dhe nenit 40, paragrafi 2, pika 2.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë: 00.09.2024, merr këtë:

V E N D I M
Për miratimin e buxhetit për vitin 2025

Neni 1

Komuna e Rahovecit, konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, miraton buxhetin për vitin 2025 me limitet, në bazë të Qarkores Buxhetore 2025/02, të shpërndara nëpër kategori ekonomike dhe buxheti për vitin 2025 është gjithsej 20,982,796.00€, ku nga grantet qeveritare janë 18,981,085.00€ dhe të hyrat vetanake janë 2,001,711.00€.

Shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike për Komunën e Rahovecit, për vitin 2025, është si vijon:

Paga dhe Mëditje	10,746,449.00 €
Mallra dhe Shërbime	2,761,006.00 €
Shpenzime Komunale	390,000.00 €
Subvencione dhe Transfere	1,010,000.00 €
Investime Kapitale	6,075,341.00 €
Buxheti total për vitin 2025	20,982,796.00 €

Neni 2

Të hyrat buxhetore komunale krijohen nga dy burime: Granti qeveritar dhe të hyrat vetanake, të cilat realizohen nga tarifat dhe ngarkesat e aprovuara në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

Neni 3

Shpenzimet nënkuptojnë të gjitha shpenzimet që kryhen nga buxheti komunal dhe buxheti për Arsim e Shëndetësi në Komunë, sipas rregullave dhe udhëzimeve financiare të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Neni 4

Ky vendim do të aplikohet së zbatuari nga data 1 janar 2025.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr. ____/24
Datë:00.09.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit